

Marash Hajati



BIJTË
E TOKËS
SIME ...

8SH - 91
H 19

MARASH HAJATI

BIJTË
E TOKËS
SIME...

(Shënimë publicistike)



SHTËPIA BOTUESE «8 NENTORI»

ITALIAN HUMAN

30-418
HVA

BİTİR
E TOKÇES
SİMİ...

(Sıreninės publicistica)

Redaktor Petrit Ymeri
Recenzentė Hamit Boriçi
Namik Dokle
Kopertina Françesk Zirüs

— Blijft u dat een goed voorbeeld van een goed verhaal? —
— Ja, dat is een goed voorbeeld. —
— En dat is een goede manier om te vertellen over de geschiedenis van ons land. —
— Ja, dat is een goede manier om te vertellen over de geschiedenis van ons land.

Bijtë e tokës sime...

Duart i zgjati me ngadalë nga oxhaku i skalit
litur në gurë, dhe, ashtu siç heq nëna me kujdes
fëmijën e vogël nga djepi, hoqi nga kërraba
lahutën legjendare trashëguar nga baba i vet. Ky
është gjyshi ynë, gjyshi i tërë shtëpisë. Kishte
tri mote mbi njëqind vjetët, e kishte tre vjet
që jetonte i verbër. Nuk shihte më as lahutën,
as njerëzit, as fytyrën time që më kishte aq
mall. Ai nuk shihte dritën... Por e ndiente
gëzimin, e shihte Shqipërinë e lirë. Ishin vitet
e para të dala nga luftërat e betejat.

— Boll besa më kanë thanë e fort kam
dëgjue se asht ba e madhe lufta partizane. E be-
sa, kur populli nis e fiton beteja të mëdha për
liri, rritet si dragoi! Unë pata krahë. Në luftë
me turkun pata krahë e me sërbin, e me austro-
hungarin... Tash edhe pse 100 vjeç, kam lahu-
tën...

Ndenjur pranë vatrës, çfarë nuk sillte ajo
lahutë, me tingujt e saj të veçantë që dukej se

merrnин burim nga thellësitë e shekujve. Dardave dilnim me gjyshin në prag të derës te guri i gdhendur e nisnim e këndonim. Jo, unë më tepër dëgjoja ato këngë fisnikë e trime, plot krenari e dhimbje që nga Gjeto Basha, Muja e Halili e deri te historitë e jetës së kaçakëve kundër Zogut.

— Eh, more gjysh, — thoshja me vete, — sa herë do ta kishe ndërprerë ti këngën tënde të përmallshme sikur ta dije se unë mbythesha në vaj nga ato fjalë prekëse. Por ai ishte i verbër e lotët e mi s'i shihte. Ndërsa unë qaja pazë, ashtu në vetvete, që ai të mos më dëgjonte.

Mbi 100 vjet jetoi gjyshi im. Deri sa e lanë sytë, gjithnjë qëndroi me armë në krah. Kur vdiq, me armët e djaliërisë e varrosën.

Shumë vite kanë kaluar, shumë të tjerë do të kalojnë, por nga mendja nuk do të më hiqen këngët e gjyshit tim, këngët për bijtë e kësaj toke, që sic thoshte ai, me luftërat e me dashurinë e shenjtë për tokën e Atdheun, ia zbardhën faqen Shqipërisë.

Kam dëshur e jam përpjekur tërë jetën t'u këndoju me penën time bijve të tokës sime, që në vite e në shekuj bënë luftën për liri e pavarësi, për kulturë e gjuhë. T'u këndoju betejave legjendare të partizanëve trima që me Partinë në krye e Enver Hoxhën komandant, realizuan ëndrrën shekullore të të gjithë gjyshërvë tanë flokëthinjur, për ta parë Mëmëdheun «Zonjë», sic thoshin vëllezérir e paharruar Frashëri. U kam kënduar ndryshimeve të mëdha të Atdheut në vitet e ndërtimit socialist të vendit, bijve të tokës sime, njerëzve të punës, të luftës, që kanë bërë e bëjnë historinë.

1967. Si që i cili është një viti i shkollës së mesme
Shkodër, kemi përdorur një vjet e shkollës së mesme
Shkodër, që ka qenë një vjet e shkollës së mesme
Shkodër, që ka qenë një vjet e shkollës së mesme
Shkodër, që ka qenë një vjet e shkollës së mesme

1967. Si që i cili është një vjet e shkollës së mesme

1967. Si që i cili është një vjet e shkollës së mesme

1967. Si që i cili është një vjet e shkollës së mesme

Në vitet e largëta e të afërtë të shkollës pedagogjike

Kujtimet si libra të pashkruar, nuk i ndahen njëjut asnjëherë. Ato e ndjekin, pas kudo; në biseda; pranë vafrës në biblioteka.

Jemi me një grup shokësh. Vite më parë kemi mbaruar së bashku shkollën pedagogjike në Shkodër, e, jeta na ka cuar në punë e detyra të ndryshme. Pjesa më e madhe kanë vazhduar profesionin e arsimtarit, në fshatra e në qytete, por ato vite, të shkollës pedagogjike kanë mbeetur aq, të dashura, e aq, të paharruara për ne, sa kudo e kurdoherë na sjellin gjëzime e meditime.

Në sallëm e muzeut të Shkodrës. Si xhevahire të cmueshme kemi grumbulluar një turri fotografish. Ato përbëjnë e përbajnjë grimca historike nga qyteti ynë i lashtë, nga shkolla jonë e dashur.

Ndalemi në këto fotografi. Jam muret e gurtat e të zymta që ngjiteshin lart duke fshehur

edhe shtëpitë, e, të dukej sikur donin të ndanin edhe qiellin. Këto mure ishin ndërtuar gjatë shekujsh në Shkodër si pér të ruajtur prapambetjen, errësirën, feudalizmin. Ato donin të ndanin dikur, në këtë qytet historik: njerëzit, familjet, lagjet e besimet.

Këtë pejsazh blasfemon Migjeni në vargjet e njohura:

«*Xhamijat dhe kishat madhështore ndër vende tona të mjerueme...*

Kumbanoret dhe minaret e nalta mbi shtëpijat tona përdhecke...

O pikture ideale, e vjetër njëmijë vjeçë!»

Kjo ishte Shkodra e vitit 1918. Tymrat e Luftës së Parë Botërore me pasojat e tyre rrënuarë endeshin mbi këtë qytet e mbi të gjithë Shqipërinë e shtypur e të robëruar. Pjesa qëndrore e veriore e vendit gjendej nën pushtimin austrohungarez, i cili ngjalli pakënaqësi të reja në masat e popullit.

Populli ynë, që nuk u gjunjëzua kurë, edhe pse në kushtet e vështira, të shtypjes e të prapambetjes, luftoi me armë në dörë, me krenari e optimizëm se një ditë do të fitonte të drejtat e tij kombëtarë. Këtë luftë të madhe përliri e pavarësi populli i Shkodrës, ashtu si kudo në Shqipëri, nuk e ndau kurë nga lufta për shkollën, pér dijen dhe pér kulturën.

Lufta pér gjuhën e pér kombin, pér arsimin, nér gjuhë amtare, pér arsimin laik dhe kombëtar, ishte një luftë politike pér zgjerimin, bashkimin dhe çlirimin kombëtar e shoqëror. Rrנדaj forcat shoqërore, përparimtare, të mbështetuta nga masat e popullit, të etura pér arsim,

kulturë e dituri, zhvilluan veprimitari të dendur, shpesh me shumë rreziqe për të themeluar shkollën laike kombëtare popullore. Në të vërtetë kjo ishte një formë e kundërtisë klasore midis forcave shoqërore përpërparimtare, kryesisht nga gjiri i popullit dhë forcave reaksionare, kryesisht nga gjiri i feudalizmit e i borgjezisë konservatorë.

Lufta për pavarësi e kulturë kombëtare hyri, kështu në një fazë të re. Atdhetarët e shquar të lëvizjes kombëtare në Shkodër, me Luigj Gurakuqin, në ballë, duke shfrytëzuar edhe disa kontradikta konjunkturale në mes të imperialisteve italiane e austrohungarezë, këmbëngulën për hapjen e shkollave në gjuhën shqipe e përgatitjen e mësuesve.

Rikësht, në këtë kohë, në Shkodër, krijuhet Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit. Si masë e parë e këtij institucionit ishte hapja, në vitin shkollor 1917-1918, e shkollës së parë të mesme shqipe profesionale, dhe laike në Shkodër. Kjo ishte plotësim i dëshirës, dhe i kërkesës së vazhdueshme, të popullit, arsimdashës, të Shkodrës, dhei përpjekje të mëdha, të atdhetarëve, të luftës shumëvjeçare, për gjuhën shqipe, për të drejta e përparim shoqëror, për dituri. Ndihmë vendimtare, në themelin e shkollës, dhanë Luigj Gurakuqi, Sali Nivica, Gaspër Beltoja etj., etj.

Në shtypin e asaj kohë, dhe në afishimet e ndryshme, njoftohej se: Mbës para-vumës së Drejtorisë së Përgjithshme, të Arsimit do të çelen, për së shpejti, rendet e para të shkollës Normale, në Shkodër e Elbasan... Nga një fletore tjetër e asaj kohë, që bëtohej në Shkodër, njoftoheshin lexësia, dhe të interesuarit se: shkolla e re do të hapej aty ku ishte shkolla popullore e Rúsit.

Qëllimi i kësaj shkolle ishte përgatitja e arsimtarëve, e atyre njerëzve që me penë e dije do të rrënjosnin te populli dashurinë për atdheun e do të rrisnin ndërgjegjën kombëtare. Shkolla, libri, shkrimi në gjuhën amtare përbënë në atë kohë një front të madh pune, e lufte, që i kundërvihet prapambetjes së madhe të vendit tonë, obskurantizmit e dasive fetare, synimeve imperialiste e shoviniste të shteteve fqinje etj.

Në këto kushte, çelja e kësaj shkolle normale laike për përgatitjen e mësuesve mori rëndësi të veçantë. Dita e hapjes së shkollës u kthye në festë të bukur. Në një fotografi shikojmë mësues e nxënës me qylafët karakteristikë të Shkodrës së dikurshme. Në fillim shkolla nisi punën më një klasë gatimore me 26 nxënës. Në planin mësimor kishte 29 orë mësim në javë. Vendin kryesor e zinte gjuhja shqipe, pastaj vini i Tëndët e tjera si aritmetika, historia, gjeografja, gjuhja e huaj, gjimnastikë, vizatimi etj.

Drejtori i kësaj shkolle ka qenë mësuesi atdhetar Gaspër Beltoja, personeli arsimor përbëhej edhe nga tre arsimtarë të tjera.

Deri vonë kanë jetuar mes nesh shumë nga nxënësit e kësaj shkolle, dëshimtarët e gjallë e pionierët e palodhur të gjuhës e dijes. Koha ata i ka çuar nga një skaj te skaji tjetër i Atdheut, por kurri s'i ka ndarë nga kujtimet, gëzimet, nga lufta e puna që kanë bërë edhe këtu në qytetin e lindjes pranë shkollës normale (pedagogjike).

Neve na ka rastisur shpesh të takoheni me këta veteranë të përhapjes së arsimit e të kulturës, në popull e gjithnjë diçka të re e të bukur kemi mësuar prej tyre. E tek bisedojmë e të kujtojmë me shokët episodet e ngjarjet e viteve të shkollës, na vijnë ndër mend e ndër biseda edhe kujtimet e brezit të parë të nxënësve të shkollës sonë.

75

Nga ajo klasë e parë e asaj shkolle ka dalë edhe mësuesi i palodhur Rakip Gjylbegu. Ja si e kujton ai ditën e parë: «U grumbulluam në obo rrin e shkollës e mandej, u bamë për dy e u ngjitetëm lart në klasë. Numri i nxanësve ishte nga 26-27 veta. Mësuesi hymë të gjithë, atëherë erdhi në klasë drejtori i përgjithshëm, i arsimit, në atë kohë Luigj Gurakuqi, bashkë me drejtorin e shkollës e me dy-tre mësues të tjere. Luigj Gurakuqi na foli disa fjalë, nă tha se ju do të hapeni në të gjitha anët e Shqipnisë e do të çoni fjalën e gjuhës shqipe që deri atëherë nuk ishte përhapun dhe e mnueme. Nxanësit që ishin mbledh aty, ishin më besime të ndryshme, myslimanë, katolikë dhe ortodoksë. Na ishim të entuziazmum shumë që po na bjen rasti me u mbledhë në shkollë e me punue bashkërisht. Asht e para herë që mblidhshim nxanës me besime të ndryshme. Po shkonte në vend fjalë e poetit dhe e shkrimtarit të madh Vaso Pash Shkodrani që ka thanë se s'na ndanë as kisha, as xhamija, feja e shqiptarit asht shqiptaria».

Me gjithë kushtet e vështira, dëshira e po pullit të thjeshtë për arsim erdhi duke u rritur. Shkolla u dha frymëzim të mëtejshëm, ndjenjave atdhetare. Kështu, me iniciativën e mësuesve dhe të njerëzve të tjerë përparimtarë që kishin njefarë kulturë, në mjaft lagje të Shkodrës u hapën kurse kundër analfabetizmit. Në Parrucë, një nga lagjet më të populluara të qytetit, ku ishin grumbulluar zejtaret e qendrat e ndryshme trëgtare, nëtëve, mbas punës së gjatë e të lodhshme, nën dritën e kandilit «mësuesit» u mësonin çirakëve shkrim e këndim. Në Ajasëm hapet një shkollë në formë kursi për të zhdukur analfabetizmin. Edhe në mjaft fshatra si në Zogaj, në Grizhë etj., bëhen përpjekje për sigurimin e arsimtarëve.

Por shkolla akoma s'kishte hedhur hapat e para, kur mbi të u derdhën mallkimet e priftërinjve e të boxhallarëve. Kleri dredharak, në-përmjet predikimeve e shtypit që ai kontrollonte, filloi sulmin e tij të hapur e të fshehtë. Ur-dhri jezuit e ai francëskan filluan të përhapin mendimin se vështirë të mbahej një shkollë pa bazë materiale, pa kushte pune, prandaj ajo ishte e parakohshme. Kadiu i Shkodrës e pasuësit e tij ankoheshin se shkolla ka shkurtuar shumë orët e besimit fetar e nxënësit që do të ndiqnin aty mësimet, nuk dihej se çfarë do dil-nin. E, sikur të mos mjaftonte gjithë ky vrer që villnin, ata u hënë në vëprime konkrete për të penguar mësimet. Meqenëse shkolla normale u vendos në një ndërtësë pranë një xhamie, pranë e «shenjtë» përnjëherë ngritën padinë përti marrë asaj oborrin se gjoja ishte vend vakëf, që i përkiste xhamisë. Arkimadriti, nga ana tjetër, kërcënói besimtarët ortodoksë që të mos dërgonin asnje nga fëmijët e tyre në shkollën laike. Jo vetëm kaq, por edhe vetë organet e pushtetit ëxirrin lloj-lloj pengesash. Kështu, gjatë zhvillimit të mësimit, pranë shkollës shpesh bënin rojë police, të cilët, me pretekstin se po prishet qetesia e qytetit, nuk lejonin t'i bihej as bilbilit në orën e gjimnastikës. Për këtë drejtori i shkollës, nëpërmjet shkresave, u ankua disa herë pranë organeve shtetërore.

Mëgjithë këto pengesa, Normalja e Shkodrës është vazhdoi veprimtarinë e saj frytdhënëse. Ajo pati jehonë edhe në qarqe të tjera të vendit. Eshtë kuqtimplot fakti që, me gjithë vështirësitetë është krizës ekonomike, kur gjëmimet e Luftës së Parë Botërore dëgjoheshin akoma mbi vendintonë, të shtypur e të varfër, popullsia e Beratit, e Fierit dhe është qyteteve të tjera, grumbullojnë ndihma për shkollën «gatimore normale të Shkodrës».

Në vitin 1920 shkolla mbyllt për shkak të vështirësive që u krijuan dhe rihapet përsëri më 1922, si degë më vete, pranë Gjimnazit të Shtetit, që sapo ishte krijuar. Më vonë, shkolla normale ndahet përsëri duke vazhduar veprimitarë e saj deri në vitin 1943 me emrin: instituti femror «Donika Kastrioti».

Ashtu si në të gjithë Shqipërinë, edhe në Shkodër, i tërë populli, të rinj, e pleq kërkuan ta prisnin sulmin fashist të prillit 1939 me armë. Në demonstratat që u zhvilluan në qytetin e Shkodrës më 5 e 6 prill, nën udhëheqjen e komunisteve, rol të rëndësishëm luajti edhe rinia shkollore e gjimnazit dhe e normales, e cila u bashkua me turmën e demonstruesve dhe së bashku kaluan nëpër rrugët e qytetit duke kërkuar armë, duke shprehur urrejtjen e thellë përfashizmin e duke kënduar këngë atdhetare.

Por Shqipëria ishte shitur nga klika tradhtare e Ahmet Zogut. Bashkë me pushtimin filloi edhe qëndresa e popullit dhe e rinisë kundër pushtuesit e tradhtarëve vendas. Ndër vatrat e para të vendosura të kësaj qëndrese ishin shkollat e mesme.

Shkollat e vëndit tönë dhe institucionet e tjera përparimtare, kulturore e artistike të asaj kohe, që trashëguan një traditë të mrekullueshmë atdhetare e luftës kundër prapambetjes e shtypjes shekollore, që mbanin gjallë si pishtarë dashurinë për Attheun, gjuhën, kulturën, me themelimin e Partisë u kthyen në qendra revolucionare, që i shembët ndarjet e mureve të shkollës nga interesat e popullit. Ato u kthyen në çerdhe të luftës për liri.

Në këtë veprimitari me vlera të mëdha në jetën revolucionare të Shkodrës, ka luajtur rolin e vet edhe instituti femror «Donika Kas-

trioti». Vajzat e kësaj shkolle, që kishin ardhur nga vise të ndryshme të Shqipërisë, bashkë me nxënëset e tjera të qytetit dhe shokët e shoqet e konviktit «Malet tonë», organizuan qëndresë të fuqishme kundër pushtuesve dhe atyre që i shkonin pas. Ato morën pjesë në demonstrata që në muajt e parë të pushtimit dhe më pas. Kështu nxënëset e djeshme të shkollës «Donika Kastrioti» kujtojnë demonstratën e 28 Nëntorit 1941. Në Ditën e Flamurit fashistët me demagogji organizuan një miting, të cilin vajzat trimëresha e kthyen në demonstratë kundër tyre. Ato protestonin dhe aty për aty improvizonin vargje e parulla kundër armikut pushtues e tradhtarëve.

Ndër aksionet e para ishte edhe demonstrata e fuqishme e organizuar në shkurt të vitit 1942. Sipas planit të bashkërenduar mirë nga shokët e Partisë, mitingu fashist i organizuar në kinema «Rozafat» të qytetit, dështoi plotësisht. Në sallë ishin futur punëtorë, nxënës etj. Sa filloim bledhja vërtuan parullat kundër fashizmit, që u pasuan me fishkëllima e trahje këmbësh.

Nga kinemaja, demonstruesit me flamur e parulla kaluan në rrugët e qytetit. Me ta u boshkuan turmat e popullit. I gjithë qyteti buçiste nga zjarri e këngët për liri. Nisi pérleshja. Në vijën e parë ra punëtori Vaso Kadija. Që të nesërmen filluan hetimet e arrestimet. Mjaft vajza u morën në pyetje, u përjashtuan nga shkolla, u burgosën, por, asnjë nuk u tërhoq nga rruga e drejtë.

Kemi në duar disa nga fotografitë e asaj demonstratë. Kuadrot e rrallë e të heshtur flasin aq shumë për ato ditë të djemve e vajzave guximtare. Me duart e tyre të njoma duket sesi janë rrokor fytazi me policinë. Mënyra sesi qëndrojnë në fotografi të duket se nuk bëjnë asnjë hap prapa në kërkësat e tyre e megjithëse të paarmá-

tosur duken, më trima, më guximtarë, më të vendosur sesa armiku që mban armët.

Më 24 nëntor u krijuat aktivitati i të reja veprave komuniste, ku në mes shqesh të tjera, bënë pjesë edhe 22 vajza konviktore të shkollës «Donika Kastrioti». Veprimtaria revolucionare shtohet edhe më shumë. Me porosinë e Partisë ata përgatitën e shpërndanin trakte, e komunikata, sabotonin veprimtari politikë e kulturore të pushtueseve fashistë etj. Vajzat e kësaj shkolle iu përgjigjën njëzëri thirrjes së Partisë e të Atdheut dhe u hodhën në aksione. Vasfije Selamiku, ish-nxenëse në ato vite e sot mësuese, kujton një prej aksioneve të organizuara. «Vajzat, të revoltuara nuk u bindeshin kërkesave të drejtuesve fashiste të shkollës, prandaj të organizuara nga Qarku i Partisë për Shkodrën, vendosën që drejtoresha italiane, të largohej, me çdo kusht, nga shkolla jonë. U pasua fjalë vesh më vesh që të gjithë të rejat të nesërmendnuk do të bënë mësim. Ishte 4 shkurt 1943. Në klasën tonë hyri mësuesja e italishtes, hoqi gjyzlyket dhe u drejtua nga klasa. «Gati, vajza, do të fillojmë mësimin». Vajzat në shenjë proteste menjëherë iu përgjigjën fjalës së saj me të trokitura pene e me fjalët: — «Nuk duam të bëjmë mësim». Në korridor dëgjohej zhurmë e klasave, të tjera, ku edhe ata, si ne, protestonin për të përjashtuar drejtoreshën italiane. Më vonë në oborrin e shkollës u grumbulluan të gjitha nxënëset duke kënduar këngë atdhetare e revolucionare. Oborri i shkollës ishte mbushur me karabinierë e me nxënës të shkollave të tjera; që kishin ardhur për të demonstruar së bashku me ne. Shkolla u mbyll për disa ditë. Drejtoresha italiane u detyrua të largohej».

Kujtojnë me mall e krenari Vasfija e shqet e saj, vajzën trime, të zgjuar e të shkathët,

Shejnaze Juka. E kanë njohur nga afër e kanë pasur në klasë, së bashku kanë biseduar për shumë e shumë gjera, kanë zhvilluar veprimitari revolucionare, kanë ëndërruar për të ardhmen. Sot shkolla mban emrin e shoqes së tyre, të Heroinës së Popullit Shejnaze Juka. Shejnaza u nda nga gjiri i luftëtarëve për liri në lulen e rinisë. Ajo jetoi pak vite, por pati një jetë të madhe. Shejnaza, aq e ëmbël, aq e dashur, luftoi me guxim e heroizëm dhe u bë e pavdekshmë.

Qershori vitit 1943. Lufta vazhdonte e fuqishme. Ishte fundi i vitit shkollor. Nxënësit përshëndeteshin me njëri-tjetrin. Ata nuk do të takoheshin më në këtë shkollë. Organet shtetërorë e mbyllën atë, mbasi ajo u kthye në një prapavijë të rrezikshme kundër pushtuesve e tradhtarëve të vendit. Nxënësit e nxënëset u larguan me mall, por plot optimizëm për rrugën e tyre të drejtë. Një pjesë e madhe e kësaj rinie shkollore si edhe mësuesit e tyre, mbushën radhët partizane e kudo që luftuan me armë në dorë nuk harruan kurrë shokët, shkollën.

Ne vazhdimisht kujtojmë me respekt ata që dolën nga dyert e kësaj shkolle e që ranë në fushën e betejës.

Çlirimt të Atdheut i falën gjënë më të shtrenjtë, jetën e tyre, shumë bij e bija, nxënës të kësaj shkolle. Në stendat e përhershme shikojmë portretet e asaj rinie të pavdekshme, Hajrulla Kastrati, Mësuesi i Popullit, trim e gjëmbël, komandant i njësiteve guerile, ushtar i papërkultur i revolucionit.

Salo Halili, njeri i gjëzuar, më buzëqeshje të thelle, shkruan edhe poezi. Detyrën e mësuesit e deshite shumë, ai ishte popullor, ndaj përvijën e Partisë u bë mësues në shtëpi, në lagje, në rrugë e kudo.

Shyqyri Haxhia, me pseudonimin Prushi, fjalëpak e punëshumë. Shtëpia e tij ishte bazë e luftës. Prushi nuk e shoi asnjëherë zjarrin kundër armiqve. Shyqyriu gjithnjë binte në mendime të thella, ai e shihte të ardhmen me optimizëm.

Xheladin Fishta, i qeshur e i afroëshëm. Një komisar i ri për rënинë. Ai nuk mundi të jepte mësim në shkollë, por nxënës të tij u bënë dhjetëra punëtorë, cirakë, fshatarë, që mësuan me aq pasion prej tij dashurinë për Atdheun, Partinë e popullin.

Eliaz Gjylbegu, njjeri i qetë, studiuës, kerkues e këmbëngulës, që s'kursonte asgjë për të ndihmuar shokët.

E lista mund të vazhdojë e gjatë, e gjatë, pa fund, sepse çdo vit i kësaj shkolle solli emra e forca të reja në luftën për liri, dije e arsim.

Çlirimi i Atdheut i hapi përsëri dyert e shkollës pedagogjike. Nga e kaluara u ruajtën vetëm traditat atdhetare-revolucionare. Për të gjitha të tjerat duhej filluar nga e para. Lufta e la Shqipërinë jo vetëm të prapambetur, por edhe të shkatërruar. Fronti i rindërtimit dhe i ndërtimit të vendit u bë një betejë e re.

Megjithë vështirësitet, mungesat, megjithë telashjet dëri dhe përbukën e veshjen e popullit, Partia nuk harroi për asnje çast arsimin, shkollën, diturinë. Eshtë kjo arsyjeja që kudo u ngritën shkolla dhe kurse kundër analfabetizmit. Në këtë luftë për arsim e dije. Shkolla Pedagogjike e Shkodrës ka dhënë kontributin e saj të çmueshëm. Me hapjen e konviktit e me ardhjen e nxënësve nga të katër anët e Atdheut, shkolla e zgjeroi shumë veprimtarinë e saj dhe transformimet rrënjosore ajo i bëri në cilësinë e në përbajtjen e mësimeve. Ato kishin të bënin në radhë të parë, me ndryshime botëkuptimore jo

vetëm në përgatitjen e nxënësve, por edhe në rolin e madh të arsimtarit, i cili do të conte fjalën e Partisë te qdë filiz i ri në Shqipërinë e çliruar, jo vetëm nga pushtuesit e tradhtarët, por edhe nga bota e vjetër dhe e mykur e rendit feudoborgjez.

Dëri në vitin 1952 pedagogjikja e Shkodrës vazhdoi veprimitarине e saj së bashku me Gjimnazin e Shtetit. Mbas kësaj kohe u nda më vete, e njojur si shkolla pedagogjike «Shejnaze Juka».

Duke qenë shkollë e përgatitjes së arsimtarëve, ajo ka luftuar, sipas mësimeve të Partisë për zberthimin e kësaj specifike duke krijuar përvojë të çmueshme në lëmin e pedagogjisë. Revolucionarizimi i jetës së vendit lidhet edhe me revolucionarizimin e shkollës sonë. Kjo ka të bëjë jo vetëm me punën që duhet bërë me kohëtivin mësues-nxënës, por edhe me perspektivën dhe të ardhmen e brezit të ri, ku pa dyshim fjalë e mësuesit, e komisarit të kuq të dritës mbetet e pashlyeshme.

Direktivat e orientimet e Partisë për shkolllën, ashtu si kudo në vendin tonë, gjetën terren të përshtatshëm edhe te nxënësit e arsimtarët e shkollës pedagogjike «Shejnaze Juka». Vendimet e plenumit të 8-të të Komitetit Qendror si dhe detyrat që shtroi Kongresi i 7-të i Partisë e venë shkollën tonë gjithnjë e më shumë në shërbim të ndërtimit socialist të Shqipërisë. Zbatimi i tre komponentëve: Mësim, punë prodhuese, edukim fiziko-ushtarak ka të bëjë, në radhë të parë, me vëtë përbajtjen dhe perspektivën e zhvillimit tonë, me rritjen e nivelit arsimor e kulturor të popullit, si edhe me edukimin me koncepte të drejta revolucionare për punën, mbrojtjen e Atdheut etj.

Të nisur nga këto detyra, edhe në shkollën

pedagogjike Shejnaze Juka» është përmirësuar struktura e mësimeve, janë ngritur në nivel më të lartë metoda e stili i punës së arsimtarëve.

Nxënës i shkollës pedagogjike «Shejnaze Juka» ishte edhe Heroi i Punës Socialiste, Ismet Sali Bruçaj. Ai vetëm disa muaj punoi si arsimtar, por shokët që punuan me të, nxënësit që ai i deshte aq shumë, panë në figurën e tij komisarin e pavdekshëm të dritës.

Shoku Enver Hoxha, në letrën që i drejton nxënësve dhe mësuesve të shkollës, për aktin heroik të Ismetit thotë: «Bashkë me familjen punëtore dhe patriote të Ismet Sali Bruçajt, për veprën e tij shembullore ndaj detyrës keni një të drejtë të ligjëshme të krenoheni edhe ju nxënësit dhe mësuesit e shkollës pedagogjike «Shejnaze Juka». Në shkollën tuaj, në gjirin tuaj, në gjirin e organizatës së Bashkimit të Rinisë së Punës të Shqipërisë shoku i juaj i paharruar Ismet u brumos me idealet e larta patriotike dhe revolucionare të Partisë.»

Në zbatimin e tre komponentëve, kjo shkollë vëmendje të veçantë i ka kushtuar edhe punës prodhuese të nxënësve në fabrika, uzina, koperativa bujqësore etj. Rol të madh në këtë drejtim kanë luajtur e lozin edhe aksionet e ndryshme të rinisë. Nxënës e mësues të kësaj shkolle kanë marrë e marrin pjesë e janë dalluar në ndërtimin e hekurudhave, në ngritjen e brezareve, në aksionet e ndryshme në ndihmë të bujqësisë etj. Për këtë flasin urdhrat e medaljet, flamujt e fletët e nderit.

Mjetet mësimore dhe baza materiale përbëjnë kushtet për rritjen e cilësisë së mësimeve dhe fitimin e shprehive të punës nga nxënësit.

Në dhomën muze të shkollës vizitori sheh dokumente, grafike, orendi e statistika që dësh-

mojnë edhe për arritjet e brezave të nxënësve e mësuesve të kësaj shkolle.

Në një dokument të vitit 1919 është shënuar inventari dhe baza materiale e normales së asaj kohe; ajo përbëhej nga një raft, një shkronjtore, tri tryeza, katër dërrasa të zeza, shtatë karrige, dy kambaleca për harta, një orë, katër varëse rrobash etj.

Sa ka ndryshuar koha! Shohim sot kabinetet e kësaj shkolle plot drithë e ajër. Ato ndihmojnë shumë për edukimin materialist të nxënësve, për lidhjen e teorisë me praktikën.

Vitet kalojnë, por koha e rinisë mbetet e pashlyer në kujtesë. Së herë që ish nxënësit e pedagogjikes ndodhen pranë kësaj shkolle ku kaluan djalërinë ndalen vetiu dhe i përshkön një mall krenarie, kujtojnë shoqet dhe shokët e rënë, rrugën e përshkuar jo pa rreziqe e flije, shohin ëndrrat e hershme qysh u bënë realitet dhe perspektivën e ndritur të së ardhmes.

Vitet kalojnë e kujtimet e shkollës sonë pedagogjike «Shejnaze Juka» shtohen e përhapen në të gjithë Shqipërinë. Ngado që shkon, deri edhe në fshatrat e zonat më të thella, takohesh me djem e vajza, që kanë nisur jetën e tyre nga dyert e kësaj shkolle për në detyrën aq fisnike të mësuesit.

E gjithë kjo të gëzon e të mbush me guxim kur mendon ato vite të shkuara, të largëta në kohë dhe të afërtë në kohë; kur mendon atë rrugë me tradita aq të nderuara të shkollës pedagogjike, të shkollës së mësuesve tanë, kur mendon atë punë të madhe që bëhet edhe sot e kësaj dite në nivele të larta për edukimin e njeriut tonë të ri, ndërtues i socializmit.

E gjithë kjo, sa shumë të frymëzon!

Shkodër, mars 1978

Krismat shqiptare në poligonet e Evropës

Këto shënime e meditime nisën të shkruhen gjatë punës për përgatitjen e një dokumentari televiziv dhe kur po grumbullonim të dhëna për qitëset tona të talentuara, na lindi një pyetje: Çfarë është qitja në vetvete? Sport? Pa dyshim që është sport, bile nga më të bukurit, më tërheqësit që njihet e preferohet, e që mund të ushtrohet nga njeriu në një periudhë shumë të gjatë të jetës, duke filluar nga vitet e fëmijërisë e deri sa të dalin thinjat e bardha.

Në botimet e ndryshme enciklopedike qitja përcaktohet si një nga sportet më të lashtë, zanafilla e të cilit nis në kohërat e betejave le gjendare të harkëtarëve guximtarë.

Edhe në vitet e historisë së hershme, të Ilirisë trime, heshtarët e shigjetarët sikundër edhe vrapiuesit e lundërtarët e shquar, kishin nderimet më të mëdha të shoqërisë. Për vetë kushtet e zhvillimit ekonomiko-shoqërór e për

domosdoshmérinë e mbrojtjes nga dyndjet e ndryshme, luftëtarët trima, stërgjyshërit tanë, që në vogëli e lidhën jetën e tyre me harkun, me armën.

Zbulimet arkeologjike tanimë kanë nxjerrë nga thellësitë e shekujve dhjetëra fakte e dokumentime të rëndësishme që bëjnë fjalë për aftësinë e mjeshterinë e rallë të të parëve tanë edhe në prodhimin e armëve. Por duhet thënë se për ne shqiptarët qitja, pushka, nuk ka personifikuar kurrë vetëm shënimin, sportin. Ajo ka qenë gjithnjë diçka më shumë, diçka, më e rëndësishme. Ajo ndofta si rrallë në vendet e tjera, ka qenë traditë beteje e heroizmi, ka qenë traditë lirie. Ajo gjithmonë ka pasur të pandarë në vetvete dashurinë për tokën, për vatanin. Dhe e gjithë kjo është trashëguar brez pas brezi, është ushqyer që në djep me qumështin e fëmijës, kur nëna bashkë me gjumin e ëmbël i uronte të birit:

«Të më bëhesh shenjtar i rrallë
Me armë ngjeshur, gjithmonë i parë».

E kështu është rritur biri i kësaj toke; mes luftërash duke ngopur gjoksin me tymin e betejave. Ai është bërë njësh me armën, njësh me pushkën. Shpesh ai ka qenë i pangrënë, ka qënë i pavesur, por armën e ka patur pranë, armën e ka patur ngjeshur.

Në shekuj, me shpatë e pushkë në dorë, ndoqi rrugën e historisë populli ynë. Ai nuk është shquar vetëm si shenjtar e si luftëtar, por kurdoherë ka qenë edhe trim e guximtar.

Le të kujtojmë për pak trimat kordhëtarë të Gjergj Kastriotit legjendar që me harqet e heshtat e tyre kositnin ushtrinë osmane.

Le të kujtojmë Mic Sokolin e trimat e tij që me huta e kapsolloqe bënë të heshtnin topat e artilerisë turke.

Po Çerçizin në Mashkullorë! Duke shtrënguar fort tytën e pushkës i jepte ultimatumin komandantit turk

*«Mylazim largo taborrë,
Leri djemtë e mi të shkojnë,
Se të kuq të bëj më bojë...»*

E tillë ka qenë historia, e tillë ka qenë rruaga e popullit tonë... E hyjnë në këtë histori qindra bij e bija të thjeshtë të popullit për t'u bërë pastaj të pavdekshëm.

Kalojnë vitet, por me respekt kujtojmë trimin guximtar, atdhetarin e flaktë Avni Rustemi, që me dy të shtëna rrëzoi përdhe, mu në mes të Parisit, tradhtarin Esat Toptani, që i kishëte aq borxhe Shqipërisë.

Po djaloshi guximtar Vasil Laçi! Në moshën 20-vjeçare nuk ju dridh dora kur ngriti nagantin mbi Viktor Emanuelin, perandorin nga Savoja, që lakmonte të fuste trojet shqiptare në Mbretërinë e Italisë.

Le të kujtojmë së fundi epopenë më të lavdishme, luftën për çlirimin e Atdheut, partizanët tanë trima me Enver Hoxhën komandant, që me armët e rrëmbyëra armikut e mësuani shkollën e qitjes grykave, pritave, llogorevë. Mijëra prej tyre dhanë jetën tytë më tytë e žjarr më zjarr me pushtuesit fashistë. Mbi truallin e kësaj toke, lanë luftëtarët tanë gëzhojat e betejave fitimtare, gëzhojat nga të cilat mbinë lulet e Shqipërisë së re. Me trimërinë e me pushkën e tyre, partizanët tanë, kishin marrë në shenjë

e kishin goditur për vdekje pushtuesit, shtypjen, varférinë.

Ne i ruajmë gëzhojat e këtyre betejave jo vetëm për nostalgji e në kujtim të të rënëve, por po të jetë nevoja me barot do ti mbushim përsëri e në beteja të reja, kësaj toke zot do t'i dalim si kurrë ndonjëherë në histori.

Çlirimi i Atdheut, ashtu si të gjithë sektorëve e degëve të zhvillimit ekonomik e kulturror, i hapi horizonte edhe sportit popullor. Edhe qitjes iu hap një rrugë e gjerë veprimi. Sot në mjaft poligone anë e mbanë Shqipërisë stërvitjen qindra e mijëra amatorë të këtij sporti të bukur.

Veterani e trajneri i palodhur Vehab Haxhiymeri, megjithëse ka vite që ka dalë në pension, nuk largohet dot nga qitja. «Njerëzit tanë, — thotë ai, — mund të mos i ushtrojnë të gjitha llojet e sporteve, futbollistë e volejballistë të gjithë mund të mos bëhen, por qitës i mirë duhet të jetë çdo shqiptar».

Mbi themelët e traditës së bukur popullore qitësit tanë, e sidomos qitëset tona, për të cilat do bëjmë fjalë në shkrimin tonë, duke u mbështetur në stërvitjen intensive e shkencore, për afro katër dhjetëvjeçarë kanë zhvilluar qindra takime e kampionate kombëtare, duke shënuar në rrathët e tabelave të qitjes precizion të nivelit të lartë. Jo vetëm kaq, por qitëset tona të talentuara kanë afro dy dhjetëvjeçarë që kanë zbritur në poligonet e ndryshme të botës e me zotësinë e tyre kanë tërhequr admirimin e speciaлистëve, trajnerëve e qitësve të njohur nga të gjitha anët.

Për të gjithë ne, amatorët e këtij sporti të bukur, ky është gëzim i madh, që lidhet me figurën e gruas shqiptare, me forcën e përgatitjen

e saj. Padyshim nuk mund tē lemë nē harresë se këto vajza, janë bijat e nënave tonë, që gjatë gjithë historisë, krahas me burrat, kanë mbushur rreshtat e luftëtarëve për liri e pavarësi. Janë bijat e Tringës e motrat e Norës së Ded Gjo Lulit, nga Kelmendi, që nē lulen e rinisë ngjeshën armët e zunë pozicion nē llogoret e zjarrit kundër pushtuesve tē vendit. Ato ishin luftëtarë e qitëse tē mrekullueshme.

Po përmendim një fakt ngajeta e këtyre trimëreshave. Në Kelmend, herë pas here, djemtë e burrat e dëgjuar për trimëri, pushkë e urti, mblidheshin nē lëndina apo grykat e përrernjve e gjuanin shenjën me pushkë. Ato ishin garra shumë tē bukura e populli i ndiqte me kënaqësi tē veçantë. Tregojnë së nē një nga këto festa erdhi mes burrave edhe Nora e re, e bukur. Ajo ishte nē prak tē martesës. Mori pushkën e gjuajti edhe ajo shenjën (një copë guri i vogël, i vendosur aq larg sa me vështirësi e dallonte njeriu me sy), por plumbi i Norës e ndau atë përgjysmë. Nuk është aspak për t'u çuditur që Norën e qindra gra tē tjera tē maleve tonë i ndeshim nē çdo hap tē historisë me pushkë nē dorë si luftëtarë trime, snajpere tē pashoqe nē vijën e parë tē betejës e tē luftës për liri.

Mendoam tē tregojmë diçka edhe për Shote Galicën, trimëreshën e Kosovës kreshnike. Kur mbushi tē 20 pranverat e u bë gruaja e luftëtarit tē dëgjuar Azem Galica, pajën e nusërisë, gjerdanin e fishekëve dhe pushkën, i ngjeshi krahëqafë ditën e martesës. Që nga ajo kohë e deri sa i sosi tē 12 vjetët e jetës së saj si luftëtar, Shota vdiq shumë e re, 32 vjeç, njoihu luftëra e beteja, ra nē përpjekje e pusi, doli nga rrethimi e i zuri pritë armikut aq shumë, sa edhe një gjeneral me përvojë do t'ia kishte zilinë.

Në të gjitha këto luftëra ajo u dallua si trimëreshë e pashoqe, komandante e pjekur e qitëse e mrekullueshme.

Për Shotën mund të flasim shumë, por deshëm të përmendim edhe një rast ngajeta e saj. Tregojnë se në korrik të vitit 1920 Shota, bashkë me Sherifen, vjehrrën e saj trimëreshë, u gjendën të rrëthuara në Galicë nga një batalion i ështrisë serbomadhe. Armiqtë menduan se dy gra, vetëm në kullë, do të tremben dhe u bënë zë të dorëzoheshin. Në përgjigje morën fishkëllimën e plumbave. Lufta u ndez e freptë për orë të tëra. Shota kishte një saktësi në qitje, sa që e vuri batalionin armik në panik të vërtetë. Të vrarët i fshihnin ferrave. Lufta bëri bujë të madhe. U ngrit në këmbë gjithë populli i krahanës. Armiqtë u gjendën kudo në pusi. Ndërkohë Shota çau rrëthimin e doli fitimtare.

Tringa, Nora, Shota e qindra gra të tjera të Sulit e të Gjirokastrës, të Dibrës e të Skraparit, të Vlorës e të Mirditës etj., që jetë i bëri qitëse në fushën e betejës, nuk erdhën si sportiste deri në poligonet e Evropës, por Evropa ua njohu krismat e armëve. Hordhitë barbare të të gjitha kohërave, që ju vërsulën vendit tonë, ruajnë mbi shpatullat e tyre edhe zjarrin që ndezën mbi to armët e bijve dhe të bijave të Shqipërisë. Sot në epokën e Partisë, pasardhëset e këtyre trimëreshave po e përsërisin rishtazi forcën e armëve si nënët e tyre. Ato kanë ardhur në garat e takimet ndërkombëtare të qitjes me forcën e guximin e trashëguar nga shekujt.

Ne duam të flasim e të tregojmë për disa prej tyre.

Ermira Dingu. Një emër shumë i dëgjuar në mes sportisteve shqiptare, por i njohur edhe në poligonet e vendeve të ndryshme të Evropës.

Dymbëdhjetë vjeçë erdhi në poligonin e qitjes të klubit «17 Nëntori». Ishte e mirë, e shkathët dhe... më e vogël se pushka. Njeriu në jetën e tij njeh shumë gjëzime, që krijojnë më vonë ato çaste të paharruara e që pastaj kujtohen me kënaqësi për tërë jetën. Në këto gjëzime për Ermirën bën pjesë edhe një fletë e vogël e tabelës së qitjes. Aty është marrë në shënim dhjeta e parë. Në tri të shtëna: dy nënta e një dhjetë. Ajo e palosi atë fletë me xhelozin, erdhi e ia tregoi njerëzve të shtëpisë, shoqeve.

E kështu rodhën vitet. Poligoni u bë për Ermirën shtëpia e dytë. Shpesh këtu merrte edhe librat e Universitetit, që të shfletonte diçka në kohën e pushimit... E pastaj përsëri qitje, lodhje, edukim i vullnetit e i vendosmërisë. Këtu në poligon Ermira u njoh edhe me qitësin Faik Basha, poligoni i lidhi për jetë. Familjes së re ju shtua më vonë edhe Erbini i vogël. Vitet do të kalojnë e ndofta dëshira e pasioni do ta sjellë që edhe ai të bëhet qitës, veç këtu do të ketë një ndryshim, për të do të ketë një privilegji të rrallë; ai me të drejtë mund të mburret se ka ardhur në poligonin e qitjes që 6 muajsh, kur e ëma e merrte ndonjëherë gjatë stërvitjes. Erbini, që tanë është mësuar me krismat, me tabelat, me pushkën, ka vendosur të bëhet edhe qitës.

Në dhjetëvjeçarin e dytë të jetës së saj si qitëse, Mjeshtja e merituar e sportit, Ermira Dingu po hyn me pjekuri profesionale. Ajo është shpallur disa herë rekordmene e vendit, fituese e Kupës së Republikës, ka qenë pjesëmarrëse e shumë takimeve ndërkombëtare dhe në çdo rast, ashtu siç u ka hije bijave shqiptare, është trenguar e vullnetshme, këmbëngulëse, me shpirt të lartë sakrifice.

Po përmendim një rast. Në vitin 1974 zhvi-

llohej në Zvicër Kampionati Botëror i Qitjes. Ekipi ynë i vajzave shkoi drejt e në stërvitje për t'u ambientuar me poligonin. Ermira, një nga pjestaret më me përvojë të ekipit nuk po ndihej mirë. Puna vajti sa të shtrohej në spital. Natyrisht mbi çdo gjë shëndeti, por edhe vija e poligonit s'duhej lënë bosh. Si të vepronë? Ajo mblohdhi forcat dhe pa dëshirën e mjekëve u radhit në poligonin e qitjes. Në 64 vende të botës me rrëth 200 qitëse në ushtrimin 1×60 pushkë me precizion, në largësinë 50 metra, zuri vendin e gjashtë, rezultat i kënaqshëm ky përrrethanat e krijuara. Si ekip në këtë garë Ermira së bashku me Tatjana Kalavacin dhe Vera Konomin zunë vendin e nëntë duke lënë prapa 55 vende të tjera të botës.

Dhe ja, në vitin 1980 u zhvillua kampionati evropian në Spanjë. Ermira Dingu në garën 1×60 pushkë me precizion shpallet kampione e Evropës.

Flamuri shqiptar ngrihet në shtizën e fitores duke u valvitur me krenari në poligonin Kontoblonko. Ai vâlvitej ashtu siç u valvit dikur në duart e trimave shqiptarë Asim Vokshi, Xhemal Kada, Ramiz Varvarica e dhjetëra të tjerëve që erdhën vullnetarë në brigadat internacionaliste për të mbrojtur me pushkë në dorë revolucionin, Republikën e re Spanjolle.

Qitësja e njohur dhe trajnere e klubit sportiv «Dinamo» Nazire Galanxhi, e cila që nga viti 1951, kur u zhvillua kampionati i parë kombëtar me pushkë luftarake e deri në vitin 1965, i ka pasur të gjitha vendet e para në të gjitha llojet e garave të qitjes, na flet me shumë passion për këtë sport. «Qitja është shumë e bukur, — thotë ajo, — por kërkon kalitje fizike, atletikë, shkathësi, gjimnastikë, edukim, vullnet. Por, veç këtyre, ka diçka specifike që nuk

e kanë sportet e tjera: qitja në momentin e zhvillimit të garës kërkon qetësi e gjakftohtësi të jashtëzakonshme fizike e shpirtërore». Duke biseduar gjatë me qitëset tona të talentuara edhe ato na theksuan vazhdimisht se ky moment psikologjik duhet vlerësuar shumë. Por asnjëherë nuk duhet humbur besimi, mprehtësia, guximi se përndryshe në çastin vendimtar krijojen vështirësi që duan shumë mund e përpjekje për t'u kapërcyer.

Ja si ndodhi një herë:

Në shtatorin e vitit 1979, në qytetin Frankfurt mbi Majn zhvillohej Kampionati evropian i qitjes. Ekipi ynë i femrave, simbas ditës së planifikuar, zuri vend në poligonin e qitjes për stërvitje. Vajzat shikojnë me vëmendje ambientin që të njihen e të fitojnë besim në vete. Aty përreth gjithçka ishtë e panjohur. Të tyret ato kishin vetëm pushkët e vendosmërinë për të dalë me sukses në këtë detyrë.

Në mes shoqesh zuri pozicion për stërvitje edhe qitesja e mirënjohur Eglantina Lalmi, spezialiste në garën 1x60 pushkë me prëcizion, 50 metër largësi. Si duket, ngarkesa emocionale, minuta hutimi, por plumbat në stërvitje nuk po i bindeshin dorës e syrit të saj. Vajza u shqetësuat, u shqetësua trajneri, shoqet. Si do të vente puna? Një pushkë të mos qëllonte mirë? Çfarë do të thotë kjo për ekipin. Për orë të tëra ajo do të rreshtohej nesër në mes pyeste veten. Si do të rreshtohej nesër në mes 60 qitesve nga më të dëgjuarat e Evropës? Për përpara ishte nata. Duhej qetësuar e fituar besimi, duhej shlodhur. Po ku ta merte Eglantina gjumin... tërë natën nuk mbylli sy. Poligoni i përfytyrohej si një fushë beteje. Ë mendja i shkonte te Shqipëria, te guximi e vendosmëria e njerëzve tanë.

Të nesërmen, me këto mendime në kokë e

në zemër, Eglantina Lalmi radhitet në poligonin e qitjes në ndërresën e dytë. Qitëset e kësaj garë ishin ndarë në tri ndërresa me nga 20 qitëse. Vështrimi dashamirës i trajnerit, bësimi tek pushka e te dora, kuraja e shoqeve, e gjithçka fillloj mbarë. Goditja e parë dhjetë, e dyta dhjetë, e treta dhjetë. Në 40 të shtëna vetëm 4 nënta. Rezultati më i mirë në atë kohë në ndërresë. Konkurentet po e ndienin dorën e fortë të shqiptares. Por... lodhja, shqetësimi, nata pa gjumë e kishin bërë të vetën. Vajza pothuajse e këpultur ngrihet nga pozicioni. Koha po ikte e çdo gjë mund të përfundonte pa rezultat. Atëherë trajneri, si komandant i mirë, ndërhyri me takt, por me vendosmëri të prerë. E kjo do të thoshte se fronti nuk duhej lënë bosh.

Vajza mori fryshtë e thellë, žunë përsëri pozicion për qitje e megjithëse për 20 fishekët e fundit i kishte ngelur pak kohë, vazhdoi garën. Katër goditjet e para jo mirë. Atëherë shtrëngoi armën, rroku mei sy shënjestrën e tabelës dhe me një fryshtë 16 të shtëna njëra pas tjetrës dhe rezultati 16 dhjeta në tabelën e qitjes. Një gjëzim i papërshkruar. Në 60 qitëse të garës vendin e katërt dhe si ekip së bashku me Ermira Dingun e Luljeta Harkën, gjithashtu vendin e katërt, duke lënë prapa shumë shtete e qitëse të Evropës.

Lindita, fëmija më e vogël e Safet Zeqos, u njoh me armën që kur ishte 10 vjeç. Babai i saj, Safeti, partizan i Brigadës VIII Sulmuese, oficer ëri sa doli në pension, sa herë që me kujdesin më të madh, do të pastronte revolverin në shtëpi, do të kishte mbi kokë Linditën. Ajo nuk i ndahej, ajo ishte shumë kurioze për armën, aq sa e futi në merak babain dhe bëri të jetë edhe më shumë i kujdeshëm. Lindita vazhdimisht e pyeste: Si luftonin partizanët? Çfarë armësh

mbanin? Sa larg i vrisnin armiqtë? Po unë mund të bëhem qitëse? E kështu pyetjet ndiqnën njëra-tjetrën e biseda zhvillohej e ngrohtë, e gjallë.

Dhe ja, me këto pyetje, me këto ëndërrime, Lindita Zeqo në moshën 15-vjeçare, me shokët e shoqet e klasës, zuri vend për herë të parë në poligonin e përgatitjes luftarake. Pushka ishte e rëndë dhe më e gjatë se vetë Lindita, ndaj dikush tha me shaka: «Të vimë ta mbajmë ne armën?». Vajza u skuq pak, buzëqeshi, por nuk u vuri vesh. Mbasi mbështeti mirë pushkën drejt tabelës, mori shënim dhe tërhoqi këmbëzën, ashtu lehtë siç e kishte mësuar babai dhe instruktori, por siç duket krisma e trembi, ajo mbylli sytë e s'pa asgjë. Plumbi se nga kish fluturuar ferrave. Në tabelë as shenja më e vogël. Vajza u turpërua pak, por nuk u dëshpërua. Mori përsëri fryshtë thellë dhe dy herë radhaci, dy dhjeta. Mbase rastësi. Mbase! Por kjo rastësi lidhej me një dëshirë të zjarrtë të Linditës për t'u bërë qitëse.

E kështu filloi puna, përpjekja, stërvitjet e vazhdueshme dhe ja, në moshën 20-vjeçare Lindita bëhet një nga qitëset e dëgjuara të vendit tonë dhe një konkurrente e denjë në garat ndërkombëtare.

Deshëm të tregojmë diçka edhe për takimin në Finlandë, që u zhvillua në maj-qershor të vitit 1980.

Në këtë takim miqësor, veç Finlandës, morën pjesë edhe shtete të tjera me përvojë në qitje, Anglia, Polonia, Kanadaja, Suedija, Norvegjia etj.

Ekipet tona, si i meshkujve, ashtu edhe ai i femrave i zhvilluan garat me nivel të kënaqshëm, zunë disa herë vendet e para dhe morën me vete entuziazmin e dashamirësve të shumtë finlandezë. Por ajo që tërhoqi më shumë vëme-

ndjen në këto gara ishte Lindita jonë. Në të gjitha takimet u tregua e gjallë, e shkathët dhe e vendosur. Në garën 1x60 me pushkë precision, që u zhvillua në qytetin e Pieksamaki ajo kishte në krah qitëse të talentuara si anglezen Margaret Thomson, me mbi 20 vjet përvojë në takimet e ndryshme në poligonet e botës, që jep intervista e deklarata në televizion e radio. Por edhe Linditës sonë nuk i dridhet dora e nuk i trembet syri. Gara fillon e rreptë, krismat ndiqnin njëra-tjetrën, dhjetat mbushnin tabelat e qitjes. Po kush do të grumbullonte më shumë pikë? Juria bën vlerësimet. Qitësja jonë, më e reja nga konkurrentet e garës, zë vendin e parë me 593 pikë nga 600 të mundshme.

Lindita është e qeshur, e lumtur, ajo përaqfohet me shoqet, me trajnierin. Dhe ja, mes gjithë këtij gjëzimi, asaj i dorëzohet kupa e kristaltë si sportisja më e mirë e gjithë veprimtarisë.

Duke i dorëzuar çmimin e lartë, qitëses sonë të talentuar, kryetari i federatës së qitjes të Pieksamakit tha me dashamirësi: «Ne dëshironim e besonim që këtë vend nderi ta zinte ndonjë nga qitëset tona. Megjithatë jemi të kënaqur që e merituat pikërisht ju shqiptaret, sepse jeni vajza të talentuara».

Tregimin tonë për qitësen tjetër të re e me perspektivë Diana Mata jemi të detyruar ta fillojmë nga familja e saj. Kjo familje përbëhet nga 7 vetë të rritur. Gjashtë prej tyre, duke filluar nga babai, Ali Mata; dy vëllezërit Skëndëri dhe Leonardi, dy nuset, Mariana e Alma si dhe Diana janë qitës e pjesëmarrës në kampionate e gara të ndryshme të vendit tonë. Kjo me të vërtetë është një gjë e rrallë, jo psë në familjet tona nuk njihet e nuk çmohet qitja, po këtu bëhet fjalë për aq qitës në një shtëpi, sa

që mund të organizohet, me shumë interes, një kampionat i vogël familjar. Në krye të këtyre qitësve vendi i nderit do t'i takojë gjithnjë baba, veteranit të qitjes së familjes e të vendit tonë, trajnerit të palodhur e të pasionuar të klubit «17 Nëntori», komunistit Ali Mata.

Jeta e tij, që ka kapercyer gjysmën e shekullit, që në moshën më të re ishte lidhur me pushkën. Për Aliun të marrësh nishan mirë, të godasësh me një të shtënë dhjetëshen në tabelën e qitjes, do të thotë të jesh rojë e guximshme e lirisë, e punës dhe e ndërtimit socialist të Shqipërisë.

— Urdhëroni, — thotë Aliu — shikoni, këto janë poligonet. Këtu çdo ditë vinë qindra qitës, që nga 10-vjeçarët, e deri te veteranët. Të gjithë duhen ndihmuar, por sidomos fillestarëve, u duhet ndenjur më pranë.

Për të tëra këto trajneri mban shënimë të rregullta; evidenton të dhënat, studion rezultatet në rritje, nxjerr përfundime për të ardhmen.

Diana, qitësja më e re e familjes Mata, që e vogël erdhi në poligon me babain, erdhi pa ndrojtje, sepse kishte dëgjuar shumë edhe për qitësit edhe për armët. Ajo njihte me emër kampionët, Mjeshtrit e merituar, por dëshira e saj ishte të njihej me rekordmenën e vendit, qitësen e talentuar Elizabeta Karaboli. Bile kjo dëshirë ndofta e shtyri atë që të provonte forcat si partnere në garat e saj. Dhe ja, puna, disiplina, këmbëngulja në stërvitje e solli shumë shpejt, që ato të jenë bashkë, në një vijë zjarri, si shoqe e si bashkëluftëtare. Rezultat i këtij bashkëpunimi ishte edhe fitorja e paharuar në Kampionatin Evropian që u zhvillua në qytetin Frankfurt mbi Majn ku Elizabeta, Diana dhe Margarita Cinga, u shpallën si ekip, në garën e

bukur, por edhe të vështirë Siluetë 30+30, 25 metra largësi, nënkampion i Evropës.

Nuk do të quhej tregimi ynë i plotësuar për familjen Mata po të mos flisnim diçka edhe për Myzejenin, nënën e Dianës, e vetmja pjesëtare e familjes që nuk është qitëse, por që ka pasion të jashtëzakonshëm për këtë sport. Edhe ajo i njeh të gjithë kampionët e rekordmenët e vendit. Ndjek të gjitha garat e lajmet për qitjen. Diana thotë me shumë ngrohtësi: «Mamaja është frymëzuesja jonë. Ajo është e mirë dhe e dashur si të gjitha nënati, por duke qenë edhe admiruese e qitjes sikur e plotëson edhe më mirë «ekipin» tonë familjar».

E për cilën rekordmene apo qitëse të talentuar nuk ke ç'të flasësh në shkrimin tonë. Por ato janë aq shumë, e kanë në jetën e tyre aq fakte e ngjarje interesante, sa që mund t'u hapin shumë punë e mund të shkruhen edhe vepra me vlerë nga shkrimtarët tanë.

Ja, Vera Konomi, pjesëtare e klubit sportiv «Dinamo». Pasioni e solli atë në poligon aty nga viti 1970. Në konkurimin e saj të parë hyri në vitin 1971. Ishte e vetmja qitëse në mes 15 djemsh dhe doli fitimtare, zuri vendin e parë në garën 1×40 pushkë me ajër duke vendosur edhe rekord të ri kombëtar.

Liri Beqja, përfaqësuese e klubit sportiv «Dajti». Në sport erdhi si pjesëtare e ekipe të radioamatorëve, por shumë shpejt u dashurua mbas qitjes. Sot është rekordmene e vendit në garën 1×60 pushkë me precizion me 597 pikë nga 600 të mundshme. Ky rezultat është vetëm një pikë larg kampionit të botës.

Aishe Selmani, edhe kjo e klubit «Dajti». Nënë me fëmijë, por qitjes nuk i ndahet asnjeherë.

Luljeta Harka, e «Tomorit» të Beratit, par-

tnere e sigurtë e ekipit kombëtar. E mprehtë dhe e kujdeshshme.

Por sa emra të tjera mund të radhisim këtu. Dhjetëra e dhjetëra qitëse të talentuara që punojnë e stërviten anë e mbanë atdheut tonë. Mjaft prej tyre janë ende të reja e me pak përvojë, por në një kohë të shkurtër jo vetëm kanë ngritur lart rekordet e qitjes në vendin tonë, por janë bërë të njohura në shumë vende të botës. Ndaj nuk është e rastit që gjatë takimeve ndërkombëtare sportistët e huaj, admiruesit e qitjes, trajnerët u bëjnë shumë pyetje vajzave tona:

— E duan sportin e qitjes në Shqipëri? Ka shumë qitëse shqiptare? Po nënët tuaja kanë qenë qitëse?

E vajzat tona u përgjigjën thjesht e me përzemërsi: «Po, në Shqipëri e duan shumë qitjen. Edhe nënët tona kanë qenë qitëse, kanë qenë luftëtare, partizane».

Po, qitëset tona janë bijat e nënave partizane e atdhetare, fotografitë e të cilave, të fiksuarë në kohën e luftës, me veshjen partizane e armët ngjeshur i ruajmë në muret e shtëpive tona apo edhe në stendat e muzeve si kujtime të paharruara.

Já një fotografi e Zonja Çurres. Ka dalë këtu e re, 20-vjeçare. Kush nuk e njeh këtë në Shqipëri? Partizane trime. Nga gjërat e para që njohu në jetë ishte pushka. Me të ajo lidhi fëmijërinë e rininë e saj. Me të luftoi pushtuesit. Me të, duke luftuar dha jetën zjarr pér zjarr kundër snajperëve të përgatitur në shkollat e vdekjes.

Po sa ishin si Zonja Curre, që në ato vite të vështira u ngritën në këmbë e rrokën armët pér çlirimin e Atdheut! Ishin mbi 6 mijë nëna e motra shqiptare, të cilave nuk u dridhej qer-

piku i syrit e këmbëza e pushkës kur godisnin objektivin: armikun. Ato nuk erdhën për gara qitjeje deri në poligone, por sot bijat e tyre po e mahnisin Evropën. Një ndër këto është edhe kampionia e Evropës Elizabeta Karabolli.

Ajo si qindra e mijëra bij e bija të Shqipërisë së lirë socialiste nuk e ka njojur shtypjen, varfërinë e nënshtrimin. E gjëzuar në mes dashurisë së prindërve, shokëve e shoqeve, të shkollës e të Pallatit të pionierëve hyri në rrugën e jetës me pasion të veçantë për violinën. Pesë vjet rresht nuk iu nda muzikës. Në shtëpinë e thjeshtë e të gjëzuar të Karabollajve deri natën vonë fluturojnë tingujt e bukur të këngës.

— E po fat i madh, — thanë babai, Tare Karabolli, oficer i Ushtrisë Popullore dhe mama e Dylbere Karabolli, — që njerën nga të dy vajzat do ta kemi muzikante, violiniste.

Por ja që në jetë ka të papritura, ka kthesa të forta, ku njeriu befasohet me horizonte krejt të reja, të panjohura por që pastaj e rrëmbejnë edhe e frymëzojnë atë për rrugë të pa shkelura. Kështu ngjau edhe me Elizabetën. Ndonfta është rast i rrallë, por në poligonin e qitjes të klubit sportiv «Partizani» ajo erdhi krejt rastësisht, erdhi sa për të shoqëruar një të njojurën e saj që ushtrohej në qitje me pistoletë.

Dhe ja këtu, mes këtyre krismave, tabelave, fletëve të qitjes që ngjallnin zhurmë e diskutime mes qitësish e trajnerësh, Elizabeta e vogël 13-vjeçare po ndiqte me vështrimin e saj plot habi pistoletën, qitësit, pozicionet në ushtrimet e ndryshme e gjithçka iu duk interesante, e bukur, frymëzuese.

Trajneri Rexh Ndreu, që po shikonte me vëmendje kuriozitetin e vajzës së vogël, ju afroa me shumë dashamirësi dhe e pyeti:

— Ke qenë ndonjëherë tjetër në poligon?

— Jo.

— Ke bërë ndonjëherë qitje?

— Jo.

— Na, merre pistoletën. Shiko me vëmendje tabelën, merr nishan mirë, mbushu me frymë, tërhiq këmbëzën pa e ndjerë e, me sukses.

Dhe ja krismat e para, rezultatet premtuese vendosën ta ndajnë Elizabetën përkohësisht nga violina. Në fillim, në shtëpi u diskutua gjatë,

— Vajza është e re e duhet ndihmuar për të zgjedhur rrugën e jetës, — thoshte i jati.

— Të bëhet si të jetë më mirë, — thoshte mamaja.

Mbas këtij diskutimi familjar, stërvitja filloj e rregullt dhe e fortë. Veç orëve për përgatitjen e mësimeve, gjithë kohën tjetër të lirë Elizabeta e kalonte në poligon. Trajnerët që në fillim i kushtuan vëmendje të posaçme përgatitjes fizike, atletike, fitimit të shkathtësisë. e imprekëtësisë.

Dhe ja vetëm mbas pak muajsh në kampionatin kombëtar të të rinjve në vitin 1974, qitësja e re u radhit në poligon si përfaqësuesja e klubit «Partizani», në ushtrimin pistoletë ajër 1×40 . Tabela goditet për 40 herë rresht me mjaft mjeshtëri. Kështu ajo zë vendin e parë duke vendosur edhe rekord kombëtar. Një ditë më vonë, në qitje të lirë me pistoletë 1×30 përsëri po të njëjtin sukses.

Elizabeta tani bëhet e njojur. Për talentin e saj filluan të shkruajnë gazetat, revistat, të flitet në emisionet e Radios e të Televizionit.

Dhe ja, Romë 1977. Kampionati evropian i qitjes. Elizabeta, partnerja më e re e garës $30+30$, hyri disi e ndrojtur dhe pa rënë shumë në sy në poligonin e qitjes. Merr nishan dhe

në dy etapat e garës arrin kuotën e 584 pikëve. Sukses i kënaqshëm. Vendin e tretë në klasifikimin individual. Shtypi i huaj sportiv, lajmet e zhurmshme bëjnë të ditur me tituj të dukshëm se një qitëse e re shqiptare e imtë dhe fjalëpak, nesër do të jetë konkurrente e fortë për titullin kampion të Evropës. Dhe në të vërtetë ata nuk ishin gabuar.

Finlandë 1978. Përsëri Kampionati evropian e përsëri për krah qitëseve më të mira të mbi 20 vendeve, Elizabeta jonë, tanë më e njojur. Në garën $30+30$ realizon 586 pikë, duke zënë kështu vendin e dytë në klasifikimin individual.

Sukseset në garat e takimet ndërkombe të, përgjegjësia para sportit shqiptar dhe para Atdheut e bënë Elizabetën edhe më të vëmendshme, më këmbëngulëse e më kërkuese për një stërvitje sa më shkencore. Me punë të palodhur dhe me besim në vetvete ajo u ngrit edhe në tribunën e plenumit të Komitetit Qendror të Rinisë në vitin 1978, ku bëhej fjalë për edukimin politiko-ushtarak të rinisë si forcë e madhe për mbrojtjen e Atdheut, dhe foli thjeshtë, por mori një zotim të madh.

— Do të luftoj që në Kampionatin e ardhshëm evropian të zë vendin e parë në garën time.

Tërë ato ditë mbas kësaj ajo u mendua shumë. «Mos bëra gabim, — thoshte me vete. — Po sikur të mos e realizoj premtimin e dhënë?» Kjo e vuri para një përgjegjësie të madhe.

Dhe ja erdhi shtatori 1979, në qytetin Frankfurt mbi Majn të Gjermanisë Perëndimore, përsëri në Kampionatin evropian. Elizabeta Karaboli me pistoletën e saj besnikë merr shënim në tabelën e qitjes. Vëmendja e fotoreporterëve, operatorëve, gazetarëve e komentatorëve të sportit nga e gjithë Evropa ishte përqendruar edhe

te dora e saj. Në gjysmën e parë të garës, në qitje pozicionale, me 30 të shtëna ajo merr 288 pikë. Rezultat i kënaqshëm, por gjithçka do të vendosej në gjysmën tjetër të garës.

Të nesërmen Elizabeta qëndron përpara tabelës e heshtur dhe e përqendruar. Silueta e figurës, simbas rregullores, dukej para qitëses për 3 sekonda, kohë në të cilën duhej bërë qitja, e pastaj figura do të dukej përsëri pas 7 sekondash. Qitësja jonë tërheq e sigurt këmbëzën e pistoletës dhe 29 dhjeta rresht njera mbas tjetrës, vetëm një nëntë. 299 pikë nga 300 të mundshme. Sukses emocionues dhe i padiskutueshëm. Në të dy garat bashkë 30+30 ajo arrinte 587 pikë. Vendi i parë në Evropë.

Në poligonin e Frankfurtit, mes pyjesh të lartë, ngrihet në shtizën e fitores flamuri kombëtar i Shqipërisë e tingujt e hymnit të Atdheut tonë buçasin me krenari. Në fytyrat e pjesëtarëve të ekipit tonë lotët e gëzimit mbushin sytë. Dhjetëra qitës e qitëse, qindra dashamirës të vendit tonë gëzojnë me ne për këtë fitore.

Kjo ishte një dhuratë e bukur në prag të 35-vjetorit të Çlirimtës së Atdheut. Elizabeta e mbajti fjalën.

Dhe ja një kujtim i paharruar. Viti 1979. është Spartakiada IV Kombëtare, me rastin e 35-vjetorit të Çlirimtës. Në tribunë shoku Enver Hoxha dhe udhëheqës të tjerë të Partisë e të Shtetit, në mes tyre Elizabeta, kampione e Evropës. Janë çaste këto të paharruara përtër jetën.

Për sportin e qitjes, ndofta si rrallë përsportet e tjera, shkrimet publicistike, reportazhet e telereportazhet duhet t'i mbajnë të hapur paragrafët, sepse në çdo garë apo kampionat, ta-

kime ndërkomëtare etj., lindin emra e fakte të reja që flasin për ecje drejt rezultateve më të larta evropiane e botërore në këtë sport të bukur.

U ndalëm në shënimet tona e treguam disa copëza të shkëputura nga jeta plot vrull, nga stërvitja, nga fitoret e qitëseve tona të talentuara. Po këto janë vetëm disa copëza, sepse të gjitha këto gra e vajza të mrekullueshme janë edhe punëtore të mira, nxënëse të dalluara, inxhiniere, ekonomiste e projektuese të zonjat, që marrin pjesë gjallërisht në ndërtimin e socialistimit.

Populli ynë trim e punëtor e ka dashur dhe e do sportin e qitjes. E do dhe është lidhur me pushkën, sepse me sýrin në shënjestër ai ka vrojtuar shekujt, me gishtin në këmbëz ka mbrojtur e mbron lirinë e pavàrésinë.

Edhe sot ne s'ia kemi kujt me të pabesë, por po ta lypë nevoja jo vetëm burrat, por çdo nënë apo vajzë shqiptare, ashtu si në Luftën për çlirimin e Atdheut, do të bëhet rojë e çdo pëllëmbe tokë të Shqipërisë socialiste.

Tiranë, 1980

Tërmeti tundi malet por jo zemrat tonë

Ishte pranvera e 35-vjetorit të çlirimt të Atdheut. Gonxhet e luleve e gjethet e njoma lodronin në flladin e bukur të ditëve plot diell e ngrohtësi. Kishin ardhur ato ditë te ne nga gjëmimet e luftrave e betejave të viteve të zjarrta për liri, e kishin hyrë në çdo vatër shqiptare ashtu të bukura, plot punë e përpjekje, plot gaz e hare... I duam ditët tonë që ngrohin tokën tonë, këtë tokë të shtrenjtë që na e lanë gjyshërit e stërgjyshërit tanë, e që ne, përmes grykës së pushkës e bëmë të lirë e të pavarur, këtë tok që jeta socialiste e përtërin...

Por, ka ditë në të cilat fatkeqësitet e natyrës lënë gjurmët e veta. Një ndër to ishte 15 prill 1979... ora 7.19 minuta. Një tërmët i fuqishëm goditi vendin tonë.

Agjencia Telegrafike Shqiptare dhe organet e tjera të shtypit e të Radiotelevizionit bënин të ditur se goditja e këtij tërmëti ishte shumë e

fortë. Ajo u përhap si jehonë tronditëse, me lëkundje të çrregullta dhe me intensitet 8 ballë të shkallës Merkali. Më rëndë u prek zona e poshtme e lumit të Bunës, duke dëmtuar e shkaterruar shumë fshatra të rretheve Shkodër e Lezhë, si Dajçin, Oblikën, Velipojën, Bushatin, Barbullushin, Mqedën, etj. Dëme të ndjeshme pati edhe në rrethet Mirditë, Dibër, Krujë, Mat, Pukë e Tropojë. Nga ky tërmet gjetën vdekjen 35 vetë dhe u plagosën afro 400 të tjerë. Si rezultat i kësaj vale goditëse të befasishme, u shembën dhe u dëmtuan mbi 17 mijë shtëpi dhe objekte ekonomike e shoqërore.

Atë ditë prilli, fshatra e zona të tëra u kthyen në gërmadha. Nga kjo fatkeqësi, afro 100 mijë banorë mbeten pa strehë, numër ky i barabartë me popullsinë e qyteteve Fier e Durrës të marrë së bashku... Dhimbja për ata që humbën jetën në këtë ngjarje të rëndë ishte e madhe. Humbjet e tjera llogariten me miliona lekë. Por historia, luftrat e betejat na kanë mësuar ta kthejmë dhimbjen në forcë, fatkeqësinë në guxim, hidhërimin në burrëri.

«Tërmeti e bëri të vetën. Tani e kemi fjalën ne! — thanë njerëzit e kohës së Partisë, njerëzit e punës e të guximit, — e kemi fjalën ne, të luftojmë, të dalim fitimtarë edhe kësaj radhe, ashtu siç kemi dalë mbas çdo beteje».

Telegrami i Komitetit Qendror të Partisë dhe i Këshillit të Ministrave drejtuar popullsisë së rretheve Shkodër, Lezhë dhe zonave të tjera të dëmtuara nga tërmeti ishte kushtim që ngri ti në këmbë të madh e të vogël. Shtypi e Radiotelevizioni vinin pas me shkrimet e shumta, jo për të derdhur lot, por për mobilizim të parë, që me forcat e veta të organizohej kudo puna për zhdukjen e pasojave të rënda. Janë orët

e para pas tërmetit. Toka lëkundet akoma. Goditje të tjera më të lehta, kohë mbas kohe ndjekin njera-tjetrën. Por komunistët, tamam si në kchën e luftës, shkojnë shtëpi më shtëpi, japid udhëzime, ndihmojnë të plagosurit, sigurojnë fëmijët. Po, ashtu si në betejë u ngrit në këmbë populli, që kishte dalë atë ditë në aksionin pranveror të bujqësisë, për të shpëtuar njerëzit që ndodheshin nëpër shtëpira. Na treguan dhjetëra raste të guximit e të vëtmohimit kur njerëzit tanë, rinia, ushtarët trima hyjnë përmes rrënojave për të shpëtuar pleqtë, fëmijët, për të nxjerrë të plagosurit, pa llogaritur se mbi ta nga çasti në çast mund të shëmbeshin muret e çatitë e varura të shtëpive.

Ky është solidariteti ynë socialist, këto janë normat e reja të moralit komunist, që Partia ka edukuar dhe edukon te njeriu ynë i ri. Kjo është vepra më e madhe e më e vyer e Partisë, që ngrihet mbi të tjerat si monument i të gjitha kohrave.

E si të mos jetë kështu, kur me fjalën e Partisë, nga të katër anët u nisën kamionët me ushtarët e popullit, sokolat e palodhur, që shkonin nga zona në zonë, zbrisnin në oborrin e shtëpive të dëmtuara rëndë nga tërmeti, ngrinin çadrat me shpejtësi, futnin brenda pleqtë, fëmijët e pa arritur mirë as të njihen, as t'ua mësojnë emrat njeri-tjetrit, përshëndeteshin si të ishin miq të vjetër, si të ishin pjesëtarë të një familjeje e pastaj, ashtu me nxitim, vazhdonin rrugën për në fshatra të tjera, për në shtëpi të tjera.

E si të mos jetë kështu kur vetëm pak orë mbas tërmetit, njerëz të ndryshëm, banorë të Shkodrës vijnë dhe paraqiteshin në Komitetin e Partisë e thonin thjeshtë, pa fraza e zbukuri-

me: «Jemi gati më dy-tre vetë të rritur të familijes të shkojmë ku të shihet e arsyeshme përtë ndihmuar në zhdukjen e pasojave të tërmetit». Në tryezë lenë adresën e shtëpisë dhe të qendrës së punës.

«Jam plak dhe i sëmurë, — tha një burrë mjaf i moshuar, — e takati nuk më premtion që të ndihmoj me ndonjë gjë atje në frontin kryesor, por ja, kam marrë me vete librezën e pensionit, shënoni emrin e numrin e mbani lëkët e një muaji. Unë e di, të gjitha ndërtimet do të bëhen me shpenzimet e shtetit, po mua kështu ma do zemra».

Erdhi në Komitetin e Partisë edhe pensioni i Haki Durra, Hero i Punës Socialiste, shofer i palodhur që vite me radhë mbarti mbi udhët e Atdheut mijëra e mijëra tonë mallra, materiale ndërtimi, makineri e ku t'i përmendim të gjitha. «E ndiej se mund ta mbaj përsëri timonin, shikojeni kërkësen time. Megjithse në moshë të thyer, nuk do t'ju turpëroj.»

Një nënë, që i ishte bërë shtëpia njësh me tokën, i thanë se po vinin shokët e Partisë e të qeverisë nga Tirana. «Mirë se të vijnë, — u tha ajo, — por ata kanë qenë gjithnjë këtu, Partinë e Qeverinë e kemi pasur edhe e kemi pranë gjithmonë. Ajo ka qenë këtu me ne, në zemratona, në gjakun tonë, në ditë gëzimi e hidhërimi.»

— Do t'i bëjmë shtëpitë edhe më të bukurë, edhe më të mira, të grupuara, tamam fshat socialist, — u thonë shokët e Partisë. — Aty çdo gjë do të jetë e sistemuari, me urbanistikë, me shkollën, me kopështin, me vatrën e kulturës, me rrjetin e tregtisë dhe të gjitha shpenzimet për këto do të përballohen nga shteti.

— Po a do të jenë të forta, — pyet dikush

andej nga fundi, — jo pse trembemi, por që tē mos na shkatérrohen më?

— Të forta do tē jenë, antisizmike, me tulla e brez betoni — u përgjigjen drejtuesit.

Njerëzit gjallérohen, buzëqeshin me optimizëm e kështu mbledhja vazhdon gjatë, e marrin fjalën me radhë gratë, rinia, secili ka diçka për tē thënë.. Mbledhjet e takimet e tillë, bisedat e përzemërtë kishin një forcë tē brendshme më tē fuqishme se tërmeti, e cila i mobilizonte, i frymëzonte dhe e bënte plakun tē ri e tē riut i jep krahë.

Kur shikon gjithë këtë punë e përkrahje tē madhe njeriu pa dashur hedh vështrimin në tē kaluarën. Në kohë tē tjera, me këto dëmtime kaq tē mëdha, njerëzit për vite tē tëra do tē ngryseshin me dhembje. Gërmadhat, si një varri i hapur, do t'u kujtonin qdo ditë mjerimin. Nëma më e rëndë për ta do tē ishte «e gjetshi si në tërmet».

Pa dashur tē bëjmë histori, u munduam tē mbledhim diçka për tërmetin, që kish rënë dikur në qytetin e Shkodrës e në zonat përreth tij. Shkuam edhe në fototekën e Shkodrës, ku për vite me radhë po bëhet punë e vyer për sistemin e dokumentacionit tē gjerë fotografik, me interes për studime tē ndryshme. Meritë e veçantë i takon në këtë punë fotografit tē talentuar e tē pasionuar Geg Marubit dhe familjes së tij, që për vite me radhë fotografuan e ruajtën me kujdes negativet për fotografi tē mjaft ngjarjeve në vendin tonë. Në to janë shënimet e asaj ngjarjeje tē rëndë për Shkodrën e zonat e tjera. Fotografi nuk është më në mes nesh, por ne do tē ruajmë si kujtim tē paharuar atë punë tē shkëlqyer që bëri për fotografinë shqiptare. Dokumentet e botimet e pakta tē shtypit tē

asaj kohe, bëjnë të ditur se tërmeti ra më 1 qershori 1905, pra 74 vjet më parë. Edhe sot në Shkodër mbahet mend nga pleqtë, që i jetuan ato ditë si «Zerzelja e Shkodrës», e cila qe një katastrofë e vërtetë për popullin e këtyre zonave. Një fletore kishtare, që dilte në atë kohë në Shkodër, bënte të ditur në muajin gusht, pra afro dy muaj mbas ngjarjes, se «më 1 qershori në orën 6.5 minuta allafranga, sikur diftuan sahatat me vjerrëza që në atë kohë mbeten, Shkodrën e disa zona të tjera i kapi nji e dridhun e tmerrshme».

Tërmeti i vitit 1905 bëri shumë dëme, pati mjaft të vrarë, të plagosur dhe shumë shkatërrime.

Në ato ditë të vështira njerëzit mbeten pa strehë, pa ndihma, pa bukë. I vetmi kujdes i hyqymetit (administratës shtetërore të kohës) ishte dërgimi i një nepunësi të bashkisë, për të bërë regjistrimin e dëmeve. Kjo ishte si një shenjë se gjoja më vonë do të bënin diçka për të ndihmuar të dëmtuarit.

Bahçallëku është një lagje e vogël në të hyrë të Shkodrës. Një përkim që mbase lidhet me shtresat e tokës dhe valët goditëse të tërmetit, por si tani, në tërmetin e 15 prillit 1979 edhe në vitin 1905 Bahçallëku pothuajse u rrafshua me tokën. Kjo lagje ka një histori të lashtë. E vendosur këtu buzë Drinit dhe jo larg kalasë, ka parë në historinë e saj shekullore dyndje e beteja, është rrafshuar disa herë nga pushtuesit, tërmetet e përblytjet, por nuk është zhdukur, kështu ka qëndruar ajo përherë në rojë të ngjajeve historike të Shkodrës.

Në kohën kur njerëzit kishin mbetur pa strehë, pa ndihma, të braktisur e me banesat e shkatërruara, fletorja kishtare në numrin e pri-

llit të vitit 1905, si për ironi të atyre që mbetën rrugëve, botonte një artikull për kuptimin dhe prejardhjen e fjalës «Sabri» — Durim. Ja si shkruante ajo në atë kohë: «Sabri, pra durimi, është i nevojshëm për gjithkën, mbasi kjo tokë e zezë nuk qet gjë tjetër veç ferra e morriza e pranai të pasun e të papasun, krajla e lypsa, të dijshëm e të padijshëm, të gjithë e kanë nga një kryq në këtë jetë. Lum kush din e don me mbajt me sabër e për hatër të Zotit...» Kjo ishte pra ndihma, që feja dhe qeveritarët e asaj kohe i ofronte në përgjithësi «fatkeqësive», pra edhe zonave të dëmtuara nga tërmeti i 1905-ës. «Të bëni sabër, të duroni, i vetmi lehtësim është durimi.» (!) Çfarë ironie tragjike!

Edhe në tërmëtin e 15 prillit të këtij viti, të 150 shtëpitë e lagjes Bahçallëk u shkatërruan pothuajse krejtësisht. Udhëheqësit e Partisë dhe të popullit erdhën këtu; u ulën pranë një çadre e biseduan gju më gju me banorët e këtij kopshti të bukur. Lindi pyetja: si do të bëhet me Bahçallëkun? Mos duhet ta ndërtojmë këtë lagje në qytet? Apo në ndonjë vend tjetër? U shfaqën mendime të ndryshme, por të shumtët ishin për ta ruajtur Bahçallëkun, historinë e tij të lashtë. E Partia tha: «Të ruhet Bahçallëku». Por kësaj radhe do të bëhet ajo që kurrë s'ka ndodhur në historinë e kësaj lagjeje kaq herë të shkatërruar. Ajo do të ngrihet e re, e bukur, mes kopshtijesh me pallate dykatëshe në formë vilash, me tulla e brez betoni dhe e gjithë kjo me shpenzimet e shtetit dhe në një kohë rekord.

Duke ndjekur historinë e hidhur të tërmetit të vitit 1905, në zonat e Shkodrës, ndonjeri mund të thotë: «Epo kohë të tjera ishin ato.» Po, kohë të tjera ishin, por të mos harrojmë se nuk vendos koha, por sistemi shoqëror, në duar

të kujt është pushteti, sa dëgjohet e sa vendos populli. Le të mos shkojmë larg. Tërmete bien në mjaft vende të botës edhe tanë, në kohën e sotme, por fati i njerëzve të dëmtuar nga këto tërmete është shumë i ngjashëm me fatin e paraardhësve tanë që u dëmtuan nga tërmeti i vitit 1905. Për t'u bindur mjafton t'u referohemi vetëm disa të dhënavë nga shtypi i huaj. Edhe sot shkruhet me dhembje për tërmetin e Nikaraguas, që ka rrënë disa vite më parë, dhe pasojat e tij ende nuk janë zhdukur. Si Nikaragua janë dhjetëra në Filipine, në Indonezi. Në vendet e Evropës e të Afrikës. Jo vetëm kaq, po në këto raste mblidhen edhe ndihma nga brenda e nga jashtë, të cilat u ngjajnë lëmoshave fatkeqe me të cilat pastaj bëhen një mijë e një allishverishe.

Për botën kapitaliste e revizioniste duket si utopi që pasojat kaq të rënda, të një tërmeti kaq të fuqishëm, do të zhduken në një kohë kaq të shkurtër. E për ne kjo nuk është utopi, por realitet. Më 1 tetor, e me sa duket edhe më përpara, pa ndihmën materiale të askujt nga jashtë, çdo gjë do të ketë ndryshuar. Fshatra të reja do të ngrihen e gjurmët e tërmetit do të mbeten të dokumentuara vetëm në filma e fotografi. Kjo është rruga jonë, dinjiteti ynë. Ky është marksizmi që e mësuam dhe e mësojmë në shkollë, dhe në jetë, këto janë mësimet e Partisë dhe të shokut Enver Hoxha.

Në shtypin tonë ato ditë u botuan qindra letra e telegrame që kishin ardhur nga të katër anët e botës. Ato i kanë shkruar bashkatdhetarët tanë kudo që janë, vëllezërit nga Kosova, partitë marksiste-leniniste e forcat revolucionare, njerëzit e thjeshtë e dashamirësit e vendit tonë, personalitete politike, shtetërore e shoqë-

rore etj. Në këto letra e telegrame jo vetëm shprehet solidariteti, ngushëllimi e dhembja për humbjet e njerëzve e dëmet e shkaktuara, por në to spikat optimizmi i gjallë, përkrahja revolucionare e besimi i patundur se, si kurdoherë, edhe kjo vështirësi do të kapërcehet me guxim e vendosmëri e Shqipëria do të bëhet gjithnjë më e fortë e më e bukur.

Kthehemë përsëri te shënimet tona për këtë ngjarje. Ishin orët e para të rënies së tërmëtit. Gjithçka të dukej në kaos, por njerëzit ruasin gjakftohtësinë, optimizmin. Të parët që u nisën në frontin e betejës, për t'u gjendur pranë të plagosurve, ishin punonjësit e shëndetësisë. Në Shkodër, si edhe në rrethet e tjera të dëmtuara nga tërmëti, u morën masa të menjëhershme. Në spitale u vu çdo gjë në gatishmëri. Çadrat e para që u ngritën në zonat e dëmtuara ishin ato të qendrave mjekësore dhe të ndihmës së shpejtë. Qindra njerëz shfaqën gatishmérinë e tyre për të dhruuar gjak për të plagosurit.

Në spitalin e Shkodrës vajti edhe shoku Ramiz Alia e udhëheqës të tjerë të Partisë. Me gjithëse ngjarja e 15 prillit ishte e rëndë dhe tronditëse, optimizmi i të plagosurve ishte më i fortë se tërmëti. Një kooperativist i shtruar me dy pjesëtarët e familjes tha: «Ne do bëhem i mirë e plagët mbase do t'i harrojmë, por kujdesin e Partisë për ne të plagosurit, do ta ruajmë sa të jemi gjallë».

Kujdesi për shëndetin lidhet në radhë të parë me masat profilaktike që duhej të merreshin. Dhe ja në zonat e dëmtuara filloi menjëherë vaksinimi i popullsisë.

Më datën 20 prill, në Shkodër, nën drejtimin e kryetarit të Komisionit Shtetëror për zhdukjen e pasojave të tërmëtit, shokut Adil Çarçani, bë-

het mbledhja e komisionit. Në të përcaktohen detyrat e orientimet konkrete.

Dhe ja, me parullën «Tërmeti lëkundi maled por jo zemrat tona» filluan aksionet. Ato tanimë janë bërë metodë revolucionare që të ngjallin guxim, trimëri e vendosmëri për realizimin e detyrave e për kapërcimin e pengesave e të vështirësive.

Eshtë e diela e parë mbas tërmetit. Në këmbë është ngritur Shkodër locja. Për cilin të flasësh më parë, për cilën ndërmarrje të mbash shënimë. Kudo ritëm, punë e disiplinë. Përkrah tyre vullnetarët e ardhur nga Tirana, nga Durrësi, nga Lushnja, nga Saranda etj., ashtu dorë-dorës, pa u kuptuar, të shpejtë si era, riparojnë, pastrojnë shembjet, grumbullojnë e sistemojnë materialet dhe hapin sheshet e ndërtimit.

Me blokun tonë të shëнимeve, për ditë me radhë, shkuam në zonat e rrethit të Shkodrës të dëmtuara nga tërmeti. I mbajtëm shënimet tona pranë shtëpive të dëmtuara, te çadrat e vullnetarëve e kudo njerëzit tregonin për punën e madhe vëtmohuese që po bëhej në kohë të mirë e të keqe, ditën e natën, për të zhdukur sa më parë pasojat e tërmetit.

Shtypi ynë, në pak ditë batoi dhjetëra artikuj, korrespondenca, lajme e fotografi nga fronti i zonave të dëmtuara nga tërmeti. Në to flitej e tregohej me hollësi për dëmet që janë bërë e punën e madhe që po bëhet. Televizioni transmetonte çdo natë kronika e reportazhe televizive nga vendi i ngjarjeve e megjithatë ishte vështirë të krijoje një tabllo të gjerë të përmasseve shkatërrimtare që kishte shkaktuar ky tërmet, i cili ishte një nga më të fuqishmit të regjistruar në zonën e Ballkanit.

Duke kaluar në zonat e dëmtuara, duke

shkuar nga një fshat në tjetrin, pamë me sytë tanë dëmet e pallogaritshme. Për të kriuar një pasqyrë më të gjërë të këtyre shkatërrimeve, ne po i drejtohem i njëfarë statistike. Simbas regjistrimeve e njoftimit të Agjencisë Telegrafike të datës 19 prill, numri i përgjithshëm i shtëpive dhe i objekteve social-kulturore të she-imbura e të dëmtuara arrinte mbi 17 mijë. Në qoftë se i marrim të gjitha këto së bashku dhe i vemë në një vijë të drejtë, do të na krijohej një rrugë e gjatë me banesa të shkatërruara e të dëmtuara prej mbi 200 kilometra, që përafërsisht është e barabartë sa rruga automobilistike Tiranë-Gjirokastër. Ja edhe diçka tjetër: sikur të xhironim vetëm nga 30 sekonda film për çdo banesë apo objekt ekonomik, apo socialkulturnor të dëmtuar, do të duhesin mbi 100 orë xhirim në vazhdimësi, gjë kjo e barabartë me një film dokumentar, që po të shfaqej do të vazhdonte mbi katër ditë e netë pa pushim.

Në zonat e Shkodrës, ashtu si edhe në rrethet e tjera të dëmtuara nga tërmeti punohej njëherësh në të gjithë frontet e në shumë procese e drejtime pune. Jo vetëm në rrethin e Shkodrës, që ishte zona më e dëmtuar, por edhe në tërë Shqipërinë vështirë se kishte pasur ndonjëherë kantier me përmasa të tillë ndërtimi. Ai shtrihet në dhjetëra kilometra me disa degë e sektorë, me disa sheshe për grumbullimin e materialeve. Nuk gabojmë po të themi se asnëherë, në të njëjtën kohë, nuk ishin bërë kaq riparime e nuk ishin hapur njëherësh kaq thëmelle përshtëpi të reja të sistemuara e komode siç ndodhi në zonat e dëmtuara nga tërmeti në rrethet e Shkodrës e të Lezhës e në krahina të tjera të vendit.

Kudo që shkonim, kudo që ndaleshim, ndeshnim me frymëzimin e njerëzve të thjeshtë,

me optimizmin e tyre revolucionar. Edhe në zonën e Velipojës tërmeti ishte shumë i fuqishëm. Por ai nuk e përkuli dot forcën e vullnetin e njerëzve. Velipojasit me guxim i hynë punës në të dy frontet: edhe për zhdukjen e pasojave të tërmetit, edhe për të realizuar detyrat e stinës.

Flamur frymëzimi u bë në Velipojë edhe akti i vajzës së thjeshtë, punëtore së pafjalë, Liza Nikollë Zefi. Ajo ishte mijelëse e dalluar, e qeshur dhe e dashur. Bashkë me shoqet, edhe në mëngjesin e 15 prillit, si gjithnjë, vajti për të punuar te stallat. Kur filloi tërmeti, stallat lëkundeshin si të ishin varkë në det. Po Liza nuk u tremb, para se të largohej deshi të hapte dyert, të shpëtonte lopët, pasurinë e popullit. Por mbeati aty në vendin e punës, në krye të detyrës, si blegtore e mirë, shembull i vetmohimit.

Akte të guximit e të vetmohimit në ditët e tërmetit, pati pa numërim. Të ndalesh për të gjitha këto raste duhet shumë kohë, por ne menduam të tregonim në disa radhë edhe për aktin e guximshëm të pionieres 14-vjeçare Margarita Vreshtha nga Dajçi. Kur ra tërmeti ajo ishte një shtëpi bashkë me tri motrat dhe me Dafinën e vogël dyvjeçare, vajzën e fqinjët, që i kishte prindërit në punë. Lëkundjet e frikshme i hutuan fëmijët. Motrat e vogla vrapuan nga dera e shpëtuan. Po Dafina e vogël ç'të bënte? Margarita e rroku atë në gji, e bashkë me të desh të dilte nga dritarja, por ishte vonë... Faqja e murit i zuri poshtë, ashtu të rrokura, të dyja bashkë.

Tërmeti i 15 prillit në Shkodër e në disa rrethe të tjera, që erdhi si një gjëmë e zhurmshme shkaktoi çrrëgullime në të gjithë sektorët e jetës. Në mjaft zona u shembën kabinetat dhe u ndërprenë energjia elektrike, pa të cilën nuk pu-

nonin as radiot e as televizorët. U shkatërruan tubacionet e ujësjellësit etj. Për masat u morën të menjëhershme. U fillua së pari me qëndrën lëvizësë të zërit. Njerëzit duheshin vënë në dijeni për telegramin e Komitetit Qendror të Partisë, për masat e Qeverisë etj. E kur jeta u normalizua me gjërat më të domosdoshme, qendra e zërit duke shkuar fshat më fshat e zonë më zonë njoftonte çdo ditë për realizimin e detyrave, transmetonte komunikatat e shtabeve të zonave e fshatrave e pse jo, jepte edhe muzikë e këngë për të përshëndetur të përparuarit.

Gjatë gjithë kohës, që u ndodhëm në zonat e dëmtuara nga tërmeti, ishte bashkë me ne edhe një grup xhirimi i Televizionit. Njerëzit kudo na drejtoheshin me dashamirësi.

— Shokë! Ju, të Televizionit jeni? Ja, filmoni këtu në Pentar, fshati është rrënuar i gjithi, kanë mbetur vetëm gërmadha e skelete muresh. Çadrat i kemi ngritur këtu në kodër sa të ndërtojmë fshatin e ri! Megjithëkëtë në punë s'kemi asnjë mungesë e detyrat po i realizojmë si asnjëherë.

— Pa mbaruar mirë këtë bisedë, të kapin të tjerët!

— Po, në Barbullush do vini, po në Obot, në Samrisht?

— Në Bushat sikur nuk jeni ndalur të filmoni zotimet tonë.

— Po si t'i filmojmë zotimet, i thonim ne si përt'u justifikuar.

— Filmohen, filmohen. Hajde shikoni se si ato po bëhen realitet.

Në rrugët drejt Lezhës e Shkodrës vështirë se kish patur ndonjëherë trafik kaq të ngarkuar. Ndaj, në lëvizjen e automjeteve e të kolonave të autobusëve me vullnetarë, kërkohet rregull e disiplinë, punë me nerva të tendosura dhe zba-

tim me përpikëri të rregullave të qarkullimit rrugor. Për mbarëvajtjen e kësaj pune policia rrugore nuk kursonte asgjë, duke punuar pa u lodhur, deri në orët e vona, sepse kështu edhe ata ndihmonin për shpejtimin e zhdukjes së pasojave të tërmetit.

Për zhdukjen e pasojave të tërmetit ishte ngritur në këmbë e gjithë Shqipëria. E kush nuk donte në ato çaste të vrullit revolucionar, të reshtohej në kolonat e vullnetarëve, por ishte e kuptueshme se të gjithë në frontin e zonave të dëmtuara nuk mund të shkonin. Megjithatë cilido te ne në atë kohë i bën vetes pyetjen: «Çfarë mund të bëj, unë? Çfarë mund të bëjmë ne për të shpejtar zhdukjen e pasojave të tërmetit?».

E kështu nisën rrugë mendimet e iniciativat e shumta si ajo për të ngritur rendimentin e normat, për të prodhuar mjete e pajisje të reja, për të zëvendësuar shokët që shkuat vullnetarë, etj. Punonjësit e ndërmarrjes artistike «Migjeni» në Tiranë, të mbledhur të gjithë së bashku vendosën që të japid pagën e një dite pune për zhdukjen e pasojave të tërmetit. Kjo ishte një ndihmë modeste, por simbolizonte një gjë të madhe: solidaritetin, dashurinë e unitetin që ka farkëtuar Partia. E ja në vazhdim të saj, qindra ndërmarrje, qendra pune e institucione të ndryshme e përkrahin këtë iniciativë njëzëri. Me të marrë lajmin për tërmetin, u mblodhën edhe kooperativistët e Dijakës. Ata shfaqën dëshirën jo vetëm të dërgonin specialistë për të ndihmuar, por vunë në dispozicion edhe fondet për ndërlimin e gjashtë apartamenteve për vëllezërit e tyre kooperativistë të Shkodrës apo Lezhës. Që të nesërmen edhe kjo iniciativë u përkrah anë e mbanë Shqipërisë.

Ish te pranvera e 35-vjetorit te qirimit te Atdheut. Gonxhet e luleve e gjethet e njoma lodronin nga era ne flladin e bukur te diteve toni plot diell e ngrohtesi. Ecnim ne ato dit, me hapin e shtrire te kohes se Partise, me vrull e guxim per zhdukjen sa me par te pasojave te ternetit.

Shkodër, prill-maj 1979

Fitimtarë mbi tërmetin

Gjurmë të rënda la pas vetes tërmeti i fuqishëm që goditi vendin tonë mëngjesin e 15 prillit 1979. Ishte ajo një fatkeqësi e madhe e natyrës. Dhiembje e nderim për të rënët. Veç këtij hidhërimi, të mëdha ishin edhe humbjet ekonomike. Në bilancin e fundit, mbi 17 mijë shtëpi banimi dhe objekte ekonomike e social-kulturore të dala jashtë përdorimi. Dëmet më të mëdha u shkaktuan në rrethet Shkodër e Lezhë, pasoja të ndjeshme pati edhe në rrethet Mirditë, Dibër, Krujë, Mat, Pukë e Tropojë.

Por ajo ç'kishte ndodhur më 15 prill: rrënojat, shkatërrimet, të filmuara e të fotografuara, po futeshin në arkivë, sepse ndërtimi e zhdukja e pasojave të këtij tërmeti filloi në front aq të gjerë, saqë në afro 6 muaj, po, po, në më pak se 6 muaj, gjithçka kishte marrë pamje krejt tjetër.

Kur u kthyem në zonat e tërmetit mëbas disa kohësh, në sytë tanë hapej një pamje e re.

Në shtëpitë e sapondërtuara pihej dollia e gë-zimit dhe e mirënjoyjes.

Po si ndodhi kjo kështu? Kaq shpejt? Si u bë e mundur që një popullsi prej afro 100 mijë banorë, e mbetur pa strehë, të hyjë në shtëpi të reja e të meremetuara në më pak se 6 muaj?

Partia lëshoi thirrjen: Të gjithë në këmbë për të zhdukur pasojat e tërmetit, për të tejkaluar kudo detyrat, për të shkuar në 35-vjetorin e çlirimtë të Atdheut ashtu siç u ka hije fitimtarëve! Dhe Shqipëria, me thirrjen e Partisë e të shokut Enver, u ngrit në këmbë.

U ngrit në këmbë klasa punëtore, fshatarë-sia kooperativiste, inteligjencia popullore, rinia, ushtria. I gjithë populli, grusht e trup bashkuar, nisi betejën e madhe. E sikurdoherë, në mes të popullit udhëheqësit e Partisë e të Shtetit. Ata për ditë të tëra qëndruan në zonat e dëmtuara krah për krah me vullnetarët e gjithë Shqipërisë, biseduan me njerëzit si pjesëtarët e një familjeje. Vajti në zonat e dëmtuara nga tërmeti edhe Hysni Kapo. Megjithë sëmundjen e rëndë, bënte takime të gjera. Gëzonte e fliste plot optimizëm e besim të madh për të ardhmen. Në këshillat e tij, në porositë, në partishmërinë e tij të lartë proletare, te vepra e tij, në kemi parë e shohim pavdeksinë, forcën, unitetin e pathyeshëm të Partisë e të popullit tonë.

Në zonat e dëmtuara nga tërmeti, që në ditët e para vërvuan nga të gjitha anët ndertuesit e specialistët. Shtabet e ngritura, që nga Komisioni Qeveritar e deri tek ato të ngritura në rrëthe, kooperativa apo fshatra, ndiqnin hap pas hapi punën e madhe për zhdukjen e pasojave të tërmetit. Përkrah shkodranit e lezhianit punonte vlonjati e gjirokastriti, kolonjari e mirditori, kuksiani e durrsaku, myzeqari e korçari, tepeleñasi e tropojasi. Erdhën ata me një ideal

të madhë në zemër: të bëjnë realitet vendimin e Partisë, e, në afatin e caktuar, të zhdukin pasojat e kësaj fatkeqësie, të dalin fitimtarë mbi tërmetin.

Ne po hedhim pak shënime e po tregojmë për disa nga heronjtë e asaj beteje, e asaj fitoreje. Ata janë shumë, janë mijëra. Secili prej tyre ka biografinë e rrugën e tij që e solli deri në këtë front dhë secili prej tyre mund të thotë me krenari se në këtë aksion përfaqëson dhjetëra e dhjetëra vullnetarë të tjerë, që shfaqën dëshirën e flaktë të reshtoheshin në këtë betejë... Ja pra, cili është heroi ynë kryesor, një popull i tërë, të gjithë njerëz të mirë e të thjeshtë, që me frymëzim në gji, për javë e muaj me radhë nuk e njohtë cakun e ndarjes në mes ditës e natës. Njerëz që shpesh, për të ndihmuar shokun më të lodhur, me sy të përgjumur ndërronin turnet e punës edhe kur nuk e kishin radhën.

Ja Bahçallëku, të gjitha shtëpitë u rrafshuan. Atëherë pati mendime që banorët e kësaj lagjeje të sistemoheshin diku në Shkodër, por shoku Enver tha: «Të ruhet kjo lagje e lashtë në hyrje të Shkodrës».

Për ndërtimin e Bahçallëkut, së bashku me shokët shkodranë punuan edhe ndërtuesit e talentuar të kryeqytetit. Ata erdhën nga ndërmarrje e qendra të ndryshme pune, por me një qëllim të përbashkët: ta ndërtonin Bahçallëkun të bukur, me shtëpi plot ajër e dritë, të forta, antisizmike, të lidhura më hekur e brez betoni. Në kantier kishte shumë të dalluar, sulmues, punonjës të pararojës. Ne na folën për Agimin, Janin, Vendimin etj., që shpeshi turnin nga turni e ndanin me aq kohë sa i duhej njeriut për të pirë një cigare duhan. Na folën për arsimfarin Shpëtim Markolaj që me brigadën e tij, s'largo-

hej nga puna pa realizuar detyrën e zotimin. Na folën për dhjetëra e dhjetëra njerëz me zemër të madhe e ndërgjegje të lartë.

Në bllokun tonë të shënimave kemi shkruar diçka edhe për komunistin Dilaver. Është një burrë mbi të 50-tat. Erdhi në Bahçallëk që ditët e para mbas tërmëtit. Ai është mekanik e karpentier, por shokët e thërrasin komisar. Që në mëngjes e deri në orët e vona të natës e gjeje në punët më të vështira të ndërtimit. Nga që në jet Dilaveri ishte disi i heshtur, edhe shokët vonë e morën vesh se ai ishte me rapport mjekësor. Madje edhe këtë e mësuani vetëm kur familja i dërgoi fletën e kurimit për në llixhat e Peshkopisë. Anëtarët e brigadës u bënë gati ta përcillnin. Dilaveri mori sqeparin, mistrinë e u tha shokëve: «Në llixha do të shkoj mbasi të mbarojmë punë me tërmëtin.»

Raste të tillë të njerëzve të thjeshtë, të vullnetarëve të mirë, që pa u thënë njeri kishin shtyrë lejet, kishin shtyrë fejesa e mërtesa apo edhe kishin vajtur, ishin martuar e mbas 5 ditësh ishin kthyer përsëri në frontin e punës, kishte patur me dhjetëra e me dhjetëra.

U larguam nga Bahçallëku, nga ajo lagje e historisë së lashtë dhe e luftëtarëve të rindërtuesve të socializmit dhe u ndalëm në lagjen «Skënderbej» të qytetit të Lezhës. Edhe kjo lagje, në rrjedhën e viteve, ka luajtur rol të rëndësishëm në jetën e Lisisit të vjetër. Ashtu si Bahçallëku, ajo e para është ndeshur me dyndjet e betejat për pushtimin e kalasë së qytetit nga armiqjtë. Sipas dokumenteve, në përleshje të ashpra me turqit, është djegur dy herë bashkë me qytetin. Këtu në këtë lagje më 2 mars të vitit 1444, nën drejtimin e Gjergj Kastriotit, është mbledhur Kuvendi Historik i Lezhës, po këtu është edhe vendvarrimi i heroit legjendar.

Edhe dëmet e shkaktuara aty nga tërmeti i 15 prillit 1979, po riparohen. E gjithë ndërtesa tanë ruhet brenda kolonave e mureve të veshura me material të veçantë ndërtimi.

Por, le t'i lemë vitet e historisë së lashtë e të kthëhem te ditët tona... Vetëm dy muaj më parë gjithçka u rrafshua në këtë lagje. Dhe ja tani përsëri kemi ardhur në këtë vend. Një pamje krejt e re. Mbi themelet e mureve të lashtë, reshtohet këtu një bllok i madh ndërtesash banimi me mbi 100 apartamente. Çdo gjë është bërë me planimetri dhe e studiuar. Të gjitha këto pallatë të bukura u ndërtuan nga vullnetarët e 7 rretheve: Kukësi, Pogradeci, Skrapari, Gjirokastra, Kruja, Librazhdi e Berati. Vullnetarët e ardhur këtu nga e gjithë Shqipëria u ambientuan shpejt. U njohën me lezhianët e me njëri-tjetrin e u bënë si të shtëpisë. Por ditët e parë duke kaluar mes këtyre ndërtimeve shpesh mund të dëgjoje:

- Ej, shoko, nga ju kemi?
- Nga Korça.
- A! Punoni mirë ju të Korçës, kanë shkrurar edhe në gazetë për ju.
- Po ju nga jeni?
- Nga Peshkopia.
- Edhe ju dibranët jeni ustallarë të mbaruar.

Kalojmë nga një kantier në tjetrin, e në vrullin e atyre ditëve që nuk mateshin me kalendar, ndjenim në çdo hap heroizmin e njerëzve të thjeshtë, përpjekjet e luftës për të realizuar zotimin para Partisë.

Në aksionin e madh për zhdukjen e pasojave të tërmetit, vullnetarët nga Gjirokastra, si i thonë një fjale, i hoqën gunat te vellezërit e tyre lezhianë, por një brigadë me rreth 50 vetë, nën drejtimin e inxhinierit të palodhur, Andonit,

u vendos në Sukat e Dajçit. Erdhën ata këtu pa fjalë, por që në ditët e para u fol shumë për punën e tyre të shpejtë, të pastër e me cilësi. Mes këtyre njerëzve të gjuar e të palodhur ishte edhe muratori i pasionuar, 24-vjeçari, Pandeli Deçka. Ai nuk mori pjesë në përurimin e këtyre shtëpive. Vdekja e ndau me shokët në krye të detyrës. E shokët, kooperativistët e Dajçit, s'do ta harrojnë Pandeliun, që ra në fushën e betejës për zhdukjen e pasojave të tërmëtit. E siç ndodh në jetën tonë, në optimizmin e gjerrë të saj, vendi i Pandeliut nuk mbeti bosh. Në apelin e brigadës, në emrin e tij, përgjigjeshin 10 sokola të tjera të ardhur nga Gjirokastra me Kostaq Deçkën në krye, vëllanë e shokut tonë. Në fjetore u shtuan krevatet, në frontin e punës mistritë.

Ja zona e Kosmaçit. Këtu u ngrit një fshat me 130 shtëpi — vila, me të gjitha mijëdiset, i grupuar me planimetri si të ishte lagje qyteti. Këtu punuan qindra vlonjatë. Zbritën nga makinat natën vonë dhe të nesërmen në mëngjez herët filluan punën sepse, të organizuar sipas kooperativave e qendrave të punës, ata i kishin sjellë me vete mjetet më të nevojshme të punës, duke filluar nga karrocat e dorës e deri te makinat e transportit.

Ja edhe Pentari. Ato ditë të rënda prilli i lamë banorët e këtij fshati pranë Bunës, në çadra. Tërmeti i fuqishëm i detyroi atë të ngjiteshin mbi shkëmbinj. Vështirësitë qenë të mëdha, por asgjë e domosdoshme nuk u mungoi kooperativistëve kufitarë. Dhe ja, mbas 4 muajsh, kur ende po vazhdonte ndërtimi, vajtëm përsëri në këtë fshat. E gjetëm atë në një betejë të madhe... Minat gjerryenin shkëmbin për të hapur kanalin e ujësjellësit. Nga gryka e malit, nën diellin përvëlues të korrikut uturinin makinat

ngarkuar me material ndërtimi, duke mbajtur kështu mbi vete fshatin e ardhshëm.

Për ndërtimin e Pentarit punuan qindra kooperativistë e punonjës shkodranë, mbi 230 specialistë e punëtorë nga rrethi i Fierit. Erdhën ata nga fushat e buta të Myzeqesë e fituan betejën mbi shkëmbinjtë e Pentarit. Këtu hapën themellet, këtu ngriten shtëpitë.

Vështirë se kishte njeri në Barbullush që nuk e njihte Remziun. Jo, ai nuk ishte as inxhinier, as përgjegjës, ishte shofer në ndërmarrjen kommunale të Tiranës. Kooperativistët, barinjtë e vullnetarët e dallonin maqinën e tij që larg, edhe kjo, jo pse kishte ndonjë gjë të veçantë, por sepse gjatë atyre muajve nuk kishte patur shofer tjetër që t'i rrihte këto rrugë kaq shumë. Me makinën e tij 3-tonëshe, brenda 24-orëve, ngarkonte e transportonte deri 100 ton material ndërtimi.

I tillë ishte edhe shoferi Iliaz i parkut të Shkodrës. Edhe atë e gjeje kudo, në frontet më të vështira. Në Pentar mbushja e truallit të shtëpive me gur e dhë po vononte ndërtimin. Si të veprohej? Të njiteshin mjetet e transportit deri në xhokolaturë e çdo ndërtësë dukej si e pamundur! Kjo e vuri në mendime Iliazin. U këshillua edhe me Kostandinin, inxhinierin e palodhur dhe vendosi të hyjë me maqinën e tij, duke shtruar gurë e trarë, mes shkëmbinjsh, shtëpi më shtëpi. Kjo bëri që punimet të shpejtoheshin.

Ja edhe një iniciativë tjetër. Ajo kishte lindur, në fshatin e ri e të bukur të Oblikës. Ne shpesh, në shënimet tonë kemi folur për shtëpi e objekte të veçanta. E tillë ishte edhe shtëpia buzë rrugës apo hyje në fshat. Ajo u përfundua, që nga piketimi i themeleve e deri me hedhjen

e çatisë, në 18 ditë, nga 3 specialistë të ndërtimit të parkut automobilistik, të udhëtarëve të Tiranës. Edhe ky një farë rekordi më vete.

Në Lezhë e në Zadrimë, me cilindo që takoje, kur binte fjala për tërmetin, sepse donin të flisnin për fshatin Piraj. Shkuam në këtë fshat në zemër të Zadrimës. Takimin e parë më të e morëm që larg nga rruga gjarpëruese. Fshati ngrihej bukur mbi një kodër. Këtu ishte menduar për çdo gjë, edhe për ujësjellësin, kanalizimet, gjelbërimin. Një plak që ishte mbështetur pranë një lisi, kur pa se ne po mbanim shënimë, foli: «Mbani aty edhe këto që po ju them unë. Pirajn e ri e ngriti Partia e popullit më Enver Hoxhën. Mos e harroni». E si të mos ia- plotësojmë dëshirën.

Për ndërtimin e Pirajt të ri, bashkë me kooperativistët e Blinishtit, punuan edhe mbi 180 vullnetarë nga Saranda e bukur e brigjeve të Jonit.

Fshati u ngrit kështu si një monument, si një kujtim i paharuar i miqësisë e i solidaritetit vëllazëror të njerëzve tanë nga Jugu në Veri. Kjo veprë i bashkoi edhe më shumë, i njobuh me njëri-tjetrin. Dhjetëra kujtime ruhen tani nga vullnetarët e Sarandës e kooperativistët e kësaj zone.

Shkuam në shtëpinë e plakut Llazër Marku. Aty gjetëm edhe inxhinier Jorgon, që po grumbullon të dhëna për historinë, për zakonet, për luftërat, për fshatin e ri e të bukur, për normat e reja së socialiste të jetesës. Me të gjitha këto ai do të shkruante një reportazh të gjatë për Zadrimën në gazeten «Fitorja» të Sarandës.

Jashtë dëshira që dëgjohet, ja dhe diçka tjeter. Gjatë atyre ditëve në Lezhë u organizua festivali i grupave folklorike. Amatorët e Blinishtit sollën në festival diçka të

re, të freskët. E këto ishin edhe këngët e vullnetarëve të Sarandës. Grupi i përbashkët u pëlqye dhe u duartrokit vazhdimisht. Juria i dha çnimin e parë në rreth. A nuk është edhe ky një kujtim që flet shumë?

Në mijëra vullnetarë veçuan edhe Nikolla Andrea Bërdufin. Ishte një sharrxhi i vjetër në kooperativën e Shtërménit. Pjesën më të madhe të 77 vjetëve ia kishte kushtuar luftës, drurit, sharrës, ndërtimit. Ai ka ecur gjithnjë mendueshëm nëpër vitet e jetës. Kur ishte ende i rizbriti nga Shpati e u pajtua hyzmeqar te bejlerët e Elbasanit, për 10 kilogram misër në muaj. Në vitet e luftës partizane u radhit në forcat e Brigadës I-Sulmuese. Nikolla Bërdufi kishte 22 nipër e mbesa dhe kudo e thërrasin xha Kola.

Kjo copëz jete, mbasë edhe mund të mos vinte deri tek shënimet tona, po të mos ishte ngjarja e 15 prillit. Xha Kola tregon: «Kur dëgjuam për tërmetin, mua m'u drodh zemra si të ishte shembur shtëpia ime. Mora vesh se po grumbulloheshin vullnetarë. Vendosa të nisem edhe unë.»

Kaq tha xha Kola e bëri gati plaqkat. Ditët kaluan e xha Kola me punën shembullore u bë i njobur jo vetëm në Velipojë, por edhe në kantierët e tjerë të zonave të tërmetit.

Kalojmë mes këtyre njerëzve me zemër të madhe e ideale të larta e themi me vete: tërmetet, që nuk njojin ndarje shtetesh. e kufijsh, ndajnë anganjëherë dy botë. Kjo dukej në çdo hap, në çdo veprim, që nga ndihma që u jepej të dëmtuarve e deri te zhdukja e pasojave shkatteredimitare. Dukej te bota shpirtërore, te konceptet e mendimet, dukej bile edhe te letrat, telegramet, në bisedat telefonike etj.

Jo rrallë na ka takuar të lexojmë në shtypin

tonë për dëme e fatkeqësi të natyrës në vendet e ndryshme të botës kapitaliste e revisioniste. Letra e telegrame ngushullimi e keqardhjeje u dërgohen të dëmtuarve, atyre që mbeten pa strehë, nga njerëz të ndryshëm, të afërmit, shoqatat bamirëse e Kryqi i Kuq, e në të gjitha ato, një fund, ... një shpresë... Perëndia e fati ju ndihmoftë... E këto urime kanë vazhduar në muaj, në vite.

Edhe te ne, në zonat e dëmtuara nga tërmeti, gjatë muajve të aksionit, në Shkodër e në Lezhë pati shumë letra, telegrame, biseda telefoni ke, por ato ishin plot optimizëm. Nuk pyesnin në se do të bëhen apo jo shtëpitë, por kur është caktuar dita e përrurimit.

E ja! Ashtu si edhe lulet në pranverë, që kur çelin ndjekin njëra-tjetrën, edhe përrurimet e lagjeve e fshatrave të reja, në zonat e tërmëtit erdhën radhazi, si festa të bukura.

Lulja e parë e këtyre festave u bë qyteza e vogël e fshatit Kuc, në kooperativën bujqësore të Gurit të Zi. Bashkë me kooperativistët punuan këtu, nën drejtimin e inxhinierit Vasil Ziu edhe 55 vullnetarë nga Gramshi.

Në zonën e Velipojës, në rrëpirën e kodrave të Luarzit pesë muaj më parë s'kishte asgjë tjetër veç ferra e driza. Tani aty ngrihej Boksi i ri me 41 banesa të porsandërtuarë.

Në kohën që dorëzoheshin për banim qindra shtëpi të reja e ngriheshin dollitë e gëzimit, pa dashur të shkojnë mendja tek ai volum i madh pune që është bërë në zonat e dëmtuara nga tërmëti. Po ja lemë radhën statistikës:

Gjatë 5 muajve, për zhdukjen e pasojave të tërmëtit punuan rrëth 20 mijë specialistë të ardhur nga e gjithë Shqipëria. Në rrëthet e prekura nga tërmëti ndihmuant edhe mbi 120 mijë

forca vullnetare pa e ndërprerë punën në realizimin e planit.

Në 5 muaj arritën në sheshet e ndërtimit 45 milionë copë tulla, pesë milionë e gjysmë copë tjegulla. Po të ngarkoheshin njëherësh çimentoja dhe gëlqerja e përdorur në zonat e dëmtuara nga tërmeti, do të duheshin afro 15 mijë kamionë 4-tonësh. Disa mijëra vagona treni me gurë. Në të gjithë zonën e në fshatrat e reja u shtri linja elekrike e telefonike. U përfunduan 15 ujësjellës. Gjatë 24 orëve në zonat e tërmetit kanë lëvizur mesatarisht mbi 400 automjete, pa llogaritur këtu qindra carro e qerre. Në çdo 24 orë u ndërtuan mesatarisht mbi 15 shtëpi apo vepra socialkulturore të reja dhe u riparuan afro 50 banesa me dëmtime të ndryshme dhe të gjitha këto me shpenzimet e shtetit.

Zonat e dëmtuara nga tërmeti u vizituan edhe nga bashkatdhetarë me banim në vende të ndryshme të botës, shokë të partive marksiste-leniniste, vëllezër kosovarë, miq e dashamirës të Shqipërisë e të gjithë kanë marrë pjesë në gjëzimet tona. Në kooperativën e Bushatit u takuan me amatorët e shoqërisë kulturore «Kastriotët» të Ferizajt. Këtu u organizua edhe një koncert i përbashkët.

Një herë duke biseduar me një grup shokësh e aksionistësh në Dajç të Bregut të Bunës, na tërroqi vëmendjen shqetësimi i tyre, që nuk u kish vajtur në mend të ruanin ndonjë nga shtëpitë gërmadhë, të rrënuar nga tërmeti, si një kënd muze. Kjo ishte një ide e mirë, por disi e parealizueshme, sepse gërmadhat ishin zhdukur si era. Por ne, kjo bisedë, na bëri të mendohemi për diçka më larg... Vetëm mbas 6 muajsh nuk gjejmë dot një gërmadhë të përshtatshme për ta ruajtur si muze...

Me një grup gazetarësh e kineastësh jemi

ngjitur me helikopter mbi fushat e kodrat pjetlore të Atdheut tonë. Nga larg vëzhgojmë lumenjtë, kanalet ujitetë, linjat e tensionit të lartë, rrugët lakadredhëse, që mbajnë mbi vete jetën tonë socialiste, jetën e re të viteve të Partisë. Gjithçka të frymëzon...

Kemi udhëtar edhe herë të tjera me pilotët tanë të guximshëm të helikopterëve dhe aeroplanëve. Jo rrallë kemi nxituar mes grykash, në shi e mjegull, për të sjellë në Televizion krontikat e ngjarjeve të rëndësishme. Pilotët ngulnin vrojtimin e tyre te fluturimi, që të arrinin të siguntë e në kohë, ndërsa ne e kishim mendjen te filmimet si dò të jenë marrë. Kështu e ka jetëta, profesioni, pasioni për punë. Por udhëtimi i asaj dite kishte dicka të veçantë. Të dy palët kishim dalë të sodisnim, të filmonim nga lart fshatrat e reja në zonat e dëmtuara nga tërmeti, që dukeshin si bugeta të bukurë më lule. Ja, Lezha me lagjen historike... Ja me radhë? Barbullushi, Dajçi, Kosmajci... Ja edhe Bahcallëku me çatitë e kuge mes gjelberimit.

Ecim të menduar mes heronjve tanë, mes mijera njerezve që punuan, sakrifikuani e në më pak se 6 muaj zhdukën pasojat e rënda të tërmetit të 15 prillit. Ata, luftëtarët e guximshëm të popullit e të Partisë, që sjanë trembur as nuk tremben kurre nga vështirësitet, frethimet e bllokadat, ngadoqofshin, fituan një betejë të madhe e të laydishesme, shkruan një kapitull të ri në ndërtimin e socializmit, lani kujtimet e tyre të mira, në cdo shtëpi e familje fshatari apo qytetari e morën më vete dicka të shtrënjtë e të paharruar dashurinë e njerëzve. Shkodër, Gusht-shtator 1979

Komani, një betejë e madhe

Që nga brigjet e detit e deri thellë në shpatet e ngushticat e lumenjve të rrëmbyeshëm, i ngrinin kështjellat e vendbanimet e tyre stërgjyshërit tanë: ilirët, arbërit.

Gryka e Drinit, mes malesh të thepisura, është një ndër monumentet e historisë së lashtë. Gjetjet e deritanishme arkeologjike në këto zona e studimet e ndryshme bëjnë fjalë për zanafillën e lulëzimin këtu të një vargu qytezash e vendbanimesh si Sarda (Shurdhahu i sotmë) Komani etj., që i përkasin një periudhë të Arbërisë së hershme, të shekujve gjashtë e tetë.

Rrënojat e mureve, zbulimet e varrezave, gjurmët e kalasë së Dalmacies në Koman, gjetjet e mjeteve të punës, të orendive shtëpiake, zburimef e ndryshme, punimi i metaleve etj., i le vend imagjinatës sonë të depërtojë në historinë shumëshekullore të luftërave e të betejave që kanë bërë paraardhësit tanë, për të ruajtur e pasuruar kulturën e tyre autoktone, e

cila sipas gjithë të dhënave është vazhduese e drejtpërdrejtë e kulturës ilire.

Kërkimet e studimet në këto zona, mbas veteve të Çlirimit kanë hedhur dritë edhe mbi faktin e rënies e të përtëritjes së vazhdueshme të këtyre vendbanimeve,

Muret e vjetra të rrëthimeve në këto qytete, janë gjetur të lidhura me mure më të reja. Godina e faltore të reja të ndërtuara mbi të vjetrat. Varreza mbi varreza. E gjithë kjo flet qartë se as luftërat, as zjarri nuk e kanë shkullur kurrë shqiptarin nga rrënjet e tij, nga toka e tij.

Zhvillimi e lulëzimi i vëndbanimeve të luginës së Drinit, ka qenë i lidhur, jo vetëm me anën strategjike, mbrojtëse të këtyre grykave, kështjellave natyrore, por ka qenë i lidhur edhe me faktin se këto zona dikur kanë shërbyer si nyja komunikacioni, përmjet një rrugë të dorës së dytë, e cila njihet që nga periudha romake e që shtrihej në tërë gjatësinë e Drinit deri në viset e Kosovës, duke kaluar edhe në afërsitë e fshatrave të njoitura sot si Mazreku, Karma, Vjerdha, etj.

Në vitin 1973, në vatrat e kësaj krahine me histori të lashtë, erdhi ekspedita e parë gjeologjike nën-drejtimin e inxhinierit të ri, të sapodale nga auditoret e Universitetit të Tiranës, Pjetër Kroj. Ajo zuri vend në Gushtën e Shllakut, tamam në vendin ku sot po ngrihet sala e makinerive të hidrocentralit.

Gushta, me rreth 10-15 shtëpi (sot ka ngelur akoma ndonjë në këmbë), e merr emrin nga gryka e ngushtë e Drinit që ndodhet në mes të dy shkëbijve gjigandë të malit në zemër gëllqerorë-strallorë. Pjetër Kroj tregon: «Zbritëm në këto brigje. Vendosëm çadrat, materialet.

Malsorët na pritën me zemër të hapur. Ata na ndiqnin nga sonda më galeri e donin të dinin sa më shumë për hidrocentralin.

Punonjësit e spëcialistët e ekspeditës, që shtoheshin nga muaji në muaj, nga viti në vit, filluan gjerësisht kërkimët e grumbullimin e të dhënave për të përcaktuar formacionet gjeologjike në shpatet e lumiit, thellësinë e gjendjen e depozitimeve të Drinit në këtë grykë si dhe rilevimin topografik të zonës, ku do të ndërtoliej hidrocentrali. Vështirësi kishte shumë, qdo gjë transporthoj me kafshë apo me motobarkë në-përmjet ligjenit të Vaut të Dejës. Kjo grykë e Drinit e lidhët Komanin me Shkodrën e me gjithë Shqipërinë. Le pastaj, — vazhdon Pjetri, — shpesh kishte mjergull, dallgë. Na takonte të udhëtonim edhe natën, ngaqë me vështirësi çaheshin erërat e Drinit. Më kujtohet nata e Vtit të Ri 1974. U nisëm të dilnim më Vatë të Dejës e pastaj të festonim Vitin e Ri në shtëpitë tona. Pö do, që diku aty afër fshatit Vjerdhaj, motobarka, që ndiqte bregun, nga që ishte kohë e vrënjtur e me shi, ndëshi në një shkëmb e tërë natën na u desh të rrnim jashtë me zjarr, sepse edhe motobarkën edhe materialet nuk i linim dot në ligjen.

Hidrocentrali i Komanit ka një lindje të veçantë, pa pérurimë sepse ai më shumë u bë një vazhdim i Fierzës. Ndaj edhe ndërtimet në Koman, ngritja e kantierëve etj. varej drejtpërsëdrejti nga lirimi i forcavës së i spacialistëve të hidrocentralit «Drita e Partisë» në Fierzë.

Më gjithatë, po vinte koha që në truallin e ndërtimit të veprés së ardhshme, të bëheshin pastrimet e sheshimet përgatitorë. Po me çfarë? Që të vinte aty ndonjë ekskavator apo buldozer duhej rruga. E andej nga do të vinte rruga dë-

gjoheshin ende vetém plasjet e minave. Atéherë buldozéristët trima vendosën të vinë në Koman edhe pa rrugë. Dhe ja në mars të vitit 1973, nga rrëpirat e Pukës e bjeshkët e Komanit, mes grykash e malesh të thepisura, kubvetëm dhitë bëjnë rrugë, u nis për në brigjet e Drinit me buldozerin e tij Luigj Govaçi. Pesëmbëdhjetë ditë i lani afat për të arritur, por ekskavatoristi i palodhur, duke udhëtarëtë ditën, që nga mëngjezi deri në dërkëje duke fjetur natën malleve e përrenjve, arriti më brigjet e Drinit përtre ditë. Ishte ky një finish maratone i paparë. Malsorët e habitur shikonin me kurreshtje, si u kallman ato gryka e qafë me gjithë këtë buldozer sa një shtëpi e madhe hekuri. Të nesërmen, gryka e Drinit bashkoi zhurmën re valëve të rrëmbyeshme me uturimën e buldozerit që u bë lajmëtari i një beteje të madhe.

Në vitin 1979, me hapjen e rrugës, filluan punimet në shkallë të gjërë. Erdhën sondat e makineritë e rënda. Ngan nëncentrali i Pukës mori udhë linjat tensionit të lartë 35 kilovatësh. I shpërndarë në tri gryka filloj ndërtimet kantieri i ngritjes, u përgatitën baza për teknikën, magazinat, fjetoret e punëtorëve e të përshtatshme tjetër me 3 500 vende, mensat, qendrat shëndetësore, kinoklubi etj. Në fund të vitit 1980, si ajo artileria e rëndë, zbriti nga Fierza pjesë më e madhe e ndërtuesve të hidrocentraleve, specialistë e inxhinierë, minatorë e sondistë të parlodhur. Ngritja e urës së madhe bëri që fronti i betejës të shtrihet në të dy krahët e Drinit.

Me fillimin e vitit 1981, forcat kryesore u përgendruan në ndërtimin e tunelit numër një të devijimit. Në luftë me shkëmbin hynë repartet pararojë të brigadave të dëgjuara, si ato të Shaban Gjokës, Xhem Pecit, Xhafer Melit etj. Kar-

pentierët me Hysen Kadrinë në krye, brigada e betoneve me brigadier Gjer Pepën e palodhur. Nuk mund të harrojmë këtu edhe transportuesit e guximshëm të automjeteve të rënda, që natë e ditë, pa ndërprerje, për muaj me radhë, nuk e lanë për asnjë çast frontin e kësaj beteje për devijimin e Drinit.

Duke ndërprerë për pak çaste tregimin tonë, po kthehemë edhe një herë në Shurdhah. Një gojdhane e vjetër e popullit të kësaj krahine tregon se në këtë kodër me kisha, gjindeshin 360 altarë, aq sa ditë ka viti dhe asnjë ditë nuk pushonin këtu kambanat e këtyre «shtëpive të Zotit», ndaj banorët e luginës e quajtën këtë vend Shurdhah, nga fjala «Shurdh». Në shekuj ato kambana me lutjet e tyre bamirëse përdrejtësi e begati nuk u sollën asnjë lumturi banorëve të varfër.

Sot, vetëm disa kilometra më lart nga Shurdhahu, në grykën e Komanit dëgjohet një tjetër zhurmë, zhurma e makinerive të rënda e buldozerëve, e sondave dhe e martinelit.

I solli Partia këto zhurma të reja për të ngritur në grykën e Drinit një mal më të lartë se shkëmbi i Shurdhahut e për t'i shtuar begatinë e forcën Shqipërisë socialiste jo në jetën e amshueme, siç thoshte feja, por sot, nesër e në shekuj.

Beteja për hapjen e përfundimin e tunelit numër një të devijimit rritej nga java në javë, e nga dita në ditë. Në një kohë të shkurtër u përgatit dhe u krye plasja e parë masive, ku u lëvizën 200 mijë metër kub shkëmbi. Dhe ja lajmi i gëzuar hyri në çdo kantier e në çdo fjetore: tuneli numër një i devijimit depërttoi shkëmbin tej për tej.

Pesëmbëdhjetë korrik 1981. Çaste të paha-

rruara. Kryhet shpërthimi për të shmangur pri-tën e përkohshme, dhe Drini, për të tretën herë i bindet forcës sonë duke kthyer rrugën për në shtratin e ri.

Devijimi i lumenit ishte një fitore dhe një fa-zë me shumë rëndësi në ndërtimin e hidrocentralit. Tani këtu puna po e cte me ritme të larta jo vetëm në shpatet e malit, por edhe në zemrën e digës.

Në Koman, si kudo në Shqipëri, Kongresi i 8-të i Partisë u ndoq me shumë vëmendje në-përmjet Radios e Televizionit. Gazetat e revis-tat shfletoheshin deri vonë në fjetoret e punëtor-ëve, në mensa e biblioteka. I gjithë Komani ishte në Kongresin e Partisë, sepse delegatët edhe kur diskutuan, edhe në bisedat e lira kur bëhej fjalë për hidrocentralin, flisnin me respekt e krenari për klasën punëtore heroike të grykës së Drinit. Kongresi u mbajt në Tiranë, por të dukej se ai i zhvillonte punimet e tij në gjithë Shqipërinë, sepse kudo mateshin forcat, shtro-heshin detyra të reja, merreshin zotime të guxim-shme. Edhe komanasit e hidrocentralit i bënë le-tër Partisë e shokut Enver për të shpejtuar ndërtimin e kësaj vepre të madhe.

Ky zotim i guximshëm, nuk ishte thjeshtë dëshirë, por llogaritje forcash, ndryshim statis-tikash, rishikim projektesh e gjithçka, pa cënu-ar aspak cilësinë e veprës. Por mbi të gjitha, zo-timi ishte mobilizim i mendjes dhe i zemrës së mijëra punëtorëve, inxhinierëve e teknikëve, që kudo në punën e tyre, çdo ditë e çdo orë të luf-tojnë për të mbajtur fjalën e dhënë.

Komanasit i shprehën qartë e thjeshtë me-ndimet e tyre. Deri në fund të vitit 1985 do të venë në shfrytëzim jo një turbinë, por dy turbi-na, pra 150 mijë kilovat energji elektrike do të

hyjnë në rrugët e tensionit të lartë më shpejt se parashikimi. I gjithë volumi i punimeve do të kryhet me makineritë ekzistuese. Kjo do të thotë llogarije të reja dhe shkurttime nga importi. Për mbulimin e transportit në hidrocentral do të punohet me 25 për qind më pak automjete. Kjo do të thotë lirimin e disa dhjetëra kamionëve, që mund të përdoren në fronte të tjera të ekonomisë.

Detyra nuk është e lehtë, por ajo tanimë është bërë ligj e ka hyrë në jetën e çdo punonjësi në hidrocentral.

Duke ecur, mes këtyre njerëzve të thjeshtë, të gëzuar e më humor, që në çdo hap të duket se nxitojnë, pa dashur të lind dëshira që të mësosh: ku i gjejnë, forcat që marrin zotime kaq të guximshme.

U takuam me Heroin e Punës Socialiste Shaban Gjoka. Ai dhe kolektivi i brigadës që drejton, janë të njobur në gjithë Shqipërinë. I kerkuan të na fliste diçka për punën, për detyrat. Ai na u përgjigj: «Kam më vete shokë e punëtorë të mirë. Çdo njeri prej tyre është krah i fuqishëm i brigadës. E duan njëri-tjetrin dhe unë i dua të gjithë. Bile i dua edhe kur ndonjëherë i qortoj. Po qe se dikush është i mërzitur, atë ditë rri më të më shumë. Po pat ndonjë nevojë përmjekim, unë vete para tij në spital. Jam kerkues, bile ndjek më vëmendje edhe si hanë edhe çfarë hanë, sepse shkëmbi do minatorë trimë e të fuqishëm. Por ajo që e dimë të gjithë është se fjalën e dhënë Partisë, popullit, nuk duhet ta thyejmë kurrsesi.

Tani kemi një merak në brigadë: të shtojmë vrullin në punë e të mbajmë vendin e nderit në garat socialiste. Këtë e themi jo për sedër të sëmurë, por ka brigada të reja nga ku edhe në të vjetrit mund të mësojmë».

Ndër to është brigada «Qemal Stafa». Brezi i ri i minatorëve mbush radhët e këtij detashamenti pararojë në hidrocentralin e Komanit. Aty ku është rinia është gjithmonë forcë e guximi. Kjo brigadë njihet sot në Koman si «korrigjuese» e normave më të larta që janë arritur në hapjen e galerive.

Këto janë brigadat e minatorëve që gjerryjnë zemrën e shkëmbit për të hapur galeri e tuneli, për të cimentuar digën e krahiët e hidrocentralit. U takuan në Koman edhe më minatorët guximtarë të gûrores. Aty gjetëm edhe Xhemal Çulajn. E filloi punën me lopatë të skafpatën e digës së hidrocentralit të Vaut të Dejës dhe sot është drejtori i kantierit të prodhimeve, më të cilin nuk ka sektor në Koman që të mos këtë lidhje. Ja edhe brigadat e minatorëve shqiponja me Kamber Gjinin e Shaqir Jatën në krye. Ata janë protagonistët e 12 plasjeve masive në Fierzë dhe tanj po përgatiten për serinë e betejave të reja në hidrocentralin e ri.

Në Koman të gjithë nxitojnë, të gjithë kanë pikësynime për të realizuar. Mes makinave 30-tonëshe e bulldozerëve, herë pas here takon edhe një makine 4-tonëshe që ecën ngadalë, kalon ajo mes rrugëve shkëmbore me një flamur të kuq në kabinë. Mjetet e tjera të fuqishme ndalojnë dhe i hapin rrugë. Kalimtarët e përshtendesin. Shoféri i kësaj makine është mik i minatorëve. Në ngarkesën e tij ai ka dinamit, lëndë eksplozive, kapsolla. Cdo gjë e qartë: këtu norma është kujdes, siguri, vëmendje e nerva të tendosurë. Forca për realizimin e zotimeve në Koman është si zinxhir i fuqishëm, që mban të lidhur njeri me tjetrin sektoret, brigadat, kantierët. Në këto zotime transporthuesit mbajnë një peshë të madhe; ndaj duhet nxituar ditë e natë. Me makinat

e rënda 20 e 30-tonëshe mori rrugë nisma për të kaluar nga 18 ditë në muaj transport të pandërprerë, me dy ndërresa, në 20 e 22, bile edhe më shumë ditë efektive. Kjo është baza e zotimit për shkurtimin e mjeteve të transportit. «Kemi vendosur, — thotë Shaban Selimi, — dhe fjalën do ta mbajmë, sepse kemi ekskavatoristë e buldozeristë të mrekullueshëm, që rrallë na lejnë kohë të ndezim nga një cigare duhan. E përtë shkuar akoma më tutje kemi në park një prapavijë që kurrë s'të le të turpërohesh».

Cilët janë këta njerëzit e prapavijës? Ja, brigada e motorristëve. Riparuesit e zemrës së makinave të rënda të transportit. Mes tyre Heroi i Punës Socialiste Simon Shestani. Shokët nuk e kanë të vështirë të bëjnë portretin e këtij injeshtri të palodhur, novatori të talentuar e me imazjinatë, veteranit të hidrocentraleve. «Ai, — thonë shokët, — mjafton të dëgjojë vetëm zhurmën e motorit e të jep si në radiografi gjendjen e makinës». Atë dhe shokët e tij i zë nata mbi agregatë. Jo, këtu nuk është çështje orari, sepse askush nuk të detyron të qëndrosh mbas kohës së caktuar, por është pasioni që i mban, e ky pasion ka mbirë në zemrat e çdo pjesëtarit të këtij kantieri të rëndësishëm.

Na folën në park edhe përmeshtin duarartë të riparimit të kamionëve e të automjeteve të rënda, Medi Merin. Kur po largoheshim një punëtor na u lut: «Po të shkruani diçka për Mediun, mos harroni të thoni se ai, mbi të gjitha, është njeri i thjeshtë që i do punën dhe shokët me zemër komunist».

Këtu në hidrocentral, në këtë grykë të vogël e të ngushtë, ka një jetë të madhe. Në çdo hapndeshesh me vrullin e betejës për realizimin e detyrave, por në çdo hapndeshesh edhe me kuj-

desin përnjeriun. Mund të vish këtu punëtor i thjeshtë e në mbarim të hidrocentralit të kesh kryer shkollën e mesme teknike për tornitor, elektricist, mekanik dhe bille të vazhdosh edhe studimet universitare.

Gjatë ditës, në frontin e galerive, në armaturën e tuneleve apo pranë sondave shikon minatorin, elektricistin e sondistin me inxhinierin. Në darkë, në klasat e shkollës së mësme ata janë nxënës e pedagogë. Kudo bashkë, gjithçka bashkë.

Në Koman vizituam edhe tunelin numër dy të devijimit. Ai ende s'ishte përfunduar, megjithëse për çdo rast nëpër të mund të kalonin ujërat e tepërtë të lumi. Dhe ajo ngjau me të vërtetë. Drini i rrëmbyeshëm, pa pritur ceremoninë e përrurimit vërshoi një herë edhe në këtë tunel rezervë. Në pak orë bëri shumë dëme: zuri makineri e sonda. Në gjithë hidrocentralin u dha alarimi, njerëzit u ngritën në këmbë. Bashkë me Drinin vërshuan edhe përrenjtë. Në grykën e Goshit u mbyt edhe një nga mensat e punëtorëve, të cilët në atë kohë luftonin me lumin. Akoma pa mbaruar turni, punëtorët e palodhur të ndërmarrjes së furnizimit transferuan mensën, në një godinë të përkohshme e çdo gjë ishte gati, që nga çatia e deri te gjellët e ngrohta.

Skena e thjeshtë e kinoklubit të Komanit pritet me dashamirësi artistë e këngëtarë nga e gjithë Shqipëria. Ata vinë këtu me artin e bukur për të kënaqur punonjësit e hidrocentralit e marrin me vete kujtime e mbresa që s'do t'i harrojnë përvite me radhë. Të paharruara janë edhe kujtimet e punëtorëve të rinj artistë, që për të parën herë janë ngjitur apo do të ngjiten në skenë këtu në Koman. Nesër kush e di, do të bëhen këngëtarë, valltarë, poetë apo shkrimtarë të dëgjuar. Kjo është gjë e bukur, veç të përt

bashkët do të kenë gjithmonë: kemi filluar të këndojmë apo të shkruajmë në Koman.

Jeta rrjedh në hidrocentral si lufti. Ndërrohen brezat si ndërrohet ujet e Drinit. Ka në Koman veteranë minatorë si Ramadan Alushi, Dali Lika, Baftjar Mero etj., që të rinj e filluan punën në hidrocentrale. Me shpatulla e mjete primitive, çarrë tunelin e Dajtit, dhe përvuan hidrocentralin e parë të Shqipërisë, të sapodalë nga lufta. Kush nuk e mban mend atë festë të pesë mijë kilovatëve? Sa e madhe na dukej! Sot disa nga këta minatorë e punëtorë kanë mbushur moshën e pensionit, dhe do të çlodhen, por nuk do të pushojnë, se kudo që të jenë punë, të tjera i presin. Do të largohen këta veteranë të punës nga hidrocentrali i Komanit, ku vetëm mbas pak vjetësh turbinat e tij do t'i japin Shqipërisë Socialiste 600 mijë kilovat energji elektriqe çdo orë. Sa ndryshim, i madh, 5 mijë me 600 mijë! Është kjo një rritje e fuqishme, është koha heroike e Partisë!

Koman, shkurt 1982

shëtitur qëndrueshëm, që përfundon me një kënd i lartë, që është i përshtatshëm për të mbrojtur shëtitjen e shtratin. Në këtë mënyrë, shtratin e përfunduar me një kënd i lartë, nuk mund të shëtitet, por mund të rënë. Në këtë mënyrë, shtratin e përfunduar me një kënd i lartë, nuk mund të shëtitet, por mund të rënë. Në këtë mënyrë, shtratin e përfunduar me një kënd i lartë, nuk mund të shëtitet, por mund të rënë. Në këtë mënyrë, shtratin e përfunduar me një kënd i lartë, nuk mund të shëtitet, por mund të rënë.

Ditët dhe netët e grykës së Mergunit

Nëpërmes galerive e tuneleve, në vetë shtratin e në digën e Drinit të devjuar, važhdon pa pushim, ditëse natën çimentimi e thurja me hekur-beton e grykës së Mergunit me qëllim që metër pas metri, pëllëmbë pas pëllëmbe të ngushqohet unazatë e lumit derisa të ndërpritet krejtësisht turri i rrujët e të nisë kështu krijimi i lqenit të tretë mbi Drinin shekulbor.

Deri tanë në digën, që do të jetë 115 metra, një nga më të lartat në Evropë, janë hedhur mbi mijë milion metër kub shkëmb e materiale të tjera penguese, janë gatuar e ngjeshun mijëra tonë hekur-beton, edalë nga edalë shkëmbi, në mes të grykës, po lidhet përmes gjymtyrëve të hekurta me krahët e Drinit. Në Komani nuk ka front pune të parëndësi shëm, as nuk ka front pune të dorës së parë apo të dorës së dytë. Këtë e ndiem kudo, që nga sigurorja, sallatë makinerive, kullat e ekuilibrit

e deri te centrali telefonik «Provoni, — na thotë një dispeçer, — të ndërprisni për pak kohë linjën telefonike e pastaj të shikon se çfarë ngjet në kantiere».

Ashtu është vërtet. Dhe këtu qëndron edhe forca e drejimit në front të përgjithshëm në hidrocentralin «Enver Hoxha» të Komanit. Por beteja për ngritjen e ekranit të digës mbasse është më e dukshmja. Ekratin e digës, do të na pëlqente ta quanim më mirë «parzmore çeliku». Kjo parzmore i vishet malit që i zë rrugën Drinit. Çdo pëllëmbë e kësaj faqeje pastrohet si të ishte sofër buke, pastaj vishet me astalt, beton e hekur-beton, trashësia e të cilit arrin në mbi një metër.

U ngjitëm me një grup shokësh në pjerrësi-në e digës e duke hedhur vështrimin mes ndërtuesve të shumtë e ndjemë veten disi ngushtë pa kamerën televizive. Jemi mësuar shpesh të udhëtojmë nëpër veprat e vendit tonë me grupet e xhirimit e gjithnjë puna na është dukur më e lehtësuar, pasi shumë gjëra s'kishim njëvojë t'i përshkruanim në tekst, sepse kamerat, afiksonin me shumë vërtetësi çdo gjë përreth. Por këtë boshillëk, shumë shpejt na e mbushën bisedat e ngrohta të njerezve plot pasion e dashuri përpunën, për shokun.

Në ekratin e digës, punojnë shumë specialistë, projektues e zbatues. Në mes tyre Zijai, Shuaipi, Pandeliu e të tjera. Brigadat hekur-kthyese e saldatorë, që ata drejtojnë, krijojnë pandërprerje skeletet, e metaltë. Mbasi tyre vjen Xhem Peca me shokë derdhin e ngjeshin pa puçhim betonin, nëpërmjet kallëpëve rrëshqitës. Një metodë e re kjo që përdoret për herë të parë në vendin tonë dhe që është nga teknologjia më moderne që njihen. Dhjetra mjeshtër të

tjerë karpentjerë, hidraulikë, kontrollorë të cilësisë punojnë e vëzhgojnë ditë e natë punimet e digës. Një fjalë e urtë popullore thotë: «Njeriu me njeriun takohen, mali më mal s'takohen». Jo, këtu në Gushtën e Drinit, nëpërmjet digës «potakohen» edhe malet.

Në bisedat e njerëzve në Koman më shpesh se për çdo gjë flitet për kohën. Koha këtu me të vërtetë është e shtrenjtë, është «mall» i kush-tueshëm, e jo si diku në ndonjë zyrë qaramane që si pa gjë të keq të thonë: «Hajde nesër, prit ta shohim, ose, duku nga jaya». Në hidrocentral s'ka kohë për nesër. Një drejtori i telefonuan në zyrë dhe i thanë se në sëktorin e tuneleve du-heshin disa elektropompa. Ai i erdhë në vend, jo për tu sqaruar, por për të marrë masa të menjëherëshme.

Nuk vaken shënimet tona po të tregojmë edhe për një mbledhje javore të këshillit teknik që u zhvillua para disa ditësh. Ajo kryesoheq nga Ismail Ahmetaj, drejtor i ndërtimit të hidrocentralit. Këtu nuk pati as hyrje të përgjithëshme, as lustër e rrumbullakosje, por aty gjithçka fliste për ato porosi të rëndësishme që dha Partia në Kongresin e 8-të. Mbledhja u zhvillua e shkurtër, me fjalë të kursyera u fol për reali-zimin e detyrave, u tha çfarë kishte mbetur pa kryer, u përcaktuari edhe përgjegjësitë, por pa bërë «biografinë» e gabimeve dhe pa sjellë lista me justifikime.

Këtë frysë e gjetëm në të gjithë sektorët e kantierët që shkuam. Ja, kapanonin e oficinës së automjeteve të rënda të transportit, që është një fushë futbolli, e gjetëm pothuajtë boshatisur. Në një cep të saj kishte vetëm 2-3 makina që po riparoheshin. Inxhinieri Tomor Bushati na flet për organizimin e punës.

— I kemi vënë vetës detyrë t'i përgjigjemi të gjitha zotimeve të sektorëve të tjerë në kërkësat për transport. Dhe kjo nuk është aq e lehtë, sepse atë që vendosin të gjerrmojnë më shumë, apo të tjerët që do të gatuajnë beton më tepër, po nuk e transportuan ne...

Ata që vizitojnë tanë Komanin, mund të themi se fitojnë një përfytyrim më të plotë për hidrocentralin. Zemra, e malit, në të dy krahët e Drinit, është plot tunele e galeritë formave e përmásave të ndryshme. Për t'i përshkuar të gjitha ato do të duhen rrugë. Një pjesë e këtyre tuneleve, që i kanë formën e rrumbullakët, tanë po vishen me tuba çeliku. Nëpërmjet tyre do të marrin rrugë ujërat e Drinit për në turbina. Këto tunele janë aq të gjerë, sa në to mund të kalojnë lirisht makina e buldozerë të rendë.

Tunelet e galeritë e tjera janë ato të devijimit, të shkarkimeve; rruga për lehtësimin e ndërtimeve etj. Të gjitha këto, nesër do të zihen nga ujërat ose do të vulossen e nuk do të shihen më. Do të imbetet në kujtesë vetëm puna e njërrëzve, e atyre që po ngrenë këtë vepër madhështore. Por cilët janë këta njerëz? Qindra e mijëra bij, nga të katër janët e Shqipërisë, që vijnë e shkojnë si zogj shtegtarë. Një pjesë e tyre e kanë lidhur dhe jetën me veprat e energjetikës. Përontë është shkruar në shtyp e ka folur Radio-televizioni, por puna e tyre e vyer ka aq ngjarje e heroizma, si lumi që nuk soset rašnjëherë.

Hashim Zýberi ka 17 vjet hidrocentraleve. Ai drejton brigadën «Ismet Sali Bruçaj», që me krijimin e saj, Brigada është komplekse dhe ka 120 pjesëtarë. Ajo, siç na thonë në Komitetin e Partisë të hidrocentralit, e ka vandin në frontet më të vështira, dhe kjo, sepse secili në këtë brigadë udhëhiqet nga motojanë peshën e rendë për



Shoku **Enver Hoxha** dhe Mjeshtja e merituar e sportit
E. Karabollë në Sparriakiadën e IV Kombëtare. 1979.

Gjatë një stërvitjeje në poligonin e qitjes.





Një pamje nga dëmtimet e tërmetit të vitit 1905
në qytetin e Shkodrës.

Tërmeti i prillit 1979 bëri shumë dëme, por solidariteti
socialist iu vu përbollë që në orët e para.






Lagjja e Bahçallékut, e re dhe
e bukur në hyrje të Shkodrës

Në pragun e përrurimit. Nga fshati i shkatërruar
nuk ka mbetur asnjë gjurmë.





Nga puna
për ndërtimin
e montimin
në kantieret
e hidrocentralit
“Enver Hoxha”
në Koman





Gjatë Festivalit Folklorik Kombëtar, Gjirokastër, 1983.

Në Koncertet e Majit





15 prill 1985. Populli e Partia përcjellin birin dhe udhëheqësin e dashur, shokun **Enver Hoxha**, për në Varrezat e Kombit.



Shoku Enver Hoxha midis një grupei punonjësish të shtypit, të Radiotelevizionit e të Kinostudios.



Gjatë punës në një nga studiot e Televizionit.

vete». Tani ata kanë ngritur frontet në ndërtesën e centralit, në kanalin e largimit të ujërave e së domos te të dy kullat se ekuilibrit.

Pjesëtarët e brigadës punojnë, mësojnë, bëhen specialistë, ngrihen në përgjegjësi. Nga koha në kohë brigada përtërihet, me gjithëse mbi 40 shokë janë që me krijimin e saj. Në krye të tyre është brigadieri, Hashimi.

— Kur ke më shumë telashe në brigadë? — e pyetëm sa për të hapur bisedën.

Shokët që kishim pranë filluan të qeshin. Si duket kishte ndonjë histori.

— Do t'ua shkoqis unë, — ndërhyri një shok i tij inxhinier. — «Telashet» më të mëdha Hashimi i ka kur i vijnë punëtorë të rinj. Një herë mori një grup djelmoshash nga Kukësi. I njoihu me punën, me shokët, me rregullat, me disiplinën e pastaj çdo ditë u rrinte pranë edhe përt'i mësuar, por edhe për kohën e punës. Mbas disa muajsh njëri nga këta pyeti një nga shokët më të vjetër: More, i ndërroni këtu në Koman ndonjëherë brigadierët se ne atje në kooperativë...

— Po tani?

— Tani qeshin, Hashimin e kanë shok, mësues e prind. Jo për punën, por ai interesohet edhe për gjumin, ushqimin bile edhe në se i kanë shkruar shtëpisë letër apo jo.

Dedë Gjoni erdhi nga Kruja për të kryer stazhin e Partisë. Kur plotësoi kohën në vend që të ndahej nga shokët, vendosi të mos kthehej në Laç pa përfunduar hidrocentrali. Deda drejton një brigadë karakteristike që punon vetëm natën, ndaj edhe quhet «brigada e natës». Ajo merret me shhangien e defekteve në makinat e rënda të transportit.

Drejtuesit e nëpunësit në Koman kanë «orar»

të reduktuar në zyra. Dhe vërtet, ata fare pak i gjen lidhur pas karrikes. Po ku e si e kryejnë punën? Ata i gjen me orar e pa orar atje në frontin e prodhimit, te tunelet e diga. Këtë e pamë kur shkuam në çdo kantier. Agimi, që na shoqëronte në këto biseda, shoferi e dispeçeri i dikurshëm i dalluar, tanj sekretar i parë i Komitetit të Partisë të hidrocentralit, gjente punë njëlloj si ne. Ai u linte takime njerëzve në ditë e orë të caktuara, atje në frontin e punës, pa u përmendur asnjëherë zyrën.

Komani pret e përcjell shumë vizitorë. Ata vijnë nga krahina të ndryshme të Shqipërisë. Vijnë jo vetëm për të parë veprën, por edhe për t'u takuar me ndërtuesit e saj, shumë prej të cilëve i njohin nëpërmjet televizorit.

Vinë në Koman edhe të huaj, delegacione, gazetarë, afaristë etj.

Komani, që po shkruan një histori të re në ndërtimin e Shqipërisë Socialiste, edhe më parë ka tërhequr vëmendjen e historianëve e studiuesve. Shekuj të shkuar këtu kalonte një rrugë kryesore që merrte nisje nga brigjet e Bunës e soste në dyert e Prizrenit e të Gjakovës. Por më shumë filloi të dëgjohej për Komanin mbas vitit 1899, kur konsulli i Francës në Shkodër A. Degrant, me ndihmën e franceskanëve, zbuloi varrezën e kalasë së Dalmacias. Për gjërrimet e gjetjet e rëndësishme arkeologjike ai shkroi më vonë librin «Kujtime nga Shqipëria e Veriut», botuar në Paris në vitin 1901.

Pikërisht, këtu në Koman ku skamja e varfëria kishin bërë mbretërinë para Çlirimt, disa javë më parë erdhi trupi diplomatik i akredituar në vendin tonë, jo për të parë zbulimet arkeologjike, që edhe ato kanë një vend të nderuar, por ndërtimin e hidrocentralit «Enver Hoxha».

që do të jetë një nga veprat e mëdha të energetikës në Evropë.

Sa kanë ndryshuar kohët në këto vitet e Çlirimt. Sa lartështë ngritur Shqipëria, nga libri i konsullit, te libri i madh i ndërtimit të socializmit. Ndaj sot të huajt befasohen shpesh jo vetëm nga përmasat e vepërës, por edhe për cilësinë e ndërtimëve; e në menyrë të veçantë, ajo që gati u duket e pabesueshme, që këtë hidrocentral e ndërtojmë me forcat tonë.

Kohë më parë, siç na tregon Skënder Kosuri, zëvendësdrejtor i kësaj vepre, erdhën dy publicistë nga Brazil. Gjithçka ju duk perfekte dhe e shfaqën kënaqësinë pa asnje ngurim. Në fund shoqëruesi ynë u thë se kemi dëgjuar që në Brazil, mbi lumin Parana, është ndërtuar hidrocentrali më i madh në botë, me mbi 12 milion kw.

— Kjo është e vërtetë, — ju përgjigjën ata, — por vetëm si fuqi, pasi për ndërtimin e tij u futën me projekte, me kredi, me specialistë edhe 5-6 vende të tjera kapitaliste. Pra, Brazili aty ka vetëm emrin. Tani bile edhe shfrytëzimi i tij ka sjellë një mijë telashe, sepse dhjetëra shoqëri kërkojnë pjesën e tyre. Ndërsa ne mendojmë e këtë e themi pa komplimente, se hidrocentralin më të madh e ndërtoni ju. Kjo potë merret parasysh numri i popullsisë, e kryesisht gjithçka me forcat tuaja.

Në hidrocentralin «Enver Hoxha» të Komunitatit nuk ka natë, bile turni i tretë është më i zhurmshmi, sepse oshtima e maleve përcjell bashkë me zhurmën e valëve të Drinit edhe uturimën e makinave të fugishme, buldozerëve, sondave e pistoletave të minatorëve.

Edhe ne nuk na zuri gjumi deri vonë. Në orët e para të mëngjezit hodhëm në shënimet

tona edhe këto shifra: çdo ditë në ekrarin e digës vendosen 20 tonë hekur, hidhen mbi 500 metër kub beton. Deri tani janë hedhur 73 përqind e mbushjeve në digë. Tejkalimet në Koman nuk janë thjesht rezervë përmuajt e ardhshëm. Çdo tejkalim këtu është materializim i zotimit që një muaj para afatit, pra më 29 nëntor 1985 të jepë energji elektrike turbina e parë e hidrocentralit.

Një muaj para afatit! Kjo do të thotë 100 mijë kw/orë energji elektrike.

Me faqë të bardhë.

Koman-Tiranë, nëntor 1984

Me fakta që sot vjen me rastin e afatit të zhvillimit të hidrocentralit Koman-Tiranë, më 29 Nëntor 1984, do t'i bëj komunisht që këtë afat është i vlefshëm.

Me fakta që sot vjen me rastin e afatit të zhvillimit të hidrocentralit Koman-Tiranë, më 29 Nëntor 1984, do t'i bëj komunisht që këtë afat është i vlefshëm.

Me fakta që sot vjen me rastin e afatit të zhvillimit të hidrocentralit Koman-Tiranë, më 29 Nëntor 1984, do t'i bëj komunisht që këtë afat është i vlefshëm.

Me fakta që sot vjen me rastin e afatit të zhvillimit të hidrocentralit Koman-Tiranë, më 29 Nëntor 1984, do t'i bëj komunisht që këtë afat është i vlefshëm.

Me fakta që sot vjen me rastin e afatit të zhvillimit të hidrocentralit Koman-Tiranë, më 29 Nëntor 1984, do t'i bëj komunisht që këtë afat është i vlefshëm.

Me fakta që sot vjen me rastin e afatit të zhvillimit të hidrocentralit Koman-Tiranë, më 29 Nëntor 1984, do t'i bëj komunisht që këtë afat është i vlefshëm.

Me fakta që sot vjen me rastin e afatit të zhvillimit të hidrocentralit Koman-Tiranë, më 29 Nëntor 1984, do t'i bëj komunisht që këtë afat është i vlefshëm.

Me fakta që sot vjen me rastin e afatit të zhvillimit të hidrocentralit Koman-Tiranë, më 29 Nëntor 1984, do t'i bëj komunisht që këtë afat është i vlefshëm.

Me fakta që sot vjen me rastin e afatit të zhvillimit të hidrocentralit Koman-Tiranë, më 29 Nëntor 1984, do t'i bëj komunisht që këtë afat është i vlefshëm.

Me fakta që sot vjen me rastin e afatit të zhvillimit të hidrocentralit Koman-Tiranë, më 29 Nëntor 1984, do t'i bëj komunisht që këtë afat është i vlefshëm.

Me fakta që sot vjen me rastin e afatit të zhvillimit të hidrocentralit Koman-Tiranë, më 29 Nëntor 1984, do t'i bëj komunisht që këtë afat është i vlefshëm.

Me fakta që sot vjen me rastin e afatit të zhvillimit të hidrocentralit Koman-Tiranë, më 29 Nëntor 1984, do t'i bëj komunisht që këtë afat është i vlefshëm.

shqiptarët e cili i kishin qenë përmes gjithë historisë së Shqipërisë. Në këtë mënyrë, Gjirokastër është një qytet i rëndësishëm i Shqipërisë, i cili ka një histori të larta dhe të vjetër. Në këtë mënyrë, Gjirokastër është një qytet i rëndësishëm i Shqipërisë, i cili ka një histori të larta dhe të vjetër.

Në Gjirokastër e gjithë Shqipëria

Gjirokastra, qyteti i gurtë, që në shekuj hodie themellet mbi shpatet e Malit të Gjerë përtu bërë i pavdekshëm në historinë e popullit të tij vendit tonë, po jeton sërisht në këtë tetoritet vitit 1983 një gëzim, që vjen çdo pesë vjet, gjithnjë më i bukur se tjetri.

Historia këtij kaluar sa herë mbi rrugët e këtij qyteti, sa herë kanë parë ato beteja e luftëra, por kanë pritur këto rrugë monumentale, këto kallëdrëmë edhe shumë gëzime, kanë pritur lirinë e fituar në agimin cilimtar, kanë ndjérë hapin e Enver Hoxhës duke ecur e duke kuvenduar aq thjeshtë e aq bukur me njerëzit e mirë; mes të cilëve lindi dhe u rrit. E, ja tani, Gjirokastra trime e stolisur me hijeshi, ka dalë këtyre monopatave, këtyre shesheve e rrugëve muzeale përtë pritur vëllezërit e motrat nga qytete e krahina të ndryshme, ka ardhur në Gjirokastër e

gjithë Shqipëria për të marrë pjesë në festën e madhe të artit e kulturës socialiste, në Festivalin Folklorik Kombëtar 1983.

Një popull i tërë i punës dhe i pushkës ka sjellë sot në sofrën e kalasë, në këtë truall të lashtë të kaq ngjarjeve historike, shpirtin e tij krijues, traditën e pavdekshme të artit, që kallon nga brezi në brez, duke u pasuar e duke e ruajtur freskinë e bukurinë e tij të pashoqe.

Këtu, me ison burrërore labe do të bëshkohet émbël melodja e fyejve të Gramshit dhe e buzukut të Kolonjës. Do gjëmojë daullja e Kukësit dhe e Dibrës e do ja marrë hareshëm curlja dyjare. Do të vihen në dýzen çiftelitë e Pukës e të Malësisë nga Kelmendi deri ku buron e derdhet Drini e Valbona e bardhë.

E si ta shprehim madhështinë e këtij festivali, të kësaj festë të madhe: poeti me vargje, shkrimtarët në mendime. Po ja se edhe me gjuhën e shifrave ajo tingëllon interesante: Për të arritur deri në këtë festë të madhe u ngritën, në 200 zona të Shqipërisë, 2 300 grupe artistike me mbi 7 000 pjesëmarrës amatorë. U kënduan afro 14 000 këngë, prej të cilave mbi 8 000 të reja. Në skena e podiumeve hodhën mbi 3 000 valle e, të gjitha këto me një larmi të madhe stillesh e kostumesh popullore. Nga i gjithë ky lumë, këngësh e vallesh, për konkurimin e këtij viti u përgatitën 26 koncerthe, 26 bugeta me lule, stoli e re për qytetin e lashtë e të ri të Gjirokastrës.

Sonte është nata e parë e mirëseardhjes. Gjithë pjesëmarrësit do të janë miqë në sofrat e familjeve gjirokastrite, ndaj janetë e dashura e të mira janë plot gëzim e shqetësimi e bisedojnë se sivjeti presin sa më mirë bijtë e bijat, yellezërit e motrat, nga e gjithë Shqipëria.

Po sonte, ka edhe diçka tjetër të bukur, sepse është shfaqja më e madhe që do të bëhet në këtë festival, pasi në çdo shtëpi, miqtë e të ftuarit, së bashku me mikëpritësit do t'ja marrin këngës e në vatrën gjirokastrite do të gjëmojë si, asnjëherë kënga e vallja gjirokastrite. Ima-gjinata na merr me vete e themi: kushedi ç'pa-mje mahnitëse do të ketë gjithë ky gjëzim, gjithë ky koncert i paparë, ku do të këndoje e do të hedhë valle njëherësh një qytet i tërë dhe mijëra artistë nga e gjithë Shqipëria.

Por veç këngës, e valles duam të tregojmë, në reportazhin tonë, se këtu në Gjirokastër, çdo shtëpi është një kënd muze, e shumë nga ato ruajnë brenda një luftë, një betejë, një faqe historie.

Kudo që të jesh mik në Gjirokastër, në shtëpitë e pastra e të rregulluar me aq merak, përsëri nuk të rrihet pa vajtur për të vizituar edhe disa shtëpi, të zakonshme, por edhe të veçanta. Në to sïkur çmallesh e kujton vitet e shkuara e të tanishme.

Një nga këto shtëpi është ajo e Bajo dhe Çerçiz Topullit. Në vitet e fillimit të këtij shekulli e dëri vonë, i gjithë populli i njohu krismat e armëve të tyre në fushën e betejës përlirinë e pavarësinë e Atdheut, e njohu mençurinë e tyre. Ata s'kursyen asgjë pér vatanin. Kënga popullore thotë:

*Di djem nga vendi inë
Vetë ç'e prishnë shtëpinë...*

Vërtet vetë e prishën shtëpinë, sepse ata me vetëdije u ngritën kundër armiqve pushtues turkomanë dhe e dinin se çfarë do të vinte pra-

pa, po kjo nuk i tuti, përkundrazi i bëri trima mbi trima. Armiqte ua dogjën dhe ua rrëzuani shtëpinë duke e bërë njësh me tokën, por kjo shtëpi te toka e kish fuqinë. Me Bajon e Çercizin ishtë i gjithë populli. Ai i ngriti shtëpitë ashtu siç ishin. Ato dolën nga tymi i luftërave e betejave, ndaj janë shtëpitë e historisë.

Ja edhe një shtëpi tjetër që i përket gjithë qytetit. Këtu ka lindur e jetuar Muzo Askeriu, dëshmori i parë i Luftës Nacionallirimtare në Gjirokastër, Hero i Popullit. Në rrugët e sokakët ku ka bredhur me kalamanët moshatarë, një grup folkloristësh nga Tropoja ia ka marrë një këngë majekrahu për trimëritë e Luftës Çlirimtarë.

Mbasi zbut Qafën e Pazarit e ecën tutje drejt shpatit, të del përpara një derë e madhe. Është kjo një shtëpi e gjithë popullit. Këtu më 16 tetor 1908 lindi Enver Hoxha, ai që me Partinë e bijtë e popullit, morën stafetën e ngjeshën armët për beteja të reja, ngritën luftën e popullit shqiptar në piedestalin e pavdekshëm të historisë...

Vitet shkojnë e çdo ngjarje, çdo betejë, çdo fitore na kthen të kjo shtëpi. Na kthen përtu çmallur, për të kujtar, na kthen edhe për historinë. Dhomat e kthihat e kësaj shtëpie, korridoret dhe objektet në mure, kujtime të viteve të shkuara, janë edhe kaq të afërta, sepse ato lidhen me jetën e njeriut që së bashku me ne, në popull e pranë popullit, për 75 vite me radhë, ecën në një rrugë plot vrull e rritje, plot këngë e beteja, plot fitore në ndërtimin e Shqipërisë Socialiste.

Duke ecur monopateve e sokakëve u ngjitëm në truallin e kalasë, në skenën më të madhe të Shqipërisë, në atë podium ku dërrasat ende

mbajnë arömën e pishës e në shkallët e saj të gdhendura me aq mjeshteri ku duket sikur ende nuk është tharë betoni lidhës.

Këtu, për 6 ditë me radhë, grupet artistike të artit popullor, të veshur me afro 500 lloj kostumesh, nëpërmjet këngës e valles, do të demonstrojnë, talentin e pavdekshëm të popullit, nëpërmjet këtij arti do të na flasin për rrugën e lavdishme që ka kaluar ai deri sa u ngjit në këtë skenë i lirë dhe i pavarur, me Partinë e tij sokoleshë e shokun Enver Hoxha në krye. Nuk ka si të mishërohet më bukur trädita me të sotmën! Kalaja është trualli; është skena e atyre këngëve e valleve që mbajtën e mbajnë të ndezur dashurinë për këtë tokë të shenjtë, i

Kënga ka qenë për ne flamur e kushtim lirie. Ajo na ka shoqëruar në gjëzime, e festa, në punë e fitore, në luftëra e beteja ajo ka ndezur zjarr istikamet.

Vijnë grupet njëri pas tjetrit. Në zérin, në interpretimin, në hapin e valles së tyre, është forca e historisë, jeta me të gjitha ngjyrat e saj, që nga lindja te dasma e deri te guximi e trimëria. Të gjitha grumbullohen këto ditë në këtë skenë, që edhe vetë ajo është një histori.

Vallet e këngët nuk kanë të pušhuar te ky truall i kalasë, ku sot është ngritur kjo skenë kaq e madhë arti. Sa hijë i ka... Vetë populli e ngri- ti këtë kështjellë për t'u mbrojtur. Historia nă rrëfen se punimet për ndërtimin e kësaj kala- je filluan aty nga shëkulli VI i erës së re. Më vonë dyndjet pushtuese u sulën mbi të për ta rrëfshuar, për ta zhdukur. Shumë ngjarje e stu- hi luftërash kaluan mbi këto mure e mbi këto bedëna, por ajo rezistoi. Dëmtonej e rindërtöhej, rindërtöhej e bëhej gjithnjë e më e fuqishme. Një kalimtar franez, aty nga shekulli XVIII,

thotë se për përforcimin e kalasë, punonin çdo ditë 1 500 deri 1 700 forca.

Në Luftën e Parë Botërore, sheshi i kalasë u kthye në gazerma të ushtrive të huaja.

Në luftën për çlirimin e Atdheut, këto mure e sheshe të kalasë, panë përleshjet heroike të partizanëve të Brigadës VIII Sulmuese kundër pushtuesve gjermanë, e atyre që ishin bashkuar me ta.

Sa hije i ka tanë festivali këtij trualli heroik, kësaj skene të madhe të artit të popullit, këtij arti të pavdekshëm si vetë kalaja që i ka rrënjet si muret, thellë rië tokën nënë. Ndaj këngët e vallet me aq bukuri i bëjnë jehonë të djeshmes, i këndojnë fuqishëm të sotmes e plot optimizëm të ardhmes.

Populli i rrëthit të Gjirokastrës, që në historinë e Atdheut ka dhënë kontributin e vet të çmueshëm me pushkë e penë, e ka dashur, e ka rritur dhe e ka zhvilluar edhe kulturën e artin. Ka luftuar për ta mbrojtur atë. Gjirokastra nuk është qytet muze vetëm për ndërtimet, për atë arkitekturë, të rallë që mahnit çdo vizitor, por mban në gjirin e vet edhe vlera kolosale që kanë të bëjnë me kulturën, me artin, me atë mençuri të popullit të shprehur me vargje, në këngë, në valle, në ritet e zakonet e lashta, në traditën e bukur socialiste që po krijohet.

Shoku Enver Hoxha, në përshëndetjen drejtuar popullit të rrëthit të Gjirokastrës, me rastin e përrurimit të qendrës muzeale, ka thënë: «Sa shumë theşare të vyera ruan kjo kodër historike në mes të Gjirokastrës. Aty është folur me pushkë e penë për Shqipërinë... Aty, në vatra si këto, janë themelët e para të shkollave që sot mbushin arëmbanë Shqipërinë. Aty lindën ske-

nat e para të teatrove amatore dhe profesioniste».

Mbi këtë kodër, ruhen edhe klasat e thjeshta, me dritaret karakteristike, të mësonjëtoren «Liria». Sa punë e përpjekje u bë, që nga Cërçiz Topulli e deri te Thoma Papapano, Hysen Hoxha etj., e me mbështetjen këmbëngulëse të atdhetarit të njohur Hasan Prishtina, që të mos mbylleshin ato klasa të shkollës e të dijes, të punës, të luftës e të lirisë.

Duke ecur nëpër rrugën që të con në Qafë të Pazarit, njeriut i shkojnë sytë te një pllakë përkujtimore, afro 100 vjet më parë erdhë këtu në Gjirokastër Abdyl Frashëri, i dërguari i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, të cilën ai e kryesonte, dhe organizoi aty mbledhjen me përfaqësues nga krahinat e ndryshme të vendit për të vazhduar luftën e për të mos ju përkulur askujt, për të mos pranuar asnje lëshim apo pazar llék në dëm të lirisë e të pavarësisë së Atdheut.

Kurvelesh e Gegëri

C'u mblodhën në Ergjëri...

Janë vargjet e atdhetarit Koto Hoxhi. Edhe këto vargje i kanë hipe festivalit. Është mbledhur sot në Gjirokastër e gjithë Shqipëria, në një «kuvend» këngësh e vallesh, që, në mes të tjerash, i këndojnë edhe punës e përpjekjeve të atdhetarëve tanë për Shqipérinë, për kombin.

Pret Gjirokastra festivalistët me sofrën shtruar, me arritje në të gjitha fushat, me një popull që e do tokën, e do arsimin e kulturën, e do artin e krijimtarinë. Në këtë rreth tani, ka dy shtëpi kulturore në qytet e shtatë në fshat, ka bibliotekën, teatrin e estradën profesioniste. Kudo në kooperativa e qendra pune e prodhimi janë

ngritur grupet amatore e folklorike. Vetëm në festivalin e sivjetëm të rrethit morën pjesë afro 4 000 amatörë. Në këto grupe artistike janë të gjithë brezat, plaq e të rinj që këndojnë e hedhin valle së bashku e mësojnë së bashku.

Kanë, gjirokastritët mikëprites edhe një me-rak tjeter të madh: duan të paraqesin sa më bukur koncertin e mirëseardhjes. Kjo nuk është një detyrë e vogël. Përgatitjet janë bërë të shumta. Do të mbushet e do të buçasë i gjithë stadiumi, që nga qindra piesëmarrës në kordin e fëmijëve e deri te grupet polifonike, nga kënga heroike e vallet e ditëve tona e deri te orkestra simfonike, që sivjet, për herë të parë del para publikut.

Të gjitha këto që treguan janë pak për tu njojur me gjithë atë punë të madhe që është bërë për përgatitjen e festivalit, me gjithë atë punë që kanë bërë vetë gjirokastritët duke rregulluar e pastruar çdo gjë: shtepitë e rrugët, duke lyer çdo prak e derë.

Të gjitha sa shkruam janë ende pak për tu njojur me Gjirokastrën, me të kaluarën e të sojmen e saj. Por është fat që në prak të këtij festivali lexuesit tanë kanë në dorë librin e ri të shokut Enver Hoxha «Vite të vëgjelisë» që sapo ka dalë nga shtypi. Të marrësh penën e të shkruash për Gjirokastrën mbas këtij libri nuk është e lehtë, aq më tepër kur e ndjen se edhe ato gjérat që i kë vizituar e parë vetë, që i kë prekur me dorë, përsëri kur shkruan për to të duket se diçka kë lënë në harresë, diçka të ka mbetur pa thënë.

Tani që kemi në duar librin e shokut Enver, «Kujtime të vegjelisë» na duket e drejtë të themi se pa lexuar këtë vepër, këto kujtime aq jetësore në jetën e në familjet, të një lagjeje,

të një qyteti të tërë, nuk mund të thuash se e njeh, Gjirokastrën.

Sa kaluam, me shënimet tona, në vite e ngjarje të paharruara, sa soditëm këtë qytet të gurtë e të papërsëritshëm, në sofrën e madhe të kalasë ka filluar festa, ka filluar konkurimi, këngë e vallja dëgjohen deri poshtë grykave e fushave ngjyrë ari të luginës së Drinos. Jehona e tyre shkon deri në Çajupin krenar e i kthehet përsëri me ushtimë Malit të Gjerë.

Radiotelevizioni, Kinostudioja kanë filluar punën me vëmendje shembullore. Ata do të fiksojnë forcën, bukurinë, ndjenjat e këtij arti të madh e të pavdekshëm të këtij festivali me bukuri mahnitëse.

Gjirokastër, tetor 1983

Kënga mori udhë...

Kënga si emri të ndjek pas tërë jetën. Ajo nis që me përkundjet e hapat e para e, tutjë ecën nëpër vite, deri në moshën e thyer. Njeriu mplaket, kënga jo.

I duam këngët tonë, këngët e bukura për kreshnikët e trimat e maleve, për heronjtë që shkuan drejt vdekjes për liri, me këngë në gojë. I duam këngët kur këndohen në kore e majëkrashut, pranë zjarrit partizan e në marshime. I duam këngët në festa e dasma. Edhe vallen kur e hedhim vënçe me këngë e shoqërojmë, edhe rrugës kur ecim nga një këngë, nën zë, me vete këndojmë...

Na erdhën këto mendime tek po dëgjonim me vëmendje një këngë të interpretuar nga artistja jonë e mirënjohur Vaçe Zela. Zëri i saj melodioz e kumbues të fuste në një botë plot ndjekja e frymëzim, të mbushte me optimizëm. E, njeriu në vetvete, ashtu pa dashur, rri e mendon përrugën e këtyre talenteve, që me aq mjeshtëri e art përcjellin këngën e bukur shqiptare.

Po si mori udhë kënga tek artistja jonë
Vaçe Zela?

Aty nga fillimi i viteve '60-të, në Fierin ende të vjetër, në mes të qytetit, ishte një teatër i vogël, si një barakë druri e ndarë nga të gjitha ndërtesat e tjera. Njëreza e thërrisin me emrë të ndryshëm: ca klub, ca kinema. Në fakt ajo ishte një sallë që shërbente për gjithçka në Fier. Sot e kësaj dite e kemi në mendje, në kujtesë atë sallë me ato dyert e dritaret e vogla, të vendosura pak nën çati, si të ishte magazinë. S'kishte asnjë lloj mqedisi për interpretuesit, mba-si nga kuintat e skenës, përmes një dere të vogël «artistët» apo interpretuesit dilnin në rrugë. Aty edhe përgatiteshin, aty edhe bënин ndonjë provë e pastaj ngjiteshin në skenë.

Asgjë s'kishte për t'u mbajtur mend kjo sallë po të mos ishte... Vaçe Zela. Atëherë ajo ishte fare e re, amatore e shtëpisë së kulturës së Lushnjës dhe, bashkë me një grup këngëtarësh kishin ardhur për të dhënë shfaqje në Fier.

Më kujtohet, dy radhët e para të sallës i kishim zënë ne të ardhurit me shërbim në këtë qytet. Kaq shumë njerëz kishin në sallë sa korridori as që dukej fare. Ishin hapur edhe dyert, e, në dritare «ishin varur», më të pasionuarit, që nuk kishin siguruar dot biletë.

Koncerti filloi. Numrat po kalonin njëri pas tjetrit e, shikuesit filluan të thërrisin: «Të dalë Vaçe Zela, të dalë Vacja!». Mirëpo koncerti po shkonte nga fundi e Vagja që asaj dite s'kishte qenë edhe aq mirë, s'po dilte. Pas shumë kërkeshash, më në fund ajo u ngjit në skenë dhe këndoi dy këngë radhazi. Salla buçiti nga duartrokitjet, pastaj secu u njoftua një numër tjetër, por spektatorët u ngritën e filluan të lënë sallën.

— Kemi ardhur vetëm për të dëgjuar Vachsen, — thanë ata.

Kjo ishte njohja jonë e parë me artisten e talentuar. Ajo sallë e vogël e thjeshtë dhe ai zë aq i bukur, më janë ngulitur në mendje, ashtu bashkë, e nuk i ndaj dot kurrë nga përfytyrimi.

Më pas, disa herë më ka rastisur të takohem me Vachsen, të flasim për pasionin e jetën e saj...

E gjithë ajo që mund ta quajmë fillimi, ka nisur edhe te një çezmë e thjeshtë, në një lagje krejt, të zakonshme, në qytetin e Lushnjës, aty nga mesi i viteve 50-të. Në atë kohë Lushnja i ngjante më shumë një fshati të madh dhe banorët e saj merrnin ujë, si në shumë zona të vendit tonë, në atë, kohë, nga çezmat, që zakonisht vendoseshin në krye të rrugës.

Nga pjesëtarët e familjes Zela, Vachsen vinte më shpesh se të tjerët në çezmë. Vajza e vogël, që nuk e bënte aspak me përtesë këtë punë, gjatë kohës së pritjes në çezmë apo kur mbushte ujin këndonte, ashtu për vete, herë nën zë e, herë harronte e kënga dëgjohej deri larg...

Kënga dhe uji, Vachsen e vogël, nga gjëzimi i këngës, hutohej e si mbi krahët e dallëndyshes shëtiste diku larg fushave të Myzeqesë.

E gjithë kjo histori e thjeshtë, pak edhe romantikë, do të kishte mbetur sekret në jetën e Vachsen po të mos ishin spektatorët e parë të saj, lushnjarët e mirë që i duan këngët, gjëzin, punën. Ata mblidheshin te çezma, ashtu pa e vënë re e ndiqnin me vëmendje zërin e bukur të fqinjës së vogël dhe, secili shprehëtë dikça, thoshëtë dikça. «I lumtë, këndon bukur!», «Do të bëhet e dëgjuar me atë zë të kristaltë!». «Duhet më u thënë shokëve të komitetit» etj, etj.

Shpesh në pak minuta te çezma grumbullohen aq shumë dëgjues, sa që Vajza e vogël

habitej, gjëzohej, por edhe turpërohej, ndaj merrte shtambën e vraponte në shtëpi.

Më shumë Vaçja këndonte në oborr të shtëpisë. Edhe kur punonte, edhe kur mbaronte detyrat e shkollës, edhe kur i vinin shoqet, Vaçja këndonte, gjithnjë këndonte.

Një ditë, arsimtari i vjetër, mësuesi i ndruar, por edhe dashamirës i këngës e i muzikës, Aleksi, e mori Vaçen e vogël për dore dhe e solli në ndërtesën ku sot është Muzeumi i Kongresit të Lushnjës. Në atë kohë aty ishte shtëpia e kulturës.

— Ju kam sjellë një këngëtar që nuk do ta ndani asnjëherë nga skena, — u tha Aleksi shokëve të muzikës.

Gjithçka filloi thjesht. Vaçes i kujtohet se as rroba nuk kishin, por se nga i kishin gjetur ca veshje beflereshash, që i shkurtonin, i ndryshonin e dilnin me to në koncerте.

Ja edhe një ngjárje që i ka lënë mbresa të paharruara këngëtares. Kur ajo ende nuk i kishte mbushur të gjashtëmbëdhjetat erdhi në Lushnjë një grup regjistrimi i Radio Tiranës. Gjithsej-gjithséj, grupi kishte një manjetofon të vjetër, një mikrofon, shirita, e kështu për të parën herë këngët e Vaçes do të regjistroheshin për në Radio. Vaçja me këtë rast, për të parën herë dëgjoi vetëveten.

— Ishte diçka shumë emocionuese, — kujton sot këngëtarja, — doja të fluturoja nga gjëzimi.

Kështu rodhën vitet, shtëpia e pionierit, erdhën turnetë e para në qytetë e krahina të vendit tonë, konkurimet. Erdhi Vaçja edhe në Tiranë, në zemrën e gjithë Atdheut e, kështu, Festivali i parë në Radio, anketat muzikore, koncertet, dhe estrada, studimet në degën e dramës në

Institutin e Lartë të Arteve, turnetë jashtë shtetit... Nisën të shkruanin gazetat, Radioja e Televizioni, regjistrimet janë të shumta por, gjithnjë këngëtarja jonë mbetet e thjeshtë, e gëzueshme, bashkëbiseduese e vëmendshme, e ciltër dhe e dashur. Të gjitha këto ndihen edhe në këngët e saj.

E ku ta ndalim mendimin tonë? Te kënga «Ylli partizan», ku më aq patos i këndohet lufte sonë partizane, apo te «Këngët e popullit tim», ku të duket se është mbledhur një tufë lulesh të derdhura në tinguj të pavdekshëm. Po «Shoqet tona ileagle», po «Nënë moj do pres gërshetin»! Sa pranë e pranë rrinë lufta, liria, sakrificat dhe aq e fuqishme dashuria e nënave. Te kënga «Në çdo zemër mbjell gjësim» është aq i bukur e frymëzues portreti i rinisë sonë ndertuese e socializmit. E... «Ti në ballë, ne krah për krah» me Enver Hoxhën, me mësimet e tij radhët tona janë të pathyeshme.

Për cilën këngë të flasësh, çdo njëra një bukuri, një gjësim, një copë jete. Vëçja nuk është e pasionuar vetëm me muzikën tonë të lehtë. Po me atë patos, po me atë dashuri, ajo këndon edhe këngët e bukur popullore, bile me shumë vëmendje e kënaqësi i ka mbledhur e përpunuar me kompozitorë e pastaj i ka kënduar. Si mund të harrohen këngët «Doli ylli që me natë», apo «Motive myzeqare». Gjurmë të pashlyeshme të lenë këto këngë. Çfarë sinkronizimi: motive, mendim, zë e interpretim.

E gjithë tematika e këngëve të Vaçe Zelës, siç thotë ajo vetë, ështëjeta e bukur plot dritë që ka ardhur nga thellësitë e shekujve në lufta legjendare përliri e pavarësi, është jehona e betejave të trimërive më të mëdha të popullit tonë,

jehonia e Luftës Nacionalçirimitare, është vrulli e puna për ndërtimin e Shqipërisë Socialiste, është këngë për njeriun e ndryshimeve të papara në jetën tonë, e njeriut që di të punojë mirë, të gjëzojë, të hedhë valle e të dashurojë.

E do skena shqiptare Vaçen për atë gjerësi shpirtërore, jo vetëm në mënyrën e të kënduarit, të tonalitetit të mrekullueshëm për zérin aq të kulluar si burimi i maleve, të ngrohtë si shpirti i popullit, por e do edhe për atë forcë të lartë interpretuese e emocionuese. Kënga e kënduar nga Vaçe Zela është një poemë, është një copëz dramë, është një hymn dhe në të gjitha këto, në mënyrën krejt të natyrshme, i thjeshtë e i fuqishëm është edhe interpretimi i saj lirik e dramatik.

Vaçen e kanë parë dhe e kanë vlerësuar edhe skenat e shumë vendeve të botës. Ne jemi dëshmitarë të aq takimeve, të aq bisedave, të aq filmave dhe emisioneve televizive ku spektatorët të mbërthyer në sallë, në heshtje, kanë shpërthyer më pas në brohoritje të pandalshme për minuta të tëra. E tillë është Vaçja jonë.

Këto merita, punën e saj të palodhshme, dashurinë për këngën e artin i ka vlerësuar Partia, populli. Ai i dha Vaçes titullin e vet më të nderuar «Artiste e Popullit». Ka maja më të larta?!

E Vaçja kështu është, me titull e në jetë. Nënë e kujdeshme, e dashur dhe e respektuar, vazhdimisht jeton me jehonën e skenës, me spektatorët aq të mirë e që i japin aq frysëzim për të kënduar.

U bënë shumë vjet që u mësuam me zérin e melodinë e bukur të këngës sonë të kënduar me mjeshtëri nga artistja jonë Vaçe Zela. U

bënë shumë vjet, por n' duam ende edhe shumë tê tjerë ta dëgjojmë zërin e saj; këngën e bukur plot dritë, që na jep ne dëgjuesve kënaqësi e frysmezim.

Tiranë, qershor 1983

Qytetit që tani është ftohet me çdo moment, ndryshon gjithashtu vlerat e tij. Në këtë mënyrë, siç e përmesur, është më i lindur se sot. Qyteti që sot është i përgjithshëm, nuk do t'i është atij që jashtëzakonisht do ndryshoj. Më sot, qyteti është i përzakonisht i fortë, i ngrojtshëm, i ri, i rafiq, i kundrejtshëm, i ri, i lindur, i lir, i lir, i lir. Ma kemi një qytet që është i përgjithshëm, që është i rafiq, i ri, i lir. Ma kemi një qytet që është i fortë, i ngrojtshëm, i ri, i rafiq, i kundrejtshëm, i ri, i lir, i lir, i lir. Ma kemi një qytet që është i përgjithshëm, që është i rafiq, i ri, i lir. Ma kemi një qytet që është i fortë, i ngrojtshëm, i ri, i rafiq, i kundrejtshëm, i ri, i lir, i lir, i lir. Ma kemi një qytet që është i fortë, i ngrojtshëm, i ri, i rafiq, i kundrejtshëm, i ri, i lir, i lir, i lir. Ma kemi një qytet që është i fortë, i ngrojtshëm, i ri, i rafiq, i kundrejtshëm, i ri, i lir, i lir, i lir. Ma kemi një qytet që është i fortë, i ngrojtshëm, i ri, i rafiq, i kundrejtshëm, i ri, i lir, i lir, i lir.

Biografi e re në këngët e popullit

Secili prej këtyre djemive, që po shijnë në këtë reportazh, erdhë në shkollën e mesme artistike «Jordan Misja» Tiranë nga rrugë të ndryshme, nga zona e Krahina të Shqipërisë ku edhe kënga, edhe vallja këndohen e hidhen disi veçantë nga njëra-tjetra.

I sollën ata këto këngë, në tryezën e ndërlicëut, ashtu siç i kishin mësuar e siç i kishin dëgjuar dhe i këndonin me shokë në festa e gjëzime, më mbrëmjet e shkollës. Në këto melodi, më ritmin e fjalët, për kohë të tëra ishte gdhendur ajo mençuri e krijimtari popullore, ku edhe kanë marrë pastaj afë ngjyrën e veçantë të krahinës që ne i kemi quajtur: këngët shkodrane, këngët e Shqipërisë së Mesme, këngët e Korçës, ku t'i përmendim të gjitha, dëri te këngët labe, ku merr zjarr njëherësh edhe vargu edhe melodja, edhe napi.

Por, këta djem të talentuar sollën me vete.

edhe diçka të përbashkët; dashurinë për këngët e popullit, për melodinë e vallet, pa dyshim, pasionin e madh për instrumentet, që i shtyu edhe të studionin e të bëhen artistë të ardhshëm.

Po cilët janë ata?

Në mes tyre Nimeti. Ka vite që në familjen e tij shkodrane, nga brezi në brez, trashëgohet kënga e interpretimi i saj. Në këtë rrugë eci edhe Nimeti. Që kur ishte pionier, bashkë me shkolën, me librat e ndiqnin pas edhe këngët, edhe veglat muzikore. Kënga, melodia iu bënë pasion, dashuri e nuk ishte aspak e çuditshme që Nimitin e gjeje në kohën e lirë pas orkestrës, në koncerte e dasma, e pse jo, edhe duke ia marrë me të atin ashtu shtruar këngëve shkodrane.

Nëse nuk do ta njihnit Aleksandrin, e rasti do t'u binte ta ndiqnit pas kur ai do të fishkellente ashtu me vete, ndonjë melodi, do ta kuptonit përnjëherë se ai vjen nga fushat e gjera të Myzeqesë, nga rajoi, shtrirja e paanë e punës dhe e melodisë.

Sazani solli në mes shokëve të Liceut Artistik gjithëhato gjëzime, gjithë ato ndjenja të bëndshme të këngës qytetare elbasanase. E, kù ta ndalim mendimin? Tek Markoja, që me aq pasion di ta japë shpërthimin e harenë e këngës Tiranase. Këto këngë, së bashku me ato të Elbasanit, përbëjnë ato që ne i quajmë «këngët e Shqipërisë së Mesme». I themi kështu vetëm si gjeografi e «mesmë», sepse për koloritin e tyre, për shtrirjen e ndjenjave, pëlqehen e ndiqen me aq dashuri në jug e veri të Atdheut.

Këta nxënës, që erdhën në Liceun Artistik për mjeshtri, në instrumente të ndryshme, së bashku me disa shokë të tjera, aty nga viti 1976 krijuan grupin e interpretimit të këngës popullore në shkollë.

Në programet e shkollave tona të mesme artistike ka shpërndarje të drejtë të ngarkesës së dijenive, të njohjes, me profesionin, me veglat muzikore, me krijimtarinë. Por ka edhe diçka shumë të mirë: që të gjithë nxënësit pavarësisht nga profili apo instrumenti, duhet të njohin e të interpretojnë: këngën popullore. Kjo, natyrisht, ka qëllimin e kulturës së përgjithshme, por është menduar drejt, që për këtë të ketë edhe një detyrim shkollor, që nxënësit në mënyrë individuale e jasin para një komisionit.

Mbase ky «detyrim» shkollor ishte pikënisja e mendimit për të krijuar grupin e këngës popullore pranë Liceut. Nemeti, Aleksandri, e shokët e tjerë vendosën ta paraqesin disi ndryshe këtë provim para pedagogëve. Me iniciativën e tyre mësuan një tifë këngësh të njohura popullore të krahinave të ndryshme të Shqipërisë, punuan me orkestrimet, me harmonizimin e veglave dhe dolën grup para komisionit.

Kjo ishte diçka e bukur dhe e papritur. Nuk ishte fjala për vlerësimin, as të nota, por tek ajo ide e bukur, te vullneti, këmbëngulja e dashuria që treguan ata për këngët e popullit, te pasioni për të ruajtur e, për të ngritur më lart atë krijimtari muzikore që i ka rrënjet në shekujt e largët.

Kështu nisi rrugën ky grup i vogël artistik, që menjëherë gjeti përkrahjen e shkollës, e të shokëve, e në mënyrë të vëçantë të pedagogut Benjamin Kruta, aq i pasionuar për folklorin, për këngën e melodinë popullore.

Në Institutin e lartë të Arteve, ku pjesëtarët e këtij grapi vazhduan studimet e larta, mes shokësh e shtuan edhe më shumë kujdesin e punën për t'u perfektionuar jo vetëm në instrumente, por edhe për të kombinuar e harmonizuar sa

më mirë anën vokale, interpretimin dhe shoqërimin me orkestër.

Megjithëse kjo krijimtari dhe kjo punë nuk bënин pjesë në programin e shkollës, drejtori i Institutit të Lartë të Arteve, Lili Zhamo, që i ndiqte me vëmendje hapat e vullnetshme të djemme të rindj, në të gjitha rastet i inkurajonte e i përgëzonte me dashuri pjesëtarët e këtij grapi artistik, i cili shpejt filloi të bëhej i njohur kudo. Edhe sot ata kujtojnë se një ditë që drejtori sapo ishte kthyer nga shërbimi në disa rrethe të vendit, e mblodhi grupin dhe u solli këtë sihariq: kudo më folën për këngët tuaja, për interpretimin tuaj!

S'kishte gjë më të gjëzueshme!

Tani që ka kaluar njëfarë kohe, pjesëtarët e grupit kanë dëshirë të hedhin disa shënimë në «historikun» e kompleksit. Si vite mbasë nuk janë edhe shumë, por puna është e madhe e fryt-dhënëse.

Qershorin e vitit 1976, pjesëtarët e grupit e quajnë si kohën e përurimit. Ajo lidhet me diçka të bukur, me transmetimin për herë të parë në Televizion të një programi artistik. Ky koncert u përgatit me shumë emocione. Të gjithë kishin ngarkesë të veçantë. Deri natën vonë vazhdonin provat. Ku ishte skena para ekranit të yogël? Tani ata do t'i shikonte e gjithë Shqipëria.

Po cilat ishin këngët e para të grupit? Nga koha në kohë repertori i këtij grapi artistik është zgjeruar me dhjetra këngë të ndryshme, por përséri nuk harrohet ajo kënga e parë «M'i gjëzofsh pesëmbëdhjetë pranverat». Ishte këngë e njohur shkodrane, por për të u punua shumë: U bë orkestrimi i ri, u punua fare pak edhe teksti, u bë harmonizimi i vëglave e mbi të gjitha ana vokale. Atë do ta këndonin studentë,

këngëtarë nga krahina të ndryshme, ndaj ruajtja e tonaliteteve, e origjinalitetit dhe e veçorive të tjera, përbënин diçka jo edhe aq të lehtë. Pra duhej diçka e re, e këndshme, por pa e cënuar aspak muzikën, dhe melodinë aq të njojur të asaj kënge. Këngën «M'i gëzofsh pesëmbëdhjetë pranverat» e ndoqën pas kënga korçare, tingujt nga Myzeqeja, etj.

Shkalla e pjekurisë së interpretimit gjatë viteve të mësimit në Institut erdhí duke u rritur vazhdimi. Në repertorin që po zgjerohet u tregua kujdes i veçantë që të ruheshin të pastrat veçoritë e këngëve nga krahinat e ndryshme. Përtatë realizuar më mirë e përtatë njohur sa më afër këtë krijimtari e mençuri të popullit, në fushën e këngës, pjesëtarët e grupit u ngarkuan me de-tyra të veçanta që secili në kohën e lirë, e gjatë muajve të verës të vëzhgonte nga afér e të njihet sa më në thellësi me këngët e krahinës së vet, me mënyrën e të kënduarit, me grupet apo solistët që interpretonin këto këngë.

Të gjitha këto hulumtime e vëzhgime sillëshin pastaj në auditoret e Institutit. Përtatë diskutohet gjerë e gjatë e mbi bazën e tyre ndërtosheshin edhe prɔvat, edhe koncertet e ardhshme.

Në «biografinë» e këtij gruji desha të theksoj edhe diçka timën, vetjake, që, në fund të fundit, nuk lidhet vetëm me mua, por edhe me punën e redaksisë së krijimtarisë artistike në Televizion.

Kishim kohë që ndiqnim punën e jetën koncertale të këtyre djemve të talentuar dhë disa herë na kish ngacmuar dëshira përtë përgatitur një program të zgjedhur televiziv. E fillova me shumë kënaqësi punën për shkrimin e ndërtimin e skenarit: I takova disa herë e bisedova gjatë

pothuaj me se cilin prej anëtarëve të grupit. Gjithnjë, më mbushnin me frymëzim.

Cdo gjë eci si s'ka më mirë, por, siç ndodh nganjëherë në krijimtarinë artistike apo publicistike, në përfundim të tekstit mungonte titulli i shkrimit. Nuk po gjenim dot diçka të menduar. Si, ta quanim këtë grup artistik. Më kujtohet, jo vetëm redaksia, por edhe vetë pjesëtarët e grupit, disa ditë e kishin vrarë mendjen për të gjetur një emër që ti përshtatej grupit apo emisionit. Por, kur bën të mos vijë mendimi, më mirë mos nxirri fjalë pa vend, vetëm mendo e mendo sa të mundesh. Cfarë nuk dëgjuam nga shokët që ishin grumbulluar për të gjetur titullin; Dikush thoshte ta quajmë grupi i këngës popullore, një tjeter grupi i ri i këngës popullorë etj. Mirépo u ndalëm thjeshtë: «Na bashkoi kënga popullore».

Mesa u duk më vonë emri u gjet me sukses, në pak kohë u bë shumë i njobur.

Kështu në vitin 1978, me këtë titull «Ata i bashkoi kënga popullore», lindi ai koncert i bukur i ndërtuar në studion e programeve artistike të Televizionit e i organizuar me mjeshtri regjisoriale, që u ndoq disa herë nga telespektatorët, për të cilin na u thanë fjalë aq të mira.

Redaksisë më vonë i kanë ardhur shumë letra e propozime për xhirime të reja në natyrë, në vendë piktoreske e karakteristike, të banesave muze, të kështjellave etj. Mjaft nga këto xhirime janë realizuar me mjeshtëri artistike, duke bërë kështu një punë të madhe për të njobur e propaganduar këtë grup artistik, që ka lënë e polë gjurmë në fushën e interpretimit të këngës popullore.

E gjithë kjo është diçka e merituar, është shpërblim i mundit dhe i djersës së këtyre djem-

ve të talentuar, që vazhdimisht «ngacmohen» në punën e krijuese, përpiken e luftojnë për repertoarit e tyre, e kjo jo vetëm në orët e punës, por duke i kushtuar asaj edhe orët e lira.

Nuk janë të pakta rastet e bisedat, diskutimet e mendimet që jepen në takime të ndryshme për këngët, e reja, për përbajtjen e tyre, për anën muzikore e yokale, për mënyrën e interpretimit, e pjesëtarët e grupit, luftojnë me të gjitha forcat për t'i vënë në jetë. Mjaft shokë nga grupi, si Nemeti, për këngët shkodrane, apo këngëtari Agim Duro për këngët korçare, kanë ndjekur e ndjekin nga afër deri në nuancat më të hollë krijimet aq të bukurat, të njerëzve të thjeshtë artistë. Dhe kjo përbën një burim të pasur në fushën e ekzekutimit të këngëve. Ka edhe diçka të veçantë në këtë grup: pjesëtarët që i ndjekin me aq pasion këngët e interpretimet e të gjitha krahinave, po me atë pasion i kanë hyrë përvetësimit të veglave të ndryshme muzikore, që nga klarineta, fizarmonika, kitara e deri te giftelia, mandolina, sharkia etj. Çdonjéri prej tyre ka mësuar e përvetësuar dy deri në tri vegla të ndryshme, e kjo nuk është thjeshtë për kulturë, po në radhë të parë u jep shumë mundësi për të qenë sa më afër natyrës së këngës, sa më afër edhe instrumenteve popullore që përdoren në zona të ndryshme për të interpretuar këngët popullore sipas krahinave.

Të gjithë ne, që ndjekim, me aq vëmendje rritjen e kësaj trupe artistike, me kënaqësi të madhe hyjmë në botën e tyre interpretuese, të gjallë e plot kolorit, e me aq dashamirësi dëgjojmë potpuritë e këngëve korçare e shkodrane, myzeqare e të Shqipërisë së Mesme, pa harruar këtu këngët nga krahina e Kosovës dhe ato të arbëreshëve, përtejdetit.

Në vargëzimin e fjalëve dhe të notave të këtyre këngëve ka një ritëm të brendshëm që në çaste të veçanta të rrëmben me të gjitha ndjenjat, siç janë këngët e trimërisë: «Trimi devolli», «Kjo Kosova e ka adet», «Atje poshtë te mülliri», «Çohi djema shalonitatin», etj.

Por, në interpretimin e këtij grupi ka edhe melodi plot meditime e mendime që të mbushin me kënaqësi e optimizën. Le të kujtojmë për një çast muzikën e gëzueshme «Mu te guri që bën xixa», «Çu takuam në një rrugë të ngushtë», «Mora mandolinën», «Dardha me të bardha» etj.

Të gjitha këto këngë që janë krijime të njo-Hûra e të hëershme, në interpretimin e grupit «Na bashkoi kënga popullore», marrin ngjyra të reja, forcë e freski, që të shplodhin e të jasin një kënaqësi që të duket se e ke pritur.

E kjo kënaqësi i ka ndjekur e i ndjek shiktesit e shumtë nëpërmjet skenës dhe ekranit në të gjitha veprimtaritë e shumta, që nga shfaqjet në Teatrin e Operas e të Baletit e deri te Koncertet e Majit, turnetë e shumta etj.

Kjo që po tregojmë tani në shënimet tona, është një temë e veçantë, por shumë e ndëruar për grupin artistik «Na bashkoi kënga popullore». Kjo temë merr rrugënisje nga ato takimet e bukurë e të paharruara të këtij grapi me punëtorë, të rinj, me kooperativistë etj.

Në mjaft raste nis ajo fare thjeshtë: me një telegram apo letër: «Ju presim të na vini në gëzimet tona», apo «Ju presim në përvjetorin e üzинës, të qendrës së punës». Këto takime, që nuk kanë qëllim vëtëm shfaqjen, kthehen në një bashkëbisedim të këndshëm mes krijuesish e punëtorësh, mes artit e punës.

Deshëm të përmendim një nga këto takime,

që ka hyrë edhe në «biografinë» e grupit si diçka që kujtohet shpesh.

Ishte shkurti i 1984-ës. Orët e pakta të ditës mbushur me shi e netët e gjata plot dëborë. Grupin «Na bashkoi kënga popullore» e kishin ftuar në minierën e kromit në Batër-Martanesh Asnjë vështirësi, asnjë hezitim nuk bëri vend te gëzimi i guximi i pjesëtarëve të grupit. Mbas disa orë udhëtimi, mbas vështirësish e penge-sash të kohës së ftohtë e të rënduar me dëborë, ansambl i vogël arriti mes minatorëve, mes atyre: djemve të rinj e të fuqishëm që me durim matin forcat me shkëmbin, me nëntokën e he-kurat po që janë edhe aq të ndjeshëm e dashamirës, të këngës e të gëzimit, të muzikës popullore.

Me t'u takuar misen bisedat për punën e përkëngët. Minatorët i njihnin të gjithë pjesëtarët e grupit e i dinin pothuaj të gjitha këngët ndaj edhe koncerti, edhe shfaqja misen që aty në rrugë. Të zënë dorëpërdore si miq e shokë të vjetër, tërë kohën që ndenjën në Batër, pjesëtarët e grupit kënduan bashkë me minatorët në shfagje e pushime për trimëritë në luftërat tonë për liri për burnat, në zë të popullit tonë, për heroizmin e ditëve tonë që nis edhe të grykat e galerive e deri te piramidat e kufijve tanë të paprekshëm.

Edhe më pas lidhjet e minatorëve të Batërs-Martaneshit me pjesëtarët e grupit artistik vazhduan e vazhdojnë edhe sot. Pogvetëm me punëtorët e kësaj miniere janë këto lidhje? Mund të themi pazarët e pruar se qindra janë fshatrat, kooperativat, qytetet ku kanë shkuar e kanë qëndruar pjesëtarët e grupit artistik. Jo, vetëm kaq, por tanimë është bëre një traditë e bukur e më vlerë që grupi «Na bashkoi kënga popullore» merr pjesë e organizon shfaqje të përbashkëta,

kudo që shkon, nje amatorë e orkestrantë të ndryshëm.

Grupi vazhdimisht përtërihet, ai i ka dyert e hapura për të talentet që e ndjekin dhe e duan këngën e popullit. Tani bashkë me «veteranët», nëse mund t'i quajmë kështu në mënyrë figurative shokët e parë që kënduan e interpretuan në këtë grup që ngërfillimi, kanë ardhur edhe zëra e interpretues të rinj si Pirro Pano nga Korça, Fatmir Fani nga Shkodra, Filip Thano nga Durrësi, e me këngëtarët: Klotilda Daliu e Vasil Marko, të cilët kanë sjellë freski të re në këngët e në interpretimet.

Kuri ndjek me vëmendje programet e përgatitura me aq dashuri e mjeshtëri nga grupi «Na bashkoi kënga popullore», të vete mendja tek ajo punë e madhe e traditë atdhetare që kanë bërë tërë ato grupe në vendin tonë para çlirimit për të krijuar e për të ruajtur të pastër gurrën e pashtershme të këngës së njerëzve të thjeshtë, të këngës së vegjëlisë në të cilat me aq «pasion» i këndonin lufthës përliri, trimave të betejave kundër sundimit të huaj, i këndonin aq bukurjetës e dashurisë.

Deri në ditët e sotme nga librat, nga fotografitë, po edhe nga të moshuarit vijnë kujtimet për «Ahengun shkodran» që aq e zbulononte dhe e mbushte me optimizëm e frysëzim jetën e varfér të njerëzve të thjeshtë.

Kujtojmë këngët e bukurë e aq melodioze të spletqve të Korçës që me aq mjeshtëri i ruajnë dhei pasurojnë këngët e bukura të kësaj krahine, duke futur në të shpirtin e mençurinë e tyre. Po grupi i Isuf Myzyrit në Elbasan, sa afër i qëndronte jetës e sa tinguj i ktheuën në këngë për njerëzit e thjeshtë, për lumturinë që ata kërkonin, për dashurinë e pastër.

që kundër tij. Dhe që mes krah për krah
shkrimitarë e gazetarë, që kanë
nëntorë së shumtë, që kanë
nëntorë së shumtë, që kanë
nëntorë së shumtë, që kanë
nëntorë së shumtë, që kanë
nëntorë së shumtë, që kanë
Krah për krah
shkrimitarë e gazetarë

E përbashkët, në mes gazetarëve dhe shkrimitarëve, nuk është vetëm pena, por është ai front i madh e qëllim i lartë i Partisë për edukimin e kalitjen e njeriut të shoqërisë sonë socialiste. Në këtë vepër të madhe, që nuk matet as me kate, as me kilometra, gazetarët, shkrimitarët dhe artistët janë ushtarët e vijës së parë, ndaj shoku Enver me të drejtë i ka quajtur arkitektë të mendimit revolucionar të masave.

Letërsia dhe artet, shtypi dhe Radiotelevizioni kanë ecur gjithnjë për krah njëri-tjetrit. Gazetat e revistat në fushën e krijimtarisë janë si të thuash laboratorët e parë për letrarët e nismëtarët në rrugën e letërsisë dhe të arteve.

Nuk ka krijues të vargut apo të prozës, mëdje edhe nga ata më të njojurit (që tanimë kanë botuar romane e drama, kanë shkruar skenarë e novela), që të mos shfletojnë plot emocione faqet e «Letrarit të ri» apo të gazetës «Rinia»,

ku dikur janë botuar shkrimet e tyre të para e të mos i kujtojnë ato me nostalги e duke tundur' koken, për rrugën që kanë kaluar. Ató shkrime, të renditura diku, jo shumë për të rënë në sy, kanë lënë gjurmë të pashlyeshme, sepse përmes tyre është bërë ballafaqimi me lexuesin e, lexuesi me shumë mëncuri, e ka përkrahur e i ka thapur rrugën, atij që i ka hyrë në zemër. Kjo ngjet edhe me krijuesit e tjerë: interpretues, piktorë apo skulptorë, edhe ata ruajnë copëzat e gazetave apo të revistave, fotografitë e botuara për veprat e tyre si një visar i madh i jetës. Edhe për këtë arsy, është aq i fuqishëm roli i shtypit e i Radiotelevizionit, të cilët vazhdimisht duhet t'u bëjnë vend në faqet e në emisionet e tyre talenteve të reja, atyre që zgjedhin rrugën e letërsisë dhe të arteve. Shtypi e Radiotélévisioni me militantizmin, që i karakterizon, të shohin e të lexojnë, mes radhëve të këtyre shkrimeve të para, shkëndijat e shkrimitarëve e të krijuesve të ardhshëm. Ani pse në një poezi tri strofa janë të paarritura, mjafton një strofë, e ngandonjëherë edhe një vârg i fuqishëm, për të parë poetin e ardhshëm. Duhet vetëm ta trajtojmë me dashuri atë filiz që kërkon tokë të fritet.

Duke e parë edhe me këtë sy detyrën e madhe e të rendësishme të shtypit e të Radiotelevizionit, s'duhet të mërzitemi e s'duhet të lodhemi asnjëherë në përkrahjen e talenteve të reja, sepse, në kushtet që ka krijuar Partia, filiza të tillë, në fushat e ndryshme të krijimtarisë letra-re-artistike, lindin çdo ditë. Edhe tani, mjaft nga ata kanë përgatitur apo përgatitin dorëshkrimet e tyre të para për t'i dërguar në «Zërin e rinisë», apo edhe në «Drita» e «Nëntori», «Historia», përsëritet, por në një shkallë të re, me talente që vijnë nga një popull mië arsim e kulturë socialiste.

Këtë detyrë të madhe, shtypi e Radiotelevizioni e kryejnë në përgjithësi, mirë por duke u nisur nga kërkesat e kohës dhe nga fakti se sot kemi një shtyp shumë të zgjeruar, me më shumë dashamirësi e më me vëmendje duhen vlerësuar talentet e reja e t'u kushtojmë atyre më tepër vend në sofrën e madhe të krijimtarisë.

Veç kësaj shtypi e Radiotelevizioni, Agjencia Telegrafike Shqiptare, për shkrimtarët dhe artistët përbëjnë edhe një burim të pastershëm informacioni plot fakte e ngjarje nga jeta jonë e larmishme.

Nuk janë të pakta rastet, kur nga një lajm i thjeshtë, i botuar në gazetë apo nga një korrespondencë ose përshkrim, në dukje pa shumë rëndësi, për heroizmin e njerëzve të zakonshëm të ditëve tona, të janë frymëzuar e të kenë lindur tregime e novela, romane; e drama me shumë interes.

Duke u nisur nga kjo vlerë e madhe e shtypit dhe e Radiotelevizonit, në të ardhmen, neve na del detyrë që të rritim edhe më shumë cilësinë në fushën e krijimtarisë sonë publicistike.

Punë më të madhe mund të bëjnë shtypi e Radiotelevizioni edhe për propagandimin e letërsisë dhe të arteve, për njojen e lexuesve dhe të shikuesve të shumtë me vlerat e veprave letrare-artistike. Nuk mund të thuhet se me botimin e një artikulli, me transmetimin e një bisede apo emisioni është përm bushur gjithçka në detyrën tonë. Jo, letërsia dhe artet duan me cilësi e vazhdimisht mendimin e pjekur, analizën e gjerë, përkrahjen dhe anketën me plot mendime, nga lexuesit. Këtë, natyrisht, nuk mund ta realizojnë vetëm redaksitë e gazetarët, madje as nuk duhet vepruar kështu edhe sikur të ishte e mundur. Në këtë veprimitari të madhe duhen futur me frymë-

zimin e talentin e tyre bashkëpunëtorët e, në radhë të parë, shkrimtarët e artistët, sepse kësh- tu do të forcohet edhe më shumë bashkëpunimi në mes shtypit dhe krijuesve në fushën e artit e të letërsisë.

Në faqet e shtypit e në programet e Radio-televizionit është e nevojshme të gjejnë vend edhe më shumë botimet e transmetimet e mirë- fillta të krimtarisë letorraine artistike. Lexuesit e shikuesit janë aq dashamirës për skicën let- rare, për poezinë e poemën, për tregimin e nove- lën, e pse jo edhe për një roman të botuar me vazhdimësi në disa numra gazete. Por, ta pranomë me keqardhje, kjo fushë bashkëpunimi është lënë disi djerrë. Lind pyetja: ai janë stë- pur gazetat apo janë tërhequr shkrimtarët? Dikush mund të thotë e para, dikush e dyta. Unë mendoj se janë të dyja: Për të parën mbasë, është çështja për një shtyp të gjerë e të profilizuar, ku janë ndarë detyrat. Për të dytën më duket se llojeve të shkurtra të letërsisë, si skicës, fej- tonit, pamfletit, u bëhet një e padrejtë e madhe, sepse, shkrimtarët me sa duket nuk i parapëlqej- në e kështu janë lënë më në harresë.

Ekrani i vogël është bërë sot një tryezë e madhe për pasqyrimin e trajtimin e problemeve të letërsisë, dhe të arteve si edhe për paraqitjen para teleshikuesve, të shumë gjinive të krimtarisë letorraine artistike duke filluar nga përralla, aq edhe dashuri për të vëgjelitë me radhë teletregimi, estrada, filmi, drama, opera etj, etj.

Nuk gabojmë kur themi se sot letërsinë e artit i ndjek i gjithë populli. Një dramë, një film, madje edhe skeçet e estradave gjejnë diskutim të gjerë që nga vatrati familjare e deri në Lidhjen e Shkrimtarëve e të Artistëve. Dikur, po edhe sot, pjesën më të mirë teatrale mund

të frekuentojnë disa mijëra shikues, për filmin e zgjedhur, gjatë shumë seancave, mund të bëhen disa qindra mijëra shikues, kurse para ekranit të vogël brenda një nate, mund të ulen mbi një milion teleshikues. Që këtu vjen ajo përgjegjësia e madhe për emisionet që përgatitim e transmetojmë.

Televizioni nuk është vetëm një komunikues masiv, por është edhe shumë popullor. Ai nuk duron akademizëm e ftohtësi, të folur e interpretime nga «mali i lartë», por atrimi të natyrshëm me teleshikuesin, bashkëbisedim të përzemërt me të.

Për gjinitë letrare-artistike, madje edhe publicistike, Televizioni përbën sot një fushë të gjerrë veprimi. Dora e shkrimitarit, e aktorit dhe e interpretuesit të këngës apo të valles, duhet të ndjehet e fùqishme që nga emisioni i përrallës, ekranizimi i tregimeve e i novelave, fjala artistike, estrada e koncerti, deri te teatri e filmi televiziv. S'ka as më të voglin dyshim se shkrimitarët dhe artistët janë përfshirë me shumë forca në procesin e rritjes së cilësisë së emisioneve tonë, por, duke u nisur nga fakti se teleshikuesi ynë po bëhet gjithnjë e më i ndjeshëm e më kërkues, puna jonë krijuese është me vend të rritet edhe më shumë. Për këtë, shkrimitarët e artistët duhet t'i gjejmë më dendur në studiot, në xhirimet e televizonit. Shokët shkrimitarë apo krijues të tjerë, që janë në profesion të lirë, apo edhe ata që kanë dalë në pension, duhet të jenë më afér kolektivit të Televizonit e të ndihmojnë konkretisht me përvojën e tyre në realizimin e programeve dhe të emisioneve.

Ne, gazetarët, punonjësit e shtypit e të Radiotelevizonit, kemi edhe një kërkesë për shokët tanë shkrimitarë e artistë, ashtu si edhe për kri-

juesit e tjerë: të rritin edhe më shumë bashkë-punimin me ne, jo vetëm me firmën e shkrimitarit, por edhe të publicistit, të gazetarit. Të përtërihet edhe më shumë ajo traditë e bukur e rilindësve tanë, të cilët gjatë tërë jetës së tyre krijuese jo vetëm ishin bashkëpunëtorë të organeve të shtypit demokratik, por, edhe kur ishin bërë shkrimitarë të mirënjojur, ata vetë drejtonin e redaktonin organet e shtypit. E themi këtë, sepse ka ndonjë rast, kur disa firma, pasi marrin «pagëzimin» e anëtarit të Lidhjes, batojnë edhe ndonjë libër, nuk u bëhet mbarë e mbasë u duket si pa rëndësi të marrin penën e të shkruajnë një reportazh, një përshkrim, fejton apo artikull.

Në gjerësinë e shtypit të sotëm e sidomos tani me Televizionin, për shkrimitarët si publicistë, është hapur një front i madh pune. Mjafton të përmendim dhjetëra rubrika e cikle emisionesh, jo vetëm për letërsinë e artet, por edhe në fusha të tjera të krijimtarisë, që presin me kënaqësi fjalën e shkrimitarit e të krijuesit. Kjo jo për një intervistë apo bisedë, por për ta drejtuar me pjekuri e kërkesa të larta ideoartistike rubrikën apo disa cikle emisionesh.

Tiranë, prill 1984

Ato ditë prilli të paharruara.

Kishim dy ditë e dy netë që po jetónim me një ankth të rëndë në zemër. Lajmi i 9 prillit, përsëmundjen, pothuaj të pakapërcyeshme të shokut Enver, na shtangu. Si në çdo gjë të papritur njerëzit duhet të jenë në gatishmëri e të përgatitur. Po çfarë të përgatisje? Të fillonim nga emisionet! Nga muzika? Po kujt i besohej e kujt i bënte zemra për një gjë të tillë. Asgjë nuk ishte thënë ende e megjithatë, mbas lidhjes me shokët e Sektorit të Shypit në KQ të Partisë filluam të mendonim sesi do t'i përgjigjej Radio-televizioni gjithë atij hidhërimi, si do t'i përgjigjej asaj humbjeje që ishte si një tërmët i fuqishëm e që mund të ngjiste nga minuta në minutë.

Pas mesnatë... 11 prill 1985... ora dy e pësëmbëdhjetë... Edhe më pas, edhe për shumë kohë do na ushtojë në veshë ajo tingëllimë e kobshme e ziles së telefonit. Lajmi ishte i rëndë sa një mal, po koha nuk të lejonte të

mendoje tepër gjatë për këtë fatketqësi. Radiotelevizioni do të përgatitej për të dhënë i pari këtë njoftim zemërvrarë.

Ora po afroante pesë... Jemi në studion e transmetimit të Radio Tiranës, ballëpërballë mikrofonit. Si zakonisht do të fillonin lajmet, kalendari enciklopedik e pastaj muzika e gëzueshme popullore, me të cilën njérëzit tanë janë mësuar të shkojnë në punë. Pas një çasti, me gjysmë zëri kërkuan që me kujdes të ndërpriten lajmet e të fillojë transmetimi i një muzike simfonike.

Tekniket, që u ndodhën disi të habitura, nga ky ndryshim i papritur i programit, u shtangën dhe u befasuan.

— Çfarë ka ngjarë, — pyetën ato më një hidhërim që dukej se po u mbështillej fië grykë.

— Një lajm shumë i hidhur shoqe... Vdiq shoku Enver...

Lofë e heshtje. Në fytyrat e zbehta një dhembje e pafund. Sa pyetje mund të bëhen: Si? Kur? Jo! S'kishte përgjigje që ta lehtësonë këtë lajm të hidhur. S'kishte fjalë që të shëron te zemrën. Teknikët kalonin nga një studio në tjetrën pa ditur pse ecnin. Por... ja, sollën bobi-nën e muzikës. Duhet ndërprerë transmetimi pa u kuptuar. Folësi pranë mikrofonit s'po gjente dot një shkëputje nga teksti, filluan të merreshim vesh me shenja e gjeste. Gjithçka të dukej se bëhej si në mënyrë të pavullnetshme, por edhe gjithçka ishte shumë korrekte.

Nuk ishte fjalë se ne, që në orët e para të mëngjesit, do të jepnim atë njoftim të kobshëm. Komunikata e Komitetit Qendror të Partisë dhe e forumeve të tjera, bashkë me lajmet shoqëruese, do të transmetohësin në orën dymbëdhjetë të drekës, por sidoqoftë deri tek ajo orë e rënë, për atë hidhërim që s'e besonim ta mbante as

toka Radioja, nuk mund të ekte pa lënë gjurmë.

Po cida muzikë nga arkiva mund të mbante emocionet, hidhërimin ndjenjat. Në këto raste secili donte të shprehte, të kujtonte diçka nga gjithë ai kujdes i madh i Partisë dhe i shokut Enver për Radiotelevizionin, donte të çmallej, qoftë edhe të qëndronte në heshtje e të mendonte në vetëvete, sepse edhe për ne, si për gjithë popullin, kjo ishte një humbje e jashtëzakonshme. Por ne, punonjësit e Radiotelevizionit tërë ato orë, që na dukej se s'mbaronin kurrë, tërë ato ditë të pafund të asaj prove të rëndë, pothuajse u privuam edhe nga ky meditim, mbasi Radiotelevizioni duhej ngritur i téri në këmbë dhe duke përballuar dhembjen e pallogaritshme të fillonte punën më të madhe, më të vështirë e, më të tensionuar që kishte njojur ndonjëherë.

Takimet me redaksitë, sektorët, me kolektivat e drejtorive të ndryshme ishin nga çastet më prekëse e më të paharuarat. Por në mes tonë nuk mbeti vetëm hidhërimi, emocionet, ajo ndarje ashtu e pa besueshme, por te cilido punonjësi ynë, vërehej edhe forca për ta përballuar këtë fatkeqësi e mbi të gjitha vërehej ajo shkëndi e detyrës së madhe që i binte institucionit tonë, që nëpërmes programeve të pasqyronte me dinjitet figurën e madhe e të ndritur të Enver Hoxhës.

Dhe ajo duhej nisur nga arkivat: të fonos, të filmit dhe të elektronikës. Veçimi i materialevë ishte detyra e parë. Nga ana tekniqe kjo s'kishte vështirësi, sepse në bazë të skedave, çdo gjë ndodhej në vendin e caktuar, por vështirë ishte se çfarë do të zgjidhним nga gjithë ajo pasuri e madhe e regjistrimeve me zë e figurë, nga jeta dhe veprat e shokut Enver, për afro dyzet vjet më radhë. Këtu kërkohej aftësi e shkathtësi,

vlerësim politik e krijues, fantazi, largmi temash e formash.

Për vite me radhë, ne punonjësit e Radio-televizionit, kemi jetuar, caste gjëzimi të papërshkrueshëm, sa herë që njoftoheshim se në veprimtari të ndryshme do të merrte pjesë edhe shoku Enver. Kjo përfaktin se, nëpërmjet mikrofonit dhe sidomos nëpërmjet ekranit të vogël, do të kënaqnim kërkuesat e mbarë popullit, për tu takuar, kështu në mënyrë masive, me shokun Enver, për të ndjerë nga afër këshillat e çmuëshme të tij, për të përjetuar atë bashkëbisedim aq të këndshëm, ato caste historike të fjalimeve të reja e pse jo, nganjëherë edhe atë humorin e tij, të papërsëritshëm.

Kishte edhe diçka tjeter, të paharruar në këto veprimtari: ishin takimet e shokut Enver, nga afër, me punonjësit e shtypit e sidomos me operatorë, kameramanë, fotoreporterë etj. Një pjesë prej tyre i njihte me emër, i pyeste për punë, për emisionet.

Se sâ i madh ishte ndërimi e respekti i shokut Enver për punonjësit e shtypit e të Radio-televizionit flet edhe ky fakt:

Në vitin 1979 në Shkodër, me rastin e zhdukjes së pasojave të tërmetit, u organizua edhe një koncert. Kur shoku Enver hyri në salë, shpërthyen duartrokite të vazhdueshme. Në korridorin e rigushtë, nga do të kâlonte udhëheqja, u «vërsulën» mbi dhjetë operatorë, kameramanë, fotoreporterë, ndriçues etj., dhei u bë gati e pamundur për të kaluar. Dikush më të drejtë ndërhyn që të hapej rrugat e të uleshin ca dritat... Shoku Enver, me atë buzëqeshjen e tij karakteristike, aq të dashur, e që kishte aq hije tha:

— Mos i ngacmoni, ata kryejnë një detyrë të madhe, ata fiksojnë historinë.

Dhe ja tani në, puñonjësit e Radiotelevizionit, që i prisnim e i paraqitnim këto takime me aq fryshtësim e kujdës, u detyruam, ato ditë prilli të paharruara, jashtë dëshirës e vullnetit tonë, të paraqitnim ndarjen, por vetëm fizikisht, me njeriun më të shtrenjtë të zemrave tona, ndarjen më shokun Enver.

Vërtetë njerëzit janë të vdekshëm e ligjeve të natyrës nuk u shpëton njeri... Edhe shoku Enver njeri ishte, por kishte disa gjëra të veçanta që në na dukej së e bënин të pavdekshëm, ndaj ne, në mbledhjet tona, në drejtori, kolegjume e redaksi, menduam që edhe ato ditë zije të kobshme, shoku Enver të ishte i gjallë, mes njerëzish, me atë çiftërsinë e tij të zemrës, me atë optimizmin e besimin e tij në të ardhmen.

Për këtë, në kohë rekord, përcaktuam tematikën, zgjodhëm pjesët më interesante nga takimet, bisedat, riga fjalimet dhe nëpërmjet studiove të Radios e Televiszionit me anën e teksteve lidhëse, ndërtuam emisionet e para tematike.

Arkivat tona nuk kishin parë ndonjëherë lëvizje të tillë, por arkiv i gjallë ishin gjithë puñonjësit e Radiotelevizionit. Janë të paharruara ato takime pune me redaktorë, regjisore, kameramanë e sigurisht pa harruar arkivistët, të cilët me një përpikëri të rallë të thonin: në këtë datë shoku Enver ka patur takim me punëtorët, në këtë muaj është takuar me zgjedhësit, e kështu me radhë me pionierët, me forcat e armatosura, me rini të, me shkrimitarë e artistë etj. Ishin aq takime të shumta të dashurë e të bukurë, ndaj të gjitha mbaheshin mend deri në detajet më të vogla.

Në Radiotelevizioni, ato ditë prilli të paharruara, qindra vete ishin në këmbë njëherësh e të gjithë si më një komandë punonin në heshtje,

secili e dinte detyrën e, secili ishte si një hallkë e një pune që vazhdonte pandërprerje për 24 orë radhazi.

Dita e punes në Radiotélévizon, ashtu si në furrën e çelikut, nuk pushon asnijëherë, por ato ditë «u prishën» edhe radhët, edhe turnet. Njerëzit kishin lënë fare pakë kohë, për vete, sepse deri edhe në 16 orë radhazi i gjejë pranë aparaturës, mbi tryezën e montazhit, pranë telefonit, në ndërlidhje me studiot lëvizëse e, gjithçka bëhenj me një organizim të përsbësur. Asgjë,asnijë kërkesë, asnijë porosi nuk u përsërit përtë dytën herë e të gjitha u realizuan me përpikëri. Mos të harrojmë se ato ditë porositë e detyrat ndiqnin varg njëra-tjetrën.

Sot për sot, ekranë i televizionit në fushën e propagandës e të informacionit, është me efekt shumë të madh. Shoku Enver thoshte: «Televizori, si një dritare na sjell pranë vatrës, në familje, gjithë Shqipërinë.» Aq më tepër efekti i ekranit ndjehet kur ka ngjarje të tilla të pashlyeshme, siç ishte ndarja më udhëheqësin tonë të dashur që do të lejë gjurmë titanike në histori.

Në gjithë këtë punë të madhe nuk duhet të harrojmë edhe Radion. Ajo zë vend të vëçantë e të pa zëvëndësueshëm në propagandën e Partisë e, kjo jo vetëm përshtpjessinë e komunikimit, për orët e shumta të transmetimit, por edhe sepse ajo mund të të shqipterojë kudo. Me një aparat të vogël radioje me tranzistorë lidhesh me ngjarjet e jetën e vendit edhe në majë të malit, edhe në udhëtim e kudo.

Në propagandën e Radiotelevizionit ka edhe një sektor pune pak të njohur përdëgjuesit e shikuesit tanë, por shumë të njohur e me shumë respekt në botën e jashtme. Ky është transmetimi i Radio-Tiranës në gjuhët e huaja. Këtë

respektive nderim, në radhë të parë, ja ka dhënë Partia e shoku Enver. Është pikërisht më 11 prill 1985, në 20 gjuhë të ndryshme, në të gjitha kontinentet, nëpërmjet valëve tonas, u përhap lajmi i hidhur për vdekjen e shokut Enver Hoxha.

Ky ishte sinjali i vërvshimit të njoftimeve të të gjithë informacionit botëror, që mbështetur në Radio Tiranën dhe transmetimet e Agjencisë Telegrafike Shqiptare, njoftonin për këtë ngjarje të rëndë e të papritur.

Ato ditë erdhën në programacionin tonë të Radios së Jashtme, qindra e qindra letra, pjesa më e madhe e të cilave mbajnë datën 11 prill 1985. Ato janë mesazhe të vërteta revolucionare të miqve e të forcave përparimtare nga të katër anët e botës.

— Po ulemi të shkruajmë këtë letër sapo dëgjuam lajmin e hidhur nga emisioni juaj. Humbja e madhe dhe e rëndë nuk është vetëm e juaja, por edhe e jona, e gjithë popujve që luftojnë për liri e pavarësi. Enver Hoxha është nga ato figurat e shquara e njerëzit e rallë që u përkasin forcave revolucionare e përparimtare kudo e në çdo vend.

Enver Hoxha dhe shtypi botëror... Kjo është një temë më vete, e madhe që do trajtim të veçantë, por në le të kthehem te ditët e paharruara të atij prilli e sidomos mbas vendosjes së arkivolit me trupin e shokut Enver në sallën e Presidiumit të Kuvendit Popullor.

Vargu i njerëzve si lumi. Dhibmbja e madhe. Lotë në sy e në zemër. Kamerat duhet të fiksojnë të gjitha: edhe vajin, edhe heshtjen, por edhe forcën, edhe burrerinë, sepse vetë shoku Enver të tillë na kishte edukuar, sepse shoku Enver na la një Parti të fortë, një shtet të organizuar e atë fuqishëm e këtë duhet ta pasqyronim në men-

dimet, në fjalët e veprat e njerëzve, në shprehjet e tyre, që nga atamë të thjeshtët e deri te Sekretari i Parë i Komititetit Qendror të Partisë, shoku Ramiz Alia.

Kamera fikson pa pushim: rrininë tonë të fortë e të gjallë, po që sot nuk përbën lotët, plakun e thinjur me mustaqe, që qan si fëmija, gruan me grushtin lart në shenjë respekti e ndërimi të thellë për atë që solli emancipimin e saj, pionierët, që duke vështruar xhaxhi Enverin të shtrirë nuk u besonin syve. Të gjithë e të gjitha duhet të fiksohen në kamératona, por pa u tronditur, që të mos cënohet sadopak figura, pa çka se sytë e operatorit janë me lotë. Kjo është diçka e zemrës që nuk e prish rregullin e xhirimit.

Pesëmbëdhjetë prill 1985. Ora 10.00. Arkivoli lëviz ngadalë drejt Shëtitores së Dëshmorëve të Kombit, mbi supet e shokëve e bashkëpunëtorëve të luftës e të punës. Pranë janë pjesëtarë të familjes dhe të afërmit, miq'e shokë nga e gjithë Shqipëria. Kjo është dita më e rëndë e gjithë atyre ditëve të dhembshme.

Tani, ndofta më shumë se kurrë duhej treguar mobilizimi e aftësia, forca e karakterit e mendimi i punonjësve të Radiotelevizionit. Nëntëmbëdhjetë kamera në nëntëmbëdhjetë pika xhironi, ishin vendosur për këtë transmetim të drejtpërdrejtë e të jashtëzakonshëm.

Në studiot e Radios e të Televizionit kishin zënë vend folësit, komentatorët. Ata ndiqnin nëpërmjet monitorëve të gjitha veprimet e kamerave, të gjitha lëvizjet gjatë ceremonisë së përmortshme.

Në pultin e drejtimit të regjisë, në studion e lajmeve të Televizionit, yinin me radhë të gjitha burimet e figurës, që nga hyrja në Presidiumin e Kuvendit Popullor e deri te Varrezat e Dëshmorëve të Kombit.

Megjithë parashikimin e saktë të skemës së transmetimit, përsëri teknika edhe mund të bënte ndonjë «kapriçio». Deri në studiot e Radiotelevizionit vinin shumë kabllo, linja, ndërlidhjet me radio. Në pultet e transmetimit, në pikat ndërmjetëse e studiot lëvizëse të Radios e Televizionit ishin afro 200 krijues, inxhinierë e teknikë të ndryshëm që punonin për transmetimin.

Në ekranin e televizorit, në transmetim, do të nxirrej një nga pesë pamjet e ndryshme, që ndërrohen herë pas here nga kamerat e ndryshme. Edhe këtu përgjegjësia ishte e madhe. Dhjetëra sy vëzhgona pér të zgjedhur figurën finale.

Një personalitet i huaj, që mori pjesë në vrrimin e shokut Enver Hoxha e përcaktoi përcjelljen që i bëri Partia e populli: Të thjeshtë por madhështore.

Ka në këto fjalë një të vërtetë të madhe. Ne kemi parë në transmetimet e ndryshme televizive funerale, ku të ka mbirë në sy pompoziteti e solemniteti i shtitur e artificial, kamerat e ftohta.

Te ne gjithçka ndryshon. Populli e Partia përcillnin Enver Hoxhën në banesën e përjetshme, si birin më të shtrenjtë, njeriun më të dashur, babanë, vëllahë, mësuesin. Në Varrezat e Dëshmorëve të Kombit çonim pjesë nga zemra jonë. Ndaj kjo përcjellje ishte e thjeshtë e madhështore.

Në të dy anët e rrugës nga kalonte korteu, radhë të shtrënguara të njerëzve me sy të përlotur, qan pünëtori e kooperativisti, qan i riu e polici i shërbimit, qan studenti dhe oficeri i rojes së ndërit, qan nëna me flokët e thinjura e mbush sytë me lot vogëlushi që mban lule në duar pér xhaxhi Enverin.

Në mes të këtij lumi njerëzish ku kaloi arkiv-

voli, ani pse të përlotur, shprehej edhe një forcë titanike, një burreri e guxim. Ky është edhe uniteti i Partisë dhe i popullit, këtu është edhe ajo, madhështorja e asaj përcjelljeje.

Ishte zotësi e ndërgjegje, nivel i lartë ideore artistik, që punonjësit e Radiotelevizionit, duke filluar nga tekniku e manipulantit e deri te grupi i regjisë, dijti të transmetojë me aftësi, deri në detaje, gjithë atë forcë të madhe, gjithë atë respektatë madh.

Niveli profesional dhe puna e teknikës së Radiotelevizionit ato ditë të mbingarkuara, flet përmjështëtët e punë vëtmohuëse të kolektivit. Asnjë kamera, asnjë aparaturë, asnjë automjet, asgjë që ishte parashikuar përmes nuk u përdor, sepse çdo gjë eci në një mënyrë të përsosur.

Po, të gjitha ishin parashikuar, s'vëtëm përmjështëtëtët e punë vëtmohuëse të kolektivit. Jo defekt s'duhet të kishte kurssesi. Ne bille as tabelën: «Na falni përmjështëtët e punë vëtmohuëse të kolektivit apo «Rifillojmë së shpejti» nuk e kërkuam ta kishim aty pranë dhe, mirë bëmë, me tërë atë tendosje pune, me tërë atë përqendrim vëmendjeje s'kishte teknikë që të mos i bindej vullnetit tonë.

Gjithshka ato ditë ishte me hidhërimin e me dhembjen tonë. Edhe vetë natyra u vu përkrah punës së Televizionit e të filmimit. Dihet që koha më e shkëlqyeshme përmes xhirimeve të mëdha e masive është ajo: pak e vrenjtur, pa diell e kontraste të forta në figurë. Ashtu ishte koha. Edhe pak shi që ra u dha një madhështi të veçantë atyre pamjeve të papërsëritura. E ku ndjehej shiu kur kishte më shumë lotë.

Përmes afro katër orë transmetim të drejtpërdrejtë, përmes dhjetëra orë transmetim me televizi-

on e për qindra orë transmetim brenda e jashtë vendit me Radio për tetë ditë me radhë, nuk pati asnjë shqetësim, asnjë ndërprerje. Mobilizimi i qindra njerëzve në studio e stacione ishte në nivelin më të lartë. Kjo flet për një dashuri të madhe që kanë krijuesit, teknikët e realizuesit tanë për Partinë, për shokun Enver, që e deshi dhe e vlerësoi aq shumë Radiotelevizionin, që me fjalën e tij na jepte krahë, na frymëzonë e na mobilizonte për të realizuar e për të ngritur gjithnjë e më lart cilësinë e programeve dhe të emisioneve.

Edhe në të ardhmen, kjo qendër e rëndësishme e propagandës së Partisë dhe e edukimit komunist të mašave do të jetë kurdoherë në vijen e parë të punës së Partisë, për t'i shërbyer kurdoherë me devotshmëri lirisë, pavarësisë e ndërtimit socialist të vendit tonë.

Tiranë, prill 1985

Kur ndjekim emisionin «Ngjarje e data» . . .

Ekrani i vogël i televizionit ka hyrë me mjaft interes në jetën e përditshme. Ai është bërë, në mjeshter tona shqërore e familjare, një bashkë-bisedues që ka tërhequr e po tërheq gjithnjë e më shumë vëmendjen e telespektatorëve të moshave të ndryshme. Nëpërmjet këtij ekrani të vogël Partia çdo ditë bisedon me qindra mijëra telespektatorë. Së bashku me shtypin e Radion, Televizioni për vëtë specifikën e tij, forcën e madhe ndikuese nëpërmjet figurës e ilustrimit, po bën një punë frytdhënëse propaganduesë në fushën e edukimit e të informimit, si edhe në trajtimin e gjerë të problemeve të rëndësishme politike, ekonomike, shqërore, kulturore e artistike.

Propaganda televizive ka specifikë të veçantë. Duke hyrë figura, si element qendror për të ilustruar faktet, ngjarjet e në mënyrë të veçantë mendimin e gazetarit, krijojen mündësi të më-

dha shprehëse që ndikojnë pastaj me shumë emociion te telespektatorët.

Duke vlerësuar forcën e propagandës së Televizionit dhe punën e dobishme që ai bën, shoku Enver Hoxha duke përfunduar vizitën e tij në rrethet e Gjirokastrës e të Sarandës në mars 1978 tha: «Njerëzit tanë të shtypit, të Televizionit, të kinemasë, punojnë me frymë realiste, me frymë socialiste dhe me një art të madh. Televizioni është bërë i dashur në vendin tonë. Ai është një ushqim i domosdoshëm për të gjithë punonjësit. Çdo mbrëmje i madh e i vogël qëndron para ekranit dhe shikon bukuritë e gjithë Shqipërisë. Ka një ngjarje në Konispol dhe në mbrëmje atë e shikojnë edhe në Majën e Hekurave në Veri.»¹

Puna e Partisë, ndjenja e përgjegjësisë e komunistëve dhe e gjithë kolektivit të Radiotelevizioni e ka rritur shumë përpjekjen për të realizuar emisione me cilësi të lartë. Për këtë po luftohet që programet tona të janë sa më afër problemeve e interesave të telespektatorëve e radiodëgjuesve, të janë sa më komunikuese e të larmishme, mendimi e ilustrimi të janë në unitet e të plotësojnë njëri-tjetrin.

Në Televizion, si në të gjithë shtypin tonë, partishmëria, objektiviteti, vërtetësia dhe militantizmi përbëjnë boshtin themelor të shkrimeve e mendimeve tona. Veçanërisht, kjo bëhet e dukshme kur në ndihmë të mendimit vjen figura. Militantizmi i gazetarit, i operatorit dhe i regjisorit, në Televizion shihet në radhë të parë në aftësitë e tij politike, ideologjike e profesionale, në paraqitjen me vërtetësi, realizëm e të sinkro-

1) Shih: «Partia e popullit thesaret më të mëdha», Tiranë, 1978, f. 143.

nizuar me kohën dhe ambjentin, të realitetit të ngjarjeve.

Kërkesa të mëdha e të veçanta në studimin e grumbullimin e fakteve, në vëzhgimin e gjetjen e dokumenteve e dëshmitarëve, në paraqitjen reale e njëkohësisht, futja e botës shpirtërore të vetë gazetarit, operatorit e regjisorit paragesin emisionet «Ngjarje e data». Gazetarët e redaktorët tanë duke vlerësuar përgjegjësinë e madhe për këto emisione, e duke punuar me ngulm e frymëzim, nga koha në kohë, kanë rritur shumë nivelin e punës së tyre duke dhënë emisione me shumë vlerë kushtuar ngjarjeve historike, figurave të shquara, heroizmit të popullit tona në shekuj etj. Nga letrat, takimet e bisëdat e ndryshme mësojmë se emisionet historike televizive, për ato kohë kur gjëmonte maleve pushka përliri e pavarësi, për ato figura të pavdekshme që me pushkë e penë mbrojtën deri në pikën e fundit të gjakut tokën e shtrenjtë, për ato beteja legjendare partizane që i söllën Atdheut lirinë e çlirimin, ndiqen më interesim të madh nga telespektatorët. Mund të përmendim këtu emisionet kushtuar luftërave tona legjendare, heroizmit masiv të popullit, figurave historike, si Isa Boletini, Abdyl Frashëri, Hasan Tahsini, Naim Frashëri, Mic Sokoli, Vellezërit Topulli, Hasan Prishtina, Sulejman Vokshi; emisionet kushtuar heroizmit partizan, héroajve të popullit Qemal Stafa, Vojo Kushi, Asim Vokshi, Baba Faja, Tom Kola e shumë e shumë të tjera.

Shoku Enver, duke ndjekur emisionin kushtuar Dëdë Gjo Lulin, ka thënë: «Të tërë pamë në televizor një emision të posaçëm për Dëdë Gjo Lulin. Në ekran na u parëqitën pleq patriotë, bashkëluftëtarë të këtij heroi, të cilët shprehën kujtimet e tyre interesante për të. Kjo është his-

toria e gjallë e luftërave të mëdha të malësorëve tanë për liri e pavarësi. Unë u kënaqa kur i pashtë e i dëgjova të flitnin aq shtruar këta pleq patriotë.»

Forca e këtyre emisioneve qëndron në vërtetësinë historike, në shikimin e ngjarjeve me realizëm e duke u mbështetur kurdoherë në parimet e marksizëm-leninizmit. Faktet historike zgjidhen e seleksionohen me kujdes. Kurdoherë nxirren në pah ato që kanë të bëjnë me vetë realitetin e zhvillimit të ngjarjeve. Por ato që bëjnë historinë të flasë, që i bëjnë këto emisione të gjalla, emocionuese e që të rrëmbenjanë, janë dëshmitë gojore, bisedat e tregimet e njerëzve të moshuar, atdhatarë, që kanë marrë pjesë në këto ngjarje, ose që i trashëgojnë këto fakte e tregime gojë më gojë nga prindërit e gjyshërit. Vështirë se mund ta zëvendësojë ndonjë përshkrim historik ose letrar bisedën aq të fuqishme të gjyshes mbi 100-vjeçare Halë Qarri nga Hasi i Kukësit, që tregon aq bukur e me aq vërtetësi për luftën, jetën dhe thjeshtësinë e Plakut të maleve, Bajram Curri.

— Ai erdhi ja, këtu, — thotë ajo, — në këtë vatër, në këtë sofër hëngri bukë. Bisedoi me shokët, bëri planin e ditës së nesërme se ku do të mblidheshin e ku do t'u zinin pritë armiqvë. Pastaj u kthyesh e pyeti përfëmijët, përhallet e dertet e njerëzve të shtëpisë, të popullit.

Të gjithë e njohim heroizmin e djaloshit Vasil Lagi, që ngriti dorën e tij të njomë por të vendosur kundër tiranisë e shtypjes, kundër perandorit pushtues. Por a ka tregim më të fortë se fjalët e nënës së tij, Viktorisë, në një emision televiziv kushtuar të birit, kur flet për emocionet e Vasilit, përvendosmërinë e tij, përdashurinë e tij ndaj Atdheut e popullit?

Duke u nisur nga vlerat e mëdha që kanë këto biseda, këto dëshmi gojore të këtyre atdhetarëve të moshuar, para nesh del detyra që ato të regjistrohen, pavarësisht nga emisionet e të arkivohen, për t'u përdorur pastaj në rubrikat e ngjarjeve historike.

Përgatitja e emisioneve kushtuar ngjarjeve historike është mbështetur kurdohërë në parimet e marksizëm-leninizmit e në mësimet e Partisë sonë mbi rolin e masave dhe të héroit, të individualitetit, në ngjarjet e mëdha, që kanë lënë gjurmë në jetën e popullit e të Atdheut.

Në emisionet tona syri i telespektatorit ballafaqohet me forcën e madhe të masave që kanë krijuar e krijojnë historinë. Këto programe duke i qëndruar besnikë realitetit, duke përshkruar me objektivitet ngjarjet, e duke u mbështetur fuqimisht në dokumentacionet me vlerë, marrin jetë, dëshmojnë, në mënyrë të padiskutueshme përkarakterin popullor të përpjekjeve për liri e të mobilizimit të masave, të vigjilencës e të pjekurisë së tyre. Janë pikërisht këto fenomene historike, këto veçori që kanë ixjerrë në ballë të levizjeve të mëdha popullore heroin, trimat legjendarë, bijtë e thjeshtë të popullit të dalë nga masat për t'i udhëhequr ato. Një plak atdhetar, veterani maleve dhe i betejave, «ushtar i Bajram Currit», siç shprehej me krenari, në një bisedë tha:

— A e di ku e kishte forcën Baca? Në popull, te njerëzit e thjeshtë e të varfér.

Ne të gjithë e dimë se ai e atdhetarët e shquar, si Abdyl Frashëri, Hasan Prishtina e gjithë tjetër, kishin përbuzur me urrejtje tituj e grada, prentime e lajka, rryshfete e pazarllëqe që donin të bënин armiqëtë e tradhtarët në kurriz të tokës së shtrenjtë. Ata preferonin më mirë të

hanin atë pak bukë e kripë shtruar mbi gjunjë dhe të lirë e me popullin, sesa të shitnin interesat e Atdheut. Sa kuptimplotë janë, e sa forcë përgjithësuesë kanë këto fjalë! «Kapedanët trima që e deshën Shqipërinë e dhanë jetën me armë në dorë nuk jetuan në pallate luksoze e nuk u mbyllën në kështjellat e mbrojtura me mure mesjetare, por, njësh me popullin, luftuan në një front, jetuan nën një strehë, ndanë bashkë hidhërimet e gëzimet e fitoreve. Lidhja e madhe e masës me heronjtë lulëzoi si kurrë ndonjëherë në kushte të reja, me koncepte të reja, gjatë Luftës Antifashiste Nacionallirimitare. Trimat partizanë, heronjtë e lirisë, që me shembullin e tyre janë përjetësuar, dolën nga rrreshtat partizane, nga kasollet e varfra dhe u ngritën në piedestalin e kohëve».

Është përgjegjësi e aftësi e skenaristëve tanë, redaktorëve, gazetarëve dhe e krijuesve të tjerë që faktet e ngjarjet të paraqiten me vërtetësi historike. Për këtë jo vetëm duhet njohur mirë historia, por duhen bërë edhe ballafaqime të fakteve, sidomos, kur është fjala për pozicione apo nuanca të panjohurë lidhur me trajtimin e temave.

Skenaristi e gazetari militant, në bashkëpunim të ngushtë me specialistët e historisë, jo vetëm u japid jetë emisioneve, nëpërmjet ilustrimit e dëshmive të ndryshme, por me frymëzim, me realizëm e objektivitet fusin në këto emisione, për ngjarje e data, edhe botën e individualitetin e tyre duke krijuar edhe stilin vetjak të të shkruarit e të paraqiturit.

Tema e historisë ka tërhequr e tërheq shumë edhe telespektatorët e vegjël. Emisionet e fëmijëve që përbëjnë sot një televizioni akoma të vogël për nga numri i programeve, por jo për nga

puna e madhe në fushën e edukimit, pasqyrojnë me interes të kaluarën historike, luftën e populilit tonë për lirinë pavarësi, duke mos harruar asnjëherë edhe punën e madhe të vetë fëmijëve dhe pionierëve si luftëtarë të vërtetë edhe në fushën e betejës.

Këto emisione trajtohen e konceptohen në botën e psikologjinë e fëmijëve, ilustrohen e plotësohen me vepra letrare artistikë, këngë popullore etj. Mbetet detyrë për këto programe që janë edhe më të vështira për t'u realizuar, ngritja cilësore e organizimi më i gjallë e realist i komunikimit me telespektatorët e vegjël. Veç kësaj më gjerë mund të përdoren improvizimet e dramatizimet e ngjarjeve, gjë që kërkon pjesëmarrjen në këto emisione të grupeve artistike e teatrale.

Duke u nisur nga fakti se filmimi i dokumentacioneve, i faksimileve të ndryshme, i objekteve reale, i vëndeve historike, regjistrimi i bisedave, tregimeve dhe episodeve nga pleqtë merr një rëndësi, të veçantë, Radiotelevizioni, Kinostudioja, muzeumet, bibliotekat etj., po bëjnë një punë më të kujdeshshme për grumbullimin, seleksionimin e sistemimin e këtyre mëterialeve. Por kjo nuk do të ishte e plotë po të mos shtonim këtu edhe gatishmérinë e njerëzve tanë atdhetarë për t'u dhënë këtyre institucioneve për filmim e, pse jo? edhe për ruajtje të përhershme, në muzeume a arkiva, shumë objekte, dokumente që i trashëgojnë ose i ruajnë kujtim nga brezat, nga njerëzit e tyre të afërt. Mbetet si detyrë për ne dhe për organizatat e masave, që ky fond i madh, ky burim i pashtershëm, kjo pasuri e çmu-eshme, të zbulohet e të vihet më mirë në shërbim të historisë e të edukimit atdhetar e revolucionar të punonjësve.

Një vend të veçantë në këtë punë përgatitore për emisionet, ose edhe për materialet e arkivit të filmit, duhet të zenë ngjarjet e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare. Brezat e atyre që jetuan këto faqe heroizmi e lavdie të pavdekshme janë akoma midis nesh, por jeta bën të sajën dhe nesër tregimet e bisedat e tyre, faktet e materialet e regjistruara që bëjnë historinë, do të mbeten si një trashëgim i pavdekshëm për brezat e ardhshëm.

Meritë për realizimin e mirë të programeve për ngjarje e data, për heroizmin e paydekshëm të popullit tonë, i takon edhe bashkëpunimit shumë të frytshëm të Radiotelevizionit me Institutin e Studimeve Marksiste-Leniniste, me Akademinë e Shkencave, me Universitetin e Tiranës e me institucione të tjera. Praktika ka vërtetuar se në rastet kur është bërë punë e studiuar dhe e kualifikuar, janë përgatitur cikle programesh, siç janë ai për historinë e Partisë, me 16 emisione, ai për Lidhjen Shqiptare të Prizrenit me 5 emisione, cikli për 35-vjetorin e themelimit të Ushtrisë sonë Popullore etj., që janë pritur mirë nga telespektatorët.

E gjithë kjo punë, e realizuar dhe e përjetësuar në programet e Televizionit, bën që para telespektatorëve të ndihet pranë e gjallë, të shihet e të flasë historia, e kaluara e largët e heroike. Duke ndjerë krenari të ligjshme për ngjarjet, për qëndresën burrërore të masave e heronjve, të çdo njeri i lidhur ngushtë me Partinë edukohen vetitë e larta të qëndrueshmërisë, trimërisë, dashuria për Atdheun e për socializmin.

Tiranë, korrik 1978

Tre çaste nga një jetë e madhe

1. Datëlindja, festë e të gjithëve

Për disa vité më radhë, duke punuar në aparatin e Komitetit Qendror të Partisë, rasti më kishte sjellë të isha në takime, biseda e mbledhje të ndryshme më shokun Enver Hoxha. Të gjitha këto vepratari, të çfarëdo natyre që të ishin, krijonin mbresa e kujtime të paharruara. Çdo njeriu, që i ka takuar të bisedojë me shokun Enver, e ata janë të shumtë, ka marrë më vete përfytyrime të pashlyeshme, që do t'i ruajë në kujtesë, në mendje e në zemër si një thesar të çmueshëm.

Të gjithë punonjësve të aparatit na kujtohen bisedat e porositë, takimet aq të ngrohta; por në mënyrë të veçantë mbeten festat, gjëzimet, datëlindja e shokut Enver, që ishte aq e gjuar dhe e bukur.

Më kujtohet, ka qenë tetori i vitit 1968. Partia

e gjithë populli krejtonte 60-vjetorin e lindjes së udhëheqësit tonë të dashur. Një festë, një datë në kalendar, që n'a dukej se me kohë ishte bërë si festa e të gjithëve.

Meqenëse ishte përvjetor i plotë, takimet me shokët, miqtë, me popullin, do të bëhen në salat e aparatit të Komitetit Qendror të Partisë.

Ne, shokët e sektorit të shtypit, gazetarë, fotoreporterë të organeve të ndryshme, kineastë etj., prisnim në korridorin e gjerë me heshtje kurioziteti e emocione të mëdha.

Aty nga ora 10.00, përballë nesh erdhi shoku Enver, gjithë buzagaz, hoqi kapelen, rregulloi flokët e pastaj na dha dorën të gjithëve me radhë.

Ne, me shumë përzemërsi e uruam për datë-lindjen dhe, ai të gjithëve iu përgjigjej «Të rrojë Partia, të rrojë populli!» E, si për të thyer disi ndrojtjen tonë na pyeti për punën, për shokët, për shtëpinë. Pastaj vazhdoi duke qeshur: «Me që sot kemi shumë punë e s'do kemi kohë më të takohemi, bëjmë së bashku një fotografi».

Ne aq deshëm, secili vrapoi që të ishte sa më pranë shokut Enver. U grumbulluam të gjithë e u krijuat pa dashur një situatë humor, sepse s'kishte asnjeri përballë nesh që të na fotografonte. Si dukej, në ato çaste asnjeri nga fotoreporterët s'dëshiron të ishte në rolin e fotografit. Kjo punë u zgjidh vetëm pasi u siguruam se dy-tre shokë edhe do të na fotografonin, edhe do të fotografoheshin.

Pastaj shoku Enver, i qeshur, na tha se jam i gëzuar që takimet e kësaj dite i fillova me ju gazetarët, dhe së toku do të presim gjithë miqtë e shokët. Ju gazetarët e kineastët, gjendeni qdo herë atje kuka shumë punë, se jeni të palodhshëm, ndaj shkrimet tuaja i do dhe i ndjek lexuesi. Edhe unë i këndoj me ëndje ato që shkruani

në gazeta dhe qfarë paraqisni në dokumentarë e filma.

Akoma pa këmbyer miřë këto mendime, në koridor ù dukën grupet e njerëzve. Kështu filloj ajo ditë feste e gëzimi, bile do të thoja edhe ditë pune shumë e frytshme. Dhe ja sepse.

Nuk numëroheshin e nuk kishte të sosur vargu i njerëzve që erdhën për urim. Vinin të gjëzuar e largoheshin të lumtur. Shoku Enver, si në, orët e para e deri në orët e vona të ditës, priste e përcillte, pyeste e kuwendonte, informohet e mësonte shumë për jetën e njefëzve, jepte këshilla e porosi të vlefshmi.

Ne, tërë kohën, mbanim shënimë. Grupeve nuk u takonte të rrinin shumë kohë, por edhe në ato pak minuta shoku Enver gjente rrugën e mënyrën që të thoshte shumë. Qdo porosi apo këmbim mendimesh përbënte më vonë një program pune e krijimtarie.

Me vëgorinë e rrallë të bashkëbiseduesit, shoku Enver ngjallte te punëtorët vrullin, nxiste sedrën revolucionare e u shtonte dashurinë për punën. Me kooperativistët, në fillim fjalosej, për bukuritë e natyrës, pastaj kthehej të tufa e dheneve, të lopët e racës, e deri te dashuria e madhe për tokën, për Atdheun dhë, të gjitha bisedat kishin një linjë, kishin një cak, një objektiv të menduar. Aty, në ato takime e biseda lindnin projekte dhe ide, ngacmohej imagjinata e projektuesve, e ndërtuesve, e novatorëve dhe e racionizatorëve.

— Pa shik, — thoshte shoku Enver, — kjo uzinë mund të zgjerohet e me pak shpenzime mund të rrissim shumë prodhimin. Këneta në afërsi të Durrësit jo vetëm duhet të thahet, por të shkripëzohen edhe tokat e saj e të merren më vonë prodhime të larta bujqësore.

Vinin në këto takime e biseda, për të uruar

shokun Enver edhe shumë shkrimtarë, aktorë, regjisore. Një pjesë të mirë shoku Enver i njihet me emër, njihet veprat e realizimet e tyre. Me krijuesit shoku Enver hynte deri në hollësi të planeve të punës e të krijimtarisë, e bashkëbisedimi merrte krahë, frymëzim, zgjohej, hapej perspektiva.

Ishin gjithë ato fakte jetësore e copëza bise-de, që dëgjuam atë ditë e që më vonë morën rrugë e gjetën realizimin e tyre në veprat e shumta të artit, të letërsisë, të kinematografisë sonë.

— Kjo temë, — sugjeronte shoku Enver, — ka interes për filma artistikë (e, në vitet e më-pastajme filmi është realizuar). Për këta trima e luftëtarë të lirisë mund të shkruhej një roman... e, romani është shkruar. — Klasën punëtore, — theksonte shoku Enver, — duhet ta kemi në mendje, në zemër e në krijimtari, — e, më pas kanë lindur tabllotë aq të bukura në pikture me minatorët në grykën e galerive, në lartësitë e furrnaltës, në qytetet e hijeshuara etj.

Ndonjëherë, shoku Enver, kthehej nga ne duke mos e ndërpërre bisedën me miqtë, e thoshte:

— I shikoni këta gazetarë, ata i morën në kalem këto që biseduam dhe do t'ua thonë edhe lexuesve.

Kush ishte si ne! Gjithato gjëzime na dha ajo ditë e paharruar.

2. Në Butrint për Televisionin

Gjatë vizitave në Gjirokastër e Sarandë, në vitin 1978, shoku Enver u ndal me kënaqësi të

veçantë në Ksamil e në Butrint. Në Ksamil, mbajti një fjalim, apo më mirë të themi, një bisedë të lirë, të thjeshtë, ashtu pranë njëri-tjetrit, plot mendime e, pse jo edhe plot humor. Aty shoku Enver u interesua për punëtorët e rinj, të ardhur nga shumë krahina të vendit, për kushtet e jetesës, për kohën e lirë, madje edhe për familjen, për fëmijët, që janë lulet më të bukura të jetës, e, kështu u ndal në transformimet e mëdha të kësaj zone e krejt bregdetit. Gjithçka ishte e bukur e interesante.

Me të mbaruar takimi, grupei i Televizionit u nis më helikopter për në Tiranë. Koha ishte e pakët, rruga e largët e, shito pastaj se ë gjithë puna bëhej me film. Në atë kohë akoma nuk kishim njete elektronike për informacionin.

Por ishte një gjëzim i madh për ne, sepse sa po u kthyen shokët nga Saranda, në studiot to-na erdhi edhe shoku Ramiz Alia, bashkë me disa shokë të aparatit të Komitetit Qendror. Biseduam me shumë përzemërsi për informacionet e reportazhet e atyre ditëve në Radiotelevizion. Ishte një bisedë pune e ngrohtë për profesionin, për filmimet, për montazhin e, më pa, ashtu pa e kuptuar shoku Ramiz hyri bashkë me ne, në të gjitha punët e përgatitjes së emisionit.

Dëshira për ta transmetuar në revistën televizive edhe bisedën në Ksamil, mobilizoi të gjithë punonjësit e Televizionit, sektorët, transmetimin, ku edhe aparatura, në atë periudhë e sidomos telekinemaja nuk ishte aq e sigurt.

Deri, në atë kohë gjithçka kishte vajtur shumë mirë, ndaj edhe takimi në Ksamil duhej të përgatitej më sukses. Vërtet ashtu ngjau, me gjithëqë pikamë e vështirë mbeti telekinemaja, sepse ishte jashtë çdo mundësie përgatitja e kop-

jes së pastër me film pa ngjitje për transmetim. Pranë aparaturës ishin grumbulluar inxhinierë, teknikë, montazhierë. Çështja ishte të mos na këpütej filmi, apo të mos na iëshonin ngjitjet, aq më tepër që i dhamë fjalën shokut Ramiz se çdo gjë do të shkojë në rregull. Jo, vonesa për të ngjitur filmin nuk do të ishte e gjatë, por sidoqoftë, nuk donim të nxirrnim në transmetim tabelën «defekt teknik» apo «rifillojmë së shpejti».

Çdo dridhje e telekinemasë na kalonte në dridhje të trupit tonë e, kjo nuk ishte e paktë por plot 45 minuta. Gjithçka doli me faqe të bardhë. Më kujtohet si uronin shokët njeri-tjetrin.

Mbas revistës televizive, po bisedonim me një grup shokësh për vështirësitë, për nxitim, që na ishte bërë natyrë e punës sonë. Njeri nga shokët tanë tha: është vërtet punë e bukur, kjo e jona, por njerëzve kushedi si u duket. Já, thonë nganjëherë: vinë ata të Televizionit, filmojnë e pastaj i nxjerrin në ekran. Nuk i njohin sa duhet telashet që kemi.

Një përkim i çuditshëm. Mbas shoku Enver vizitoi Butrintin, foli me historianë e arkeologë për zbulimet në Butrint, për vlerësimin e gjetjeve në këtë trevë, për shkencëtarët e shumtë që janë marrë me Butrintin. U ndal në mjaft detyra për kërkuesit tanë, për shkencën e arkeologjinë, për lidhjet e këtyre zbulimeve me vendet fqinje etj.

Nga kjo bisedë ne filmuam vetëm për një krönikë të shkurtër, kështu që në pushim ishim më të lirë.

Ndërkohë shoku Enver, duke parë mozai-kët, muret e kalasë, vendstrehimet, amfiteatrin e njohur të Butrintit, erdhë e u ndal te grupi i Televizionit, që po xhironte me shumë kujdes e vëmendje.

— Ju lumtë, — foli ai me ton shumë dashamirës. — Keni bërë një punë të madhe. Po mirë, na thoni një herë, kur arrini, kur i dërgoni materialet në laborator, kur hyni në montazh, kur i kontrolloni. Ju punoni shumë shpejt. Përgatitja e filmit është proces i gjatë pune. Ju lumtë!

A kishte vlerësim më të madh për ne!? Fjala nuk ishte këtu vetëm se emisionet e lajmeve dhe pasqyrimi i vizitës po shkonin mirë, por shoku Enver njihet të gjitha vështirësitë e «telashet» e punës sonë deri në detajet më të hollësishme.

U gëzuam shumë që biseda erdhi në një fushë që ne mund të diskutonim lirshëm. Shoku Enver na dëgjonte me vëmendje, e në fund, na dha një sihariq, të madh: «Nuk do të kursejmë për Radiotelevizionin. Ai është mjet i fuqishëm e shumë masiv i propagandës së Partisë. Televizioni është si një dritare e hapur kur çdo natë shikojmë punën e jetën e gjithë Shqipërisë. Ndaj Televizionin do ta forcojmë e do ta pajisim me aparatura moderne elektronike e bille, edhe mençnjyra.»

Të gjitha u realizuan dhe madje në një kohë të shkurtër. E ne shqetësohen: a i njeh njeri «telashet» tona apo jo!

3. Në mbrëmjen e Vtit të Ri

Nga të gjitha festat e gjëzimet, Viti i Ri sepse ka diçka të veçantë që mbahet mend nga një mot në tjetrin. Por... ka edhe Vite të Rinj që

dallohen nga të tjerët. Për njerin prej tyre, për një takim të paharruar desha të tregoj diçka në këto shënimet e mia,

Gjatë viteve gjashtëdhjetë, por edhe në fillimin e viteve shtatëdhjetë, kur punonim në aparatin e Komitetit Qendror të Partisë, në festat e Vtit të Ri vinin të gjithë punonjësit, që nga Sekretarët e Komitetit Qendror e deri te punëtorët e shërbimit. Ishte rasti ku mblidheshim të gjithë. Vinte në këto gjëzime me gjithë familjen edhe shoku Enver. Dhe nuk ishte kohë e pakët, por orë të tëra gjëzonim e këndonim, trigonim historira pér pjesëtarët e kolektivit.

E përmenda, pér orë të tëra, sepse në vitet 1971 deri 1973, në mbrëmjet e Vtit të Ri, me një grup shokësh u ngarkuam pér të hartuar e pér të zbatuar programin e mbrëmjes së kësaj festë. Me këtë punë ishim marrë edhe herë të tjera, por çështja qëndronte që të kishim gjëra të reja, humor. Sidomos humor ngajeta, nga puna e shokëve, të kishim edhe korin e kolektivit, por edhe solistë. Me një fjalë një «festë e lodhshme» siç i thonim në me shaka.

Gjithçka ishte në rregull. Mbrëmja filloj shumë e gjuar, por kur hyri shoku Enver, gjëzimi ishte i papërshkruar. Ne të organizimit të mbrëmjes, se si mbetëm me ato letra në duar e gjithçka e përgatitur na u duk e varfër e s'dinim se si do të na ekte puna. Por shoku Enver me thjeshtësi e gjiltërsi, si ta kuptonte hallin tonë na u drejtua:

— Vazhdoni ju, se ne, ja u ulëm e do t'u dëgjojmë me ëndje çfarë na keni përgatitur.

Siç ndodh gjithnjë në këto festa, pak minuta na kaluan me përshëndetje e urime... e pas-taj programi ynë u gjallërua nga vetë pjesëma-

rrësit, saqë ne s'po merrnim vesh ç'kishim përgatitur ne e ç'po bënte kolektivi.

E filluam me korin e aparatit. Dirigjent kishim caktuar një nga shokët tanë më të shëndo-shë e më të rëndë në peshë. Gazi s'kish të sosur. Ku këngët e ku dirigjenti. Shoku Enver ndiqte me vëmendje e qeshte me gjithë zemër. Më vonë programi mori zhvillim krejt të lirë. Për këtë na ndihmoi vëtë shoku Enver.

— Po mirë, — filloi ai, — grupi lab me Hysniun kur e ka radhën?

Shoku Hysni Kapo, në këto mbrëmje, bashkë me grupin e tij, ishte nga më të dalluarit! Dhe janë skenën e improvizuar ngjiten vlonjatët. Ja merr këngës shoku Hysni. Iso mbante grupi pas, po s'vononte e, iso mbante e gjithë salla. Çaste të gëzueshme e të këndshme. Dikush propozonte të incizoheshin. Shoku Enver shtoi:

— Ky grup ka bërë përparime. Hysniu kënduar më mirë se vitin e kaluar.

Mbas këngës labe fillonin vallet. Këndohej e kërcehej. Një muzikë kishte, por secili e hidh-te hapin «sipas dëshirës».

Pastaj ndërhyntë përsëri shoku Enver:

— Po nga Shkodra, çfarë na keni përgatitur?

— Kemi gjëra të reja shoku Enver.

Në «skënë» doli edhe Skënder Sallaku që filloi me humorin e tij të njobur.

Shoku Enver qeshi me gjithë zemër. Të gjithë qeshëm, sepse Artisti i Popullit tregoi shumë bukur. Më pas shoku Enver e takoi Skënderin e u fjalos me të për estradën, për humorin e hollë e të bukur të popullit tonë.

Mbrëmja vazhdoi gjatë. Programin tonë e pasuruan vetë pjesëmarrësit. Orët po na iknën si minutat. Megjithatë vlerësimin më të madh për

punën tonë të përgatitjes e dha vetë shoku Enver. Dhe ja se si.

Ishim ngritur pothuaj të gjithë të vallzonim. Orkestra ekzekutonte një tango të qetë. Kërcente edhe shoku Enver me shoqen Nexhmije. Për një çast, duke vallézuar ai erdhi e u afroa te grupi i ynë. Na përgëzoi për mbrëmjen, që ishte organizuar shumë bukur. Pastaj, duke m'u drejtuar mua, që edhe paraqitja programin, edhe tregojë historira, më tha:

— Kemi qeshur sonte sa për një vit. Më duket edhe ne e pësuam si ato ndërmarrjet që realizojnë planin në fund të vitit. Të gjithëve faleminderit. Tani si kujtim them të bëjmë një fotografi. Dhe Sulo Gradeci, si gjithnjë i papërtuar, shkrepri aparatin.

Ky ishte një kujtim i paharruar. Jo thjesht për mbrëmjen, jo vetëm për gëzimin, por për atë që ishte në mes nesh shoku Enver. Dhe ishte ashtu i thjeshtë, i dashur, i qeshur.

Sa donim që ajo mbrëmje të zgjatej pa fund.

Tiranë, maj 1985

Rritja e ekranit të vogël

Vendi ynë në këto vitet e Çlirimt, ka bërë hapa të mëdha përparrë në të gjitha fushat. Këto ndryshime, edhe me gjuhën e statistikës, shprehin një kontrast të thellë me të kaluarën.

Për të arritur nivelin e zhvillimit të sotëm, Shqipërisë së paraçlirimit, sikur të ekte me rritmet e vitiit 1938 do t'i duhesin afro 400 vjet. Pra 400 ne i kapërcyem në 40 vjet. Po, kjo në të përgjithshmen, po në disa sektorë krahasimet do të donin shifra e llogaritje akoma më të mëdha:

Të marrim zhvillimin e Radios në vendin tonë. Gjithsej — gjithsej Radio Tirana e paraçlirimit përbëhej nga një stacion me një kilovat fuqi transmetuese e me pak aparatura primitive, mikrofonë e kaballo, të vendosura në një dhomë të vogël, aty ku ka qenë bashkia e Tiranës (Ish-Komiteti Ekzekutiv i vjetri). Edhe ky stacion, kishte ardhur për të transmetuar ceremoninë e martesës së mbretit Zog, në disa rrugë të kryeqytetit.

Ku ta nisësh krahasin. Radiotëlevizioni Shqiptar sot, vjen ndër vendet e para të botës për orët e transmetimit. Çdo ditë, afro 20 orë i përkasin transmetimeve për programin e brendshëm, mbi 80 orë transmetohen programe në 20 gjuhë të huaja, që nëpërmjet stacioneve tona të fuqishme dëgjohen në pjesën më të madhe të vendeve të botës. Shtojmë këtu edhe transmetimet televizive prej afro 40 orë program në javë. Atëherë, cili mund të ishte krahasi me të kaluarën? Të mos harrojmë, këtu është fjala vetëm për krahasime në sasi, në shtrirje e në mjetë, po cila statistikë do t'i maste këto ndryshime në përbajtje?

Të ndalemi tani në shënimet tona te rritja e zhvillimi i madh që ka marrë kohët e fundit «ekrani i vogël».

Televizioni është bërë sot një nga mjetet më të rëndësishme të propagandës dhe të punës ideologjike të Partisë për edukimin e masave të gjera punonjëse me fryshtë të lartë revolucionare e me idealet komuniste, me botëkuptimin marksist-leninist për zhvillimin e ndërtimin socialist të vendit, me krijimin e koncepteve të drejta në shoqërinë sociale, për mënyrën e jetesës, për shijet, sjelljet, për kuptimin e drejtë e rolin e rëndësishëm që luajnë te ne kultura, letërsia dhe arti i realizmit socialist.

Me gjithë kohën relativisht të shkurtër që nga krijimi i Televizonit Shqiptar, në krahasin me organet e tjera, si dhe me gjithë problemet e rëndësishme që ka pasur dhe ka akoma sot Televizioni ynë, mund të themi se ai ka ardhur duke e rritur gjithnjë e më shumë nivelin ideologjik e artistik të tij. Analiza dhe shqyrtimi i problemeve të Televizonit tonë nga Sekretariati i Komitetit Qendror të Partisë në qershor të vitit

1974, fjala e shokut Enver e 20 dhjetorit, mbi zbatimin e detyrave të plenumit të 4-të të Komitetit Qendror të Partisë për letërsinë dhe artet, si dhe orientimet e vendimet e rëndësishme të Partisë në Kongresin e 8-të, fjala e shokut Ramiz Alia në Sekretariatin e Komitetit Qendror, më 5 prill 1985. «Për rritjen e nivelit cilësor të shtypit tonë», kanë bërë e kanë ndihmuar për revolucionarizimin e mëtejshëm dhe ngritjen cilësore të programeve dhe të emisioneve televizive.

Janë bërë hapa konkretë për hartimin e një strukture programesh që u përgjigjen sa më mirë detyrave të kohës e u shërbejnë sa më mirë tele-spektatorëve për problemet e mëdha që ngre Partia. Veç kësaj, janë përcaktuar objektiva të qarta lidhur me konceptimin më të drejtë të përbajtjes së emisioneve dhe të cikëlemisioneve, si dhe të paraqitjes së tyre.

Për të gjitha këto probleme, Radiotelevizioni edhe paraprakisht, por edhe në vazhdimësinë e punës së tij, e ka bërë metodë marrjen e mendimeve të teleshikuesve, të atyre që ulen çdo natë para ekranit për programet, rubrikat e emisionet e ndryshme. Jo vetëm kaq, por një pjesë e madhe e cikleve, e rubrikave, e temave, janë fryt i mendimit dhe i sugjerimeve të teleshikuesve dhe bashkëpunëtorëve. Në takimet e mbledhjet që organizohen, në letrat e shumta që na dërgojnë shikuesit, nga të katër anët, bëjnë madje edhe vërejtje konkrete, deri edhe për shtjellimin e temës, për paraqitjen, për dekorin, për drejtuesit, për paraqitësit e programit etj.

«Në emisione njerëzit mundësishët të flasin pa letër», na bëjnë vërejtje teleshikuesit. Një mendim shumë i drejtë, por që nuk arrihet menjëherë, ama lufta po vazhdon e përmirësime ka. Në po ecim drejt asaj që disa emisione t'i kalojmë

edhe në transmetim të drejtpërdrejtë, sepse emisionet bëhen më komunikuese, më të kapshme, më të natyrshme e si rrjedhim, më shumë e më shpejt ndikojnë në edukimin e njeriut në shoqërinë tonë.

Dikur puna armiqësore në Televizion kishte synuar, në radhë të parë, të deformonte përbajtjen socialiste të programeve tona. Ky qëllim do të arrihej duke e kthyer Televizionin në një institucion me prirje thjesht informative e me një strukturë të mbushur me gjithfarë programesh argëtuese, ku forma dhe paraqitja e jashtme do të mbizotëronin mbi çdo gjë. Këto ishin tendenca reaksionare të nënshtrimit ndaj të huajës, injorimit të kombëtares, nënveftësimit të traditave, të zakoneve, të artit, e të kulturës shqiptare etj.

Duke e kthyer Televizionin tonë në një organ thjesht informues e argëtues, ata mendonin, si pikënisje, t'i hiqnin atij rolin e madh propagandues, edukues e organizues, përhapës të përvojës së përparuar në të gjitha fushat e jetës e afirmues të së resë përparimtare socialiste.

Si kundërvënie të kësaj pune në Televizion po zbatohet me kujdes vendosja e raporteve të drejta në trajtimin e problemeve politike, ekonomike, kulturore e argëtuese. Në bazë të përvojës së krijuar e praktikës së përditshme, si dhe duke u mbështetur gjërisht në mendimet e telespektatorëve për hartimin e programeve të Televizionit, sot mund të themi se është arritur në një raport të drejtë e të efektshëm të problemeve që trajtohen në emisionet tona. Kështu, çështjet informative, duke përfshirë edhe telereportazhin e rubrikën sportive, zënë afro 25 për qind të transmetimeve televizive, problemet

ideopolitike, edukative, kulturore dhe ekonomiko-shoqërore zënë afro 40 për qind, ndërsa problemet artistiko-muzikore e argëtuese mbi 35 për qind. Në këto përqindje nuk janë përfshirë transmetimet sportive, që shpesh dalin jashtë strukturës.

Realiteti tregon se emisionet që mbushin këtë strukturë, për kushtet aktuale e mundësítë e shtrirjes së programave tona, i plotësojnë në mënyrë të kënaqshme kërkuesat e telespektatorëve.

Tani nga krijuesit tanë kuptohet më drejt e përcaktohet më mirë platforma e çdo emisioni ose cikli emisionesh, shtjellohet e piketohet më me vëmendje përmbajtja e tyre dhe bëhet punë më e organizuar e më e menduar në drejtim të paraqitjes artistike. Kështu, mund të theksojmë se gjatë kohëve të fundit mjaft emisione kanë krijuar fizionominë e tyre, pëlqehen e ndiqen me vëmendje nga teleshikuesit. Kështu, mund të përmendim emisionet e fëmijëve e të rinisë me karakterin e theksuar edukativ, erudit e zbavitës. Këto emisione nga viti në vit kanë ardhur duke u rritur në përmbajtje e në paraqitjen e tyre. Kohët e fundit, nisur edhe nga përvoja e nga propozimet e vetë teleshikuesve, të specialistëve në fushat e arsimit, të pedagogjisë e të psikologjisë, emisionet e fëmijëve ndërtohen të grupuar me një mendim lidhës e ku emisionet, sipas grup-moshave plotësojnë njëri-tjetrin. Ato në fakt, tani përbëjnë një televizion të vogël, me rrëth një orë program të veçantë për këto mosha.

Megjithatë, në mjaft raste ndërtimin e strukturën e tyre e përcaktojmë si për të rriturit. Edhe tekstin e përmbajtjen e ndërtojmë sikur kemi të bëjmë me burra e gra, pa folur këtu përgjuhën e mënyrën e të folurit, që në disa raste u ngjajnë bisedave të të rriturve.

Edhe në paraqitjen e regjinë e emisioneve për fëmijë, defterët mbeten të hapur, sidomos për sa i takon ndërtimit të dekoreve, shijeve në punimin e tyre, përshtatjen me psikologjinë e botën e fëmijëve për këto mjetet, ku do të luajnë, ku do të këndojnë e interpretojnë.

Struktura e programeve për fëmijë, me shtrirjen e tematikën, plotëson në vija të përgjithshme interesat më të gjera të jetës së tyre. Yllkat mësojnë e tregojnë, fatosat mësojnë, vëzhojnë e interpretojnë.

Në emisionet për të rritur është synuar që një pjesë e mirë e tyre të kenë vazhdimësi, qoftë në tematikë, qoftë në paraqitje. Kjo ka bërë që ta ndiejmë më shumë nevojën e ciklevë. Ciklet televizive për problemet e prodhimit, të arsimit, të kulturës, e të artit, kanë ndihmuar në zbërthimin e problemeve dhe ndjekjen e tyre për një kohë të gjatë nga teleshikuesit, të cilët nuk janë thjesht vëzhgues, por përkundrazi, pjesëmarrës të drejtpërdrejtë në këto emisione.

Të kujtojmë ciklet «Prodhues e konsumatorë» apo «Si ju shërbejmë», emisionet për prodhimin e makinerive e pjesët e këmbimit etj. U vu re se masa e njerëzve që lidhen çdo ditë me këto probleme kishte edhe interesim të madh për t'i ndjekur këto cikle televizive.

Edhe për sektorët e tjera ka pasur cikle me interes siç ishin ato për shkollën, për shkencën, për artin, për kulturën popullore, për gjinitë muzikore etj.

Mjaft interes paraqesin emisionet per problemet e ditës e të kohës, e si të thuash, ato janë faqet e gazetave tona të ilustruara me dokumentacionin televiziv. Këto emisione, bashkë me lajmet e revistën televizive, përbëjnë strumbullarin e informacionit politik e për problemet e ndry-

shme në fushat e ekonomisë, të kulturës, të artit etj.

Në këtë gamë të madhe, emisionet për problemet në industri, në miniera, në ndërtim, për teknologjinë e shkencën e prodhimit etj, ndiqen e kanë krijuar fytyrë të tyren. Por hapa më të dukshëm përpara kemi bërë në emisionet për bujqësinë.

Emisionet e mjekut kanë vend të veçantë. Ato ndiqen jo vetëm sepse njerëzit janë të interesuar, sepse aty shohin një këshillues, një mësues, por edhe për faktin se, bashkëpunëtorët më të kualifikuar të vendit tonë në fushën e mjekësisë i trajtojnë problemet kuptueshëm e me kompetencë. Është edhe një përparësi e këtyre emisioneve që problemet i trajtojnë në drejtim të profilaksisë, të marrjes së masave mbrojtësse, të edukimit shëndetësor e sanitari për një trup të kalitur fizikisht.

Me interes ndiqen edhe emisionet shkencore: ciklet për fizikën e zbatimin e saj në praktikë; shkenca dhe prodhimi, veprimtaria e shkencëtarëve në degët e kimisë, të biologjisë, të gjëografisë; njojja me vendet e ndryshme të botës, fenomenet e detrave e oqeanevë, fauna e flora në ujërat oqeanike etj.

Rezultate të mira janë arritur edhe në fushën e programeve artistike e muzikore, në koncertet varietet, fjala artistike, sidomos në ske-nimet e xhirimet me interes të koncertit të madh të Vinit të Ri. Tashmë po lëvizet mirë për një konceptim më të detajuar të emisioneve apo programeve muzikore. Në disa nga dokumentarët televizivë me këtë temë, është zbërthyer mendimi dhe emocioni i këngës në ilustrim real jetësor me një shpjegim të brendshëm televiziv.

Një gjallëri të mëtejshme i kanë dhënë struk-

turës së programeve të Televizionit transmetimet e drejtpërdrejta që te ne kanë filluar këto kohët e fundit. Këto jo vetëm e afrojnë shumë teleshikuesin me Televizionin me temën që trajtohet, por ato krijojnë edhe ndjenja e emocione të menjëhershme, sepse shikuesit marrin pjesë drejtpërdrejtë në këto ngjarje.

Transmetimet e para, përjashto këtu veprimtaritë e ndeshjet sportive, nuk u arriten menjëherë, kishte njëfarë ndrojtjeje e pasigurie, por këto ishin çastet e para, sa u fitua besimi e, më pas gjithçka eci mirë. Kështu mund të përmendim festivalet e këngës në Radiotelevizion, emisionin e mjekut, këngëtarë të ftuar në studio etj. Mendojmë se në të ardhmen edhe një numër i madh emisionesh, bisedash e takimesh mund e duhet të transmetohen drejtpërdrejt.

Në hartimin e programeve dhe të emisioneve televizive, mbahet parasysh se ato ndiqen në të njëjtën kohë nga masa të gjera teleshikuesish duke filluar nga fëmijët e deri te pensionistët. Kjo përfaktin se Televizioni, si mjet i informacionit, i edukimit dhe i argëtimit, u merr një pjesë të madhe të kohës njerëzve, ndaj duhet llogaritur që të gjithë të gjejnë interesanten në çdo transmetim.

Në fushën e gjinive të mëdha artistike, si filmat, dramat e teledramat, koncertet variete, nga estrata në ekran etj., janë arritur disa suksese të dukshme. Kështu filmat «Udhë e shkronjave», «I, treti», «Kur hidheshin themelet», «Stina e madhe», filmi për jetën e veprën e Ali Kelmendit etj; një sasi e tërë dramash e teledramash, programe muzikore, koncerete variete etj., të realizuara nga Televizioni janë mirëpritur e kanë ndikuar mirë te teleshikuesit e shumtë.

Janë të njobura tanimë detyrat e gazetarit

e të redaktorit në shtyp (gazetë), në Radio e në Televizion. Në rastin e parë, për gazetarin mbizotërojnë: mendimi, analiza, konkluzioni i dhënë nëpërmjet artikullit, materialit të botuar; në rastin e dytë, redaktori i Radios të japë nëpërmjet zërit dhe efekteve të ndryshme, vërtetësinë për ngjarjen, kohën, dëshmitarët pranë mikrofonit, mendimet e pjesëmarrësve në një veprimitari etj. Kurse për çdo gjë të paraqitur në ekran ka një mendim të redaktorit, të kamerës, të regjisë, të operatorit. Pra, kemi të bëjmë më një punë kolektive krijuese të shkallës së lartë. Ndaj edhe çështja e organizimit të brendshëm të emisionit merr rëndësi të veçantë. Këtu nuk është fjala vetëm për përbajtjen, për nxjerrjen e ideve kryesore, sepse ky gjithnjë është problem qendror, por rëndësi të veçantë merr formulimi artistik regjisorial.

Në emisionet televizive rëndësi të veçantë merr edhe raporti i fjalës me figurën, të cilat duhet të jenë në harmoni të plotë me njëratjestrën. Gazetari në Televizion ka një përparësi që nuk e ka as gazetari i shtypit e as i Radios, ka figurën, pamjen. Atë që ne shpeshherë e kemi vështirë ta pëershkruajmë, dhe bile ndonjëherë e deformojmë, kamera ta jep të gjallë e reale. Këtu qëndron edhe specifika televizive. Fjala tani duhet zgjedhur më me kujdes. Është sinkrone me figurën apo jo? Kështu, ka raste që në p.sh. flasim për misrin e mënyrën e mbjelljes, dhe në ekran duken njerëz që prashisin bimët e rritura; ose jemi duke folur për veshjen karakteristike të Veriut e në ekran është afruar fustaneilla e Kolonjës etj. Të një natyre tjeter janë rastet kur fjala e figura nuk plotësojnë njëratjestrën në ekran. Këto ndodhin sidomos në transmetimet e drejtëpërdrejta nga vendi i ngjarjes,

në transmetimet sportive etj. Për shembull, duke transmetuar një paradë ose manifestim ditën e 1 Majit, është e tepërt t'u thuhet telespektatorëve se filan ndërmarrje që parakalon tanë mban në duar flamuj, parulla e banderola, kur ato duken shumë mirë; ose: iks futbollist është duke ecur vetëm me top në krahun e djathtë të sulmit të tij në kohën që telespektatorët atë e shohin shumë mirë... Por si duhet vepruar, mos duhet heshtur në këto raste? Jo. Këtu fjala, teksti, duhet të jenë zërthim e bashkëshoqërim i këtyre emocioneve e veprimeve që zhvillohen, sepse duke i përdorur ato me ekonomi, me takt e zgjuarsi, jo vetëm nuk bëhen shqetësuese për telespektatorët, por edhe mbushin ekranin e veprojnë në unitet duke ia arritur qëllimit.

Në praktikën e përgatitjes së emisioneve televizive te ne, vështirësi paraqesin akoma organizimi e realizimi i bisedave. Bisedat e intervistimet zënë një pjesë të mirë të transmetimeve tonale televizive e kanë të bëjnë kryesisht me emisione shumë të rëndësishme, si ato për çështjet ideologjike, për probleme shoqërore, të arsimit, të letërsisë dhe të artit etj. Pra, si të thuash, emisionet-biseda përbëjnë thelbin e punës propagandistike në Televizion.

Disa herë nuk bëhen sa duhet përpjekje për ilustrimin e tyre, nuk punohet me perspektivë për sigurimin e bashkëpunëtorëve të aftë, që të dinë të komunikojnë e të ambientohen me kamrën, nuk përcaktohet mirë tema në funksion të ciklit të bisedave etj. Si rezultat i kësaj pune jo shumë të menduar, disa biseda televizive akoma zhvillohen me nivel jo të kënaqshëm. Shpesh në to, edhe nga vetë redaktori, bëhen pyetje pa kuptim ose që ia ndërojnë drejtimin bisedës. Në mjaft raste pyetjet e formuluara nuk i hapin

horizont mendimit të bashkëbiseduesve, sepse atyre mund t'u përgjigjesh me një «po» ose «jo». Veç kësaj, në disa raste, emisionet televizive, e sidomos ato që ndërtohen mbi bazën e bisedave, mbushen me frazeologji e téminologji të ndërlikuar, që me vështirësi ndiqen nga telespektatorët. Shoku Enver, duke folur për këtë në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH të nëntorit 1975, tha: «Televizioni nuk duhet t'u paraqesë spektatorëve, ta zëmë, auditorin e psikiatrisë në seri, ose të japë kursin e leksioneve të Universitetit me skica e plane të stërholluara mbi arkitekturën. Kur flitet mbi artin e popullit shqiptar dhe punimet artistike, ta zëmë në Berat telespektatori ka dëshirë të shikojë objektet artistike si dollapin, tavanin musëndrën etj., dhe jo vetëm ftyrën e arkitektit që jep shpjegime. Arkitekti mund të paraqitet një herë në ekran sa për të trënguar cili është ai që flet dhe pastaj ai të mos duket më. Duke paraqitur vazhdimisht specialistin që jep shpjegime dhe skicat që ai ka varur në mur për të trënguar se këtu është dritarja dhe atje oxhaku që del nga ana e derës me qëllim që të mos ketë korrente e të tjera, emisioni bëhet i mërzitshëm. Këto hollësi mund t'i hyjnë në punë auditorit në Universitet, por jo publikut».

Pjekurinë në përcaktimin e tematikës, në gjetjen e temës në kapjen e çështjeve, duhet ta kemi jo vetëm për emisionet problematike, por duke filluar që nga lajmi, që nga kronikat. E nën-vizojmë këtë, sepse disa herë në kronikat tonë duket njëfarë skematizmi. Po të jetë, për shembull, kronikë nga bujqësia tregojmë më parë kodrat, pamjet e fshatit e pastaj njerëzit duke punuar në kanal. Po të jetë industri, tregohen konturet e fabrikës, reparti, pastaj tornitorë.

Lindin pyetjet: Cila është tema? Ku duhet përgjendruar kamera jonë? Cila është përbajtja e lajmit? Po t'i analizojmë me kujdes të gjitha këto, atëherë me siguri do të përcaktojmë më drejt çfarë duhet të filmojmë, çfarë është kryesorja e cilat mendime do të vëmë në qendër të vëmendjes.

Është fakt që sot për Televizionin ka interesim të madh. Kjo duket nga mendimet, sugjerimet, propozimet e vërejtjet e drejta të telespektatorëve, të shokëve të udhëheqjes etj. Nisur nga ky kujdes e interesim e sidomos për të plotësuar kërkesat e teleshikuesve është e domosdoshme të luftohet që çdo emision të ketë ftyyrën e tij televizive. Dhe mendojmë se e gjithë kjo punë duhet të fillojë që me përgatitjen e skicë-skenarëve e të skenarëve, me njohjen e regjisorit, me veçoritë e temës së emisionit, të bisedës që do të organizohet në studio etj. Për këtë, është e domosdoshme që të gjitha emisionet të vlerësohen e të shikohen me syrin politik, të përcaktohen më mirë mjetet shprehëse e pasqyruese për to, të zgjidhet me kohë dekor i vendi i xhirimit etj.

Kujdes të veçantë duhet t'u kushtojmë ilustrimit, dokumentacionit, faksimileve, futjes së dëshmitarëve e të njerëzve që kanë marrë pjesë në ngjarje të caktuara. Kur këto porosi janë mbajtur parasysh e janë realizuar me kujdes e vëmendje, edhe emisionet kanë dalë të nivelit të lartë. Në mënyrë të veçantë duhen përmendur këtu emisionet për ngjarje e data dhe për figura të shquara. Kështu, mund të përmendim emisionet për Isa Boletinin, Bajram Curri, Bajo e Çerciz Topullin, Avni Rustemin, Mic Sokolin, Luigj Gurakuqin, Riza Cerovën etj; emisionet kushtuar figurave të shquara të kulturës, të

letërsisë e të artit shqiptar, si Naim Frashërit e vëllezërve Frashëri, Pashko Vasës, Filip Shirokës, Aleksandër Moisiut etj. Për t'u theksuar janë edhe emisionet e përgatitura mjaft mirë për brigadat partizane të UNÇSH e ngjarje të Luftës Nacionalçlirimtare, për heronjtë e kësaj epopeje të lavdishme etj.

Sot, me të drejtë, teleshikuesit tanë kërkojnë që programet e Televizionit të mbeten gjithnjë interesante, të edukojnë, të mësojnë dhe të argëtojnë.

Për këtë duhet angazhimi i tërë forcave krijuese të vendit, që mund të arrihet vetëm nëpërmjet bashkëpunimit të mirë në mes nesh, Ministrisë së Arsimit e të Kulturës, Lidhjes së Shkrimtarëve e Artistëve dhe gjithë institucioneve të tjera.

Realizimi i këtyre detyrave, kërkon edhe një punë me horizont të gjerë për ngritjen ideo-profesionale të punonjësve të Televizionit.

Ka ardhur koha të mendohet seriozisht, për përgatitjen e kuadrit me specifikën e punës në Radiotelevizion. Edhe gazetari, redaktori, komentatori për këtë institucion e profil të propagandës duhet të njohë e të përdorë mirë specifikanë e punës në Radiotelevizion. Jo vetëm kaq, por edhe regjisoret, operatorët, kameramanët sektori i multit etj., kanë specifikën e tyre që lidhet me një punë të domosdoshme e që duhet tanimë të fitohet në shkolla e degë të veçanta kryesish në vendin tonë, për pjesën kryesore të specjaliteteve.

PËRMBAJTJA E LËNDËS

| | |
|--|-----|
| Bijtë e tokës sime | 3 |
| Në vitet e largëta e të afërta të shkollës pedagogjike | 5 |
| Krismat shqiptare në poligonet e Evropës | 19 |
| Tërmeti tundi malet por jo zemrat tonë | 39 |
| Fitimtarë mbi tërmetin | 54 |
| Komani, një betejë e madhe | 66 |
| Ditët dhe netët e grykës së Mergunit | 77 |
| Në Gjirokastër e gjithë Shqipëria | 85 |
| Kënga mori udhë... | 94 |
| Biografi e re në këngët e popullit | 101 |
| Krah për krah shkrimitarë e gazetarë | 112 |
| Ato ditë prilli të paharruara | 118 |
| Kur ndjekim emisionin «Ngjarje e data» | 129 |
| Tre çaste nga një jetë e madhe | 137 |
| Rritja e ekranit të vogël | 147 |

Hajati, M.

Bijtë e tokës sime... (Shënimë publ-
cistike) Red. P. Ymeri, T., «8 Nëntori», 1986
...f. me il.

(B.m.) dhe
(B.v.): 891.983-92

H 19

Tirazhi 2000 kopje Format 78x100/32 Stash: 2204-82

Shtypur: Kombinati Poligrafik
Shtypshkronja «8 Nëntori» — Tiranë, 1986